Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 11 (103). NËNTOR 2014. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.



Market KEN

Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

REPORTAZH

Me libra mes fëmijëve

Një nxënës - një libër, dhuratë për shkollën 9-vjeçare të Vranjit

Nga **BUJAR KAROSHI** - FAQE 12-13



KUJTESË

Përmendore për Betejën e Torviollit dhe luftërat për liri



FAQE 4,5,6

Tuneli i Qafës së Buallit



Përfundon gjysma e tunelit. Segmenti Ura e Vashës-Tiranë në pritje të koncesionit

Çfarë po ndodh me Rrugën e Arbërit? Kush po e pengon nënshkrimin e marrëveshjes me qeverinë kineze? Çfarë parashikojnë kontratat që janë në negocim? Kinezët do të marrin me koncension vetëm një segment rrugor, apo gjithë segmentin nga Tirana deri në kufirin maqedonas? Marrëveshja e parashikuar të mbyllej në gusht nuk është firmosur akoma. Në Qafë të Buallit vazhdojnë punimet për tunelin, i parashikuar në projektet fillestare të ishte i gjatë 850 metra por që po ndërtohet vetëm 460 metra. Nga njëra anë presim kinezët të ndërtojnë autostradën, nga ana tjetër vazhdojnë punimet që qeveria aktuale, kush ishte në opozitë, i ka konsideruar jashtë standardeve, si projektimin ashtu edhe ndërtimin.

Nga **HYSEN LIKDISHA, BUJAR KAROSHI** - Faqe 2-3

Hidrocentrali i Valikardhes

Nuk rrezikohet Liqeni i Zi!

Pas shkrimit "Valikardha, fshati i trazuar nga ndërtimi i një hidrocentrali: Liqeni i Zi "nxin" mbi të ardhmen e Zerqanit, botuar në gusht 2014 në gazetën Rruga e Arbërit, ka reaguar kryetari i Komunës së Zerqanit, Defrim Fiku.

FAQE 7

70-vjetori i Clirimit

Ismail Strazimiri, *dëshmori më i moshuar antifashist në shkallë botërore*

Në nëntor të vitit 1943, pra, një vit para se Shqipëria të çlirohej nga pushtimi fashist, u vra nga nazistët Ismail Strazimiri. Duke iu referuar kësaj ngjarje, shkrimtari i njohur, Haki Stërmilli, në ditarin e tij të luftës shkruan: "Katundarët thanë se gjermano-ballistat paskan djegë shtëpitë e Cen Elezit në Sllovë të Dibrës dhe në ndeshjen që qenka bam, paska ra dëshmor heroikisht Ismail Strazimiri, plaku 75-vjeçar që për sigurimin e lirisë së Atdheut kishte rrok armët dhe kishte dalë maleve...

FAQE 17

Portret

Shemsi Hoxha – *dibrani me mendje e veprime brilante*

Shemsi Hoxha, kudo ku punoi e jetoi në Dibër, ka lënë emër tepër të respektuar. Jeta e tij prodhoi vetëm mirësi, mençuri e kontribute. Ai ishte kuadër me mendje të kthjellët e të thellë, me pasion e kompetencë në punë, me korrektësi e shpirt demokratik, me cilësi të veçanta komunikimi, mbi të gjitha, me karakter për t'u admiruar.

FAQE 20

Sport

Korabi, *shtatë fitore në shtatë ndeshje*


Flasin presidenti i Korabit Fehmi Meziu, kryetari i Bashkisë Peshkopi Ilir Krosi, shefi i klubit Sokol Muho, trajneri i ekipit Erblin Laçi, kapiteni i skuadrës Gerald Lleshi dhe ylli i futbollit dibran Shpëtim Toska.

FAQE 22-23

Filiali që "u mbyt" në baltën që krijoi vetë

"Ne duhet të luftojmë për të pasur një institucion të arsimimit të lartë në Dibër, në themel të të cilit do të derdhet kontributi akademik i mbi 150 profesorëve e pedagogëve dibranë, që kanë rrezatuar dije e kompetencë akademike në universitete e qendra kërkimore e shkencore në Shqipëri e në botë. Këta personalitete kanë shprehur vullnet për të kontribuar për Filialin e Peshkopisë, por janë ndeshur në heshtje, shpërfillje, mungesë respekti e injorim. Tashmë është radha të nisim betejën ne, që kemi qëllim iluminimin shoqëror dhe përparimin e Dibrës. Ne duhet të luftojmë fort për të pasur jo një Filial, por një Institucion të Arsimit të Lartë, në kapacitete reale me qëllime e objektiva të menduara mirë e mbi kritere shkencore. Kjo është një ftesë për të gjithë ata që ndjejnë vërtetë dhimbje për dështimin një institucioni arsimor, si Filiali..."

Nga HYSEN UKA - Faqe 8



cyan magenta yelloë black 1

Çfarë po ndodh me Rrugën e Arbërit? Kush po e pengon nënshkrimin e marrëveshjes me qeverinë kineze? Çfarë parashikojnë kontratat që janë në negocim? Kinezët do të marrin me koncënsion vetëm një segmentr rrugor, apo gjithë segmentin nga Tirana deri në kufirin maqedonas? Marrëveshja e parashikuar të mbyllej në gusht nuk është firmosur akoma. Në Qafë të Buallit vazhdojnë punimet për tunelin, i parashikuar në projektet fillestare të ishte i gjatë 850 metra por që po ndërtohet vetëm 460 metra. Nga njëra anë presim kinezët të ndërtojnë autostradën, nga ana tjetër vazhdojnë punimet që qeveria aktuale, kush ishte në opozitë, i ka konsideruar jashtë standardeve, si projektimin ashtu edhe ndërtimin.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 11 (103). 1 - 30 Nëntor 2014

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Kontribuan për këtë numër:
Sashenka NDREKA
Abdurahim ASHIKU
Ali HOXHA
Ardian REÇI
Beqir SINA
Defrim METHASANI
Hysen LIKDISHA
Hysen UKA
Metush SKEJA
Mevlud BUCI
Shemsi MANJANI
Sulejman TOMÇINI

Arkivi i gazetës është ME pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.** Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online. Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.

Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 4700036640
IBAN: AL902021121900000004700036640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Përfundon gjysma e tunelit në Qafën e Buallit

Nga **HYSEN LIKDISHA**
BUJAR KAROSHI


©Foto: Hysen Likdisha

TUNELI I QAFËS SË BUALLIT: HAPEN 200 METRAT E PARA

Mbetet e pashuar, madje ka nisur të ndriçojë dukshëm drita e shpresës për ndërtimin e Rrugës së Arbërit. Themi kështu, pasi prej të paktën 6 javësh ka vijuar intensivisht punë për hapjen e tunelit në Qafën e Buallit, pjesë e rëndësishme e këtij segmenti rrugor. Rreth 1 kilometra mbi qytetin e Bulqizës, pikërisht në vendin ku ndahet kufiri me Matin, po vazhdojnë punimet për të lidhur luginën e Bulqizës dhe Luginën e Planit të Bardhë me tunelin e Qafës së Buallit, një nga segmentet e rëndësishme në aksin e Rrugës së Arbërit.

Tuneli i Qafës së Buallit, me gjatësi 460 metra, do të jetë edhe "pika e kthesës", ku Rruga e Arbërit do të marrë kthesën për të hyrë në gjurmën e vjetër tradicionale të saj, për të vijuar mes për mes Planit të Bardhë për të zbritur në Urën e Vashës. Më pas rruga do të vazhdojë drejt Xibër Murrizës dhe më në fund për të zbritur në kryeqytet brenda 40 minutave. Rruga me gjatësi rreth 45 kilometra do ta kthejë qytetin e minatorëve në një lagje lindore të kryeqytetit.


Gjatë këtyre ditëve të fundnëntorit u bëmë dëshmitarë të vijimit të punimeve për hapjen e këtij tuneli, ku puna vijonte intensivisht në të dyja anët e tij. Tuneli është pjesë e lotit 3 të kësaj rruge, dalje Ura e Vashës-Bulqizë. Punimet për hapjen e këtij loti rrugor me vlerë 6.3 milion lekë pa TVSH, kanë nisur më 20 korrik 2009 dhe duhej të përfundonin më 20 mars 2011. Dukshëm këto punime kanë njohur zvarritje dhe ndërprerje sporadike të herëpashershme, që në përgjithësi, sipas një burimi nga firma zbatuese, kanë ardhur si pasojë e mungesës së fondeve financiare, por edhe dëmshpërblimit të vonuar të pronarëve të fshatit në Planin e Bardhë, që u dëmtoheshin pronat nga ndërtimi i rrugës.

Aktualisht, gjendja në ndërtimin e këtij segmenti rrugor paraqitet e tillë: Deri në Qafën e Buallit rruga ka përfunduar së ndërtuari me të gjitha elementët përbërës të saj. Ndërsa segmenti nga Qafa e Buallit-Ura e Vashës, kanë përfunduar hapja e trasesë dhe hedhja e shtresave të zhavorrit. Edhe zbatimi i projektit për ndërtimin e tunelit ka pasur zvarritje të dukshme. Kështu punimet për ndërtimin e tij kanë nisur më 7 shkurt 2011 dhe kanë pasur një afat prej 18 muajsh. Por ende nuk është hapur dhe vetëm gjatë fillimit të muajit tetor të këtij viti ka nisur puna intensivisht për hapjen e tij.

Fondi financiar për hapjen e këtij tuneli kap vlerën prej rreth 1.6 milionë dollarë dhe punimet kryhen nga firma "Gjoka konstruksion" që punon prej vitesh në këtë rrugë. Punohet me ritëm të lartë në të dyja anët e tunelit, me makineri e kushte të larta të sigurisë në punë.

Drejtuesit teknikë të punimeve, thanë për "Rruga e Arbërit", se puna për hapjen e tunelit paraqet mjaft vështirësi, pasi shtresat tokësore ku bëhet hapja janë të shkrifta dhe jo shkëmbore, gjë që duan ndërmarrjen e masave të forta për kushtet e sigurisë në punë. Kështu, sipas tyre, asnjë centimetër e hapjes së tunelit nuk mund të avancojë pa u betonuar. Deri më tani ecuria e punimeve mësohet se ka qenë shumë e mirë, pasi janë hapur rreth 200 metër linear të tij. "Dhe me këtë ritëm pune, - thonë specialistët, - parashikojmë se në fillim të Vitit të Ri të përfundojë hapja e këtij tuneli.

Nisja e punimeve për hapjen e Tunelit të Qafës së Buallit, pjesë e shumë të përfolurës Rruga e Arbërit, ndez shpresën, por edhe besimin, pse jo, se nga ndërtimi i saj nuk do të ketë kthim prapa dhe as bllokim punimesh, por se ndërtimi i rrugës do të jetë vetëm çështje kohe. Kështu mediat kanë bërë me dije, se vijojnë negociatat mes qeverisë shqiptare dhe kinezëve për marrjen prej tyre me koncesion të kësaj rruge. Madje thuhet se këto bisedime pritet që të finalizohen gjatë muajit dhjetor. Më në fund duket se me



Firmos dhe **komento peticionit** në **change.org**

http://www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-the-arb%C3%ABri-road-nd%C3%ABrtoni-sa-m%C3%AB-shpejt-dhe-me-standarde-rrug%C3%ABn-e-arb%C3%ABrit?utm_campaign=petition_created&utm_medium=email&utm_source=guides

kryesore



© Foto: Hysen Likdisha

Segmenti Ura e Vashës-Tiranë në pritje të koncesionit

Deputeti i Dibrës Shkëlqim Cani: "Kam premtuar Rrugën e Arbërit. Për këtë jemi ne negociata. Ndahet mendja si do bëhet. Rruga e Arbërit është rrugë që kërkon para. P.sh. 26 km duan afërsisht 200 milionë euro. Ne kemi hyrë në negociata të vazhdueshme. Unë jam i interesuar për këtë çështje. Jemi në negociata dhe nuk e ka lënë askush jashtë vëmendjes Rrugën e Arbërit. Kuptohet, deri në përfundim të negociatave intensive, ne nuk heqim dorë së thëni që ajo rrugë do të realizohet".

hapjen e tunelit të Qafës së Buallit në fundin e tij do të hapet drita jeshile për ndërtimin e Rrugës së Arbërit.

KONCESIONI: PËR ÇFARË NUK PO BIEN DAKORD QEVERITË?

Që nga muajit shtator, kur Kryeministri Rama tha nga se qeveria ishte në prag një marrëveshje për rrugën e Arbërit me qeverinë kineze, nuk ka më asnjë lajm të ri. Zyrtarë të qeverisë, pushtetit lokal apo deputetë, herë pas here kanë deklaruar se kjo marrëveshje është në prag të firmosjes, por deri në festat e nëntorit asgjë nuk ka ndodhur. Një burim pranë grupeve negociatore i tha korrespondentit të gazetës sonë se marrëveshja do të nënshkruhet së shpejti, por janë disa detaje që kanë të bëjnë me kushtet financiare, për të cilat grupet negociatore nuk kanë rëndë dakord akoma.

Ministri i Financave, njëherësh edhe deputeti i Dibrës, gjatë një emisioni në Top Channel përballë gazetarit Sokol Balla, pyetjes se pse në buxhetin e ri të shtetit nuk janë parashikuar para për rrugën e Arbërit, ai u përgjigj: "Kam bërë tre premtime gjatë fushatës elektorale. Kam premtuar uljen e moshës së pensionit - u realizua. Kam premtuar punimet në pusin e thellësisë ku garantohet puna për 800 minatorë - punimet kanë filluar. Së treti kam premtuar Rrugën e Arbërit. Për këtë jemi ne negociata. Ndahet mendja si do bëhet. Rruga e Arbërit është rrugë që kërkon para. P.sh. 26 km duan afërsisht 200 milionë euro. Ne kemi hyrë në negociata të vazhdueshme. Unë jam i interesuar për këtë çështje. Jemi në negociata dhe nuk e ka lënë askush jashtë vëmendjes Rrugën e Arbërit. Kuptohet, deri në përfundim të negociatave intensive, ne nuk heqim dorë së thëni që ajo rrugë do të realizohet".

Por ndërkohë që deklarimet e qeverisë shqiptare janë shumë optimiste për rrugën, në praktikë nuk shihet shumë shpresë. Vazhdimi i punimeve në segmentet e lëna përgjysmë, me të njëjtin projekt zbatimi si para zgjedhjeve, kur kjo qeveri, atëherë në opozitë, i konsideronte si punime pa standarde, lë dyshime se vazhdimi i rrugës nuk do të jetë në parametrat e dëshiruara.

Në fund të shkurtit 2014, dy shoqata dibrane në Tiranë, "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" dhe "Nisma Dibrane" i kanë dërguar një letër Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, z. Edmond Haxhinasto, më kërkesën për ta rishikuar projektin e Rrugës së Arbrit në segmentin nga Ura e Vashës në Tiranë.

Në letrën që u është dërguar edhe Autoritetit Kombëtar të Rrugëve dhe gjashtë deputetëve të Dibrës, theksohet nevoja për rishikim të projektit, me qëllim për të pasur një rrugë me standarde bashkëkohore, si të cilësisë së ndërtimit, ashtu edhe të elementëve të sigurisë.

"Në tremujorin e tretë të vitit 2013 disa anëtarë të kryesisë së Shoqatave të Intelektualëve Dibranë dhe Nisma Dibrane në Tiranë kryen vrojtime në zonën ku do të kalojë Rruga e Arbrit, nga Qafa e Buallit, Plani i Bardhë, Ura e Vashës në Gurin e Bardhë të Matit, në Qaf Murrizë, Bastar Kaçu, Shpal, Zall Dajt e Ura e Brarit të Tiranës", thuhet në letër.

"Qëllimi i këtyre vrojtimeve ishte për t'u njohur me ecurinë e punimeve të kryera për gjatë aksit ku kalon Rruga e Arbrit në këtë zonë, vonesat dhe mangësitë e vërejtura në kryerjen e punimeve për të krijuar një ide për punimet e kryera deri tani dhe për të dhënë ndonjë mendim e për të bërë ndonjë propozim për shpejtimin dhe përmirësimin e punës projektuese e zbatuese në vazhdim. Nga një vrojtim i përgjithshëm i punës së kryer deri tani gjatë gjithë aksit që përshkon Rruga e Arbrit, pothuajse vetëm traseja e hapur nga Tuneli i shkurtër në afërsi të Zall Dajtit deri tek ish Uzina e Artilerisë në afërsi të Urës së vjetër të Brarit dhe një pjesë e trasesë në luginën e Planit të Bardhë e mbi Urën e Vashës, mund të quhen trase të rrugës së Arbrit, ndërsa në pjesët e tjera kemi ose rikonstruksion të rrugës ekzistuese ose shmangie nga aksi i rrugës së Arbrit. Shmangja më e madhe është ajo ku duhet të hapet Tuneli i Qaf Buallit", thuhet në letrën e kryetarëve të dy shoqatave dibrane.

"Mbështetur në konstatimet e mësipërme për objektet më të rëndësishme të kësaj rruge si: Tuneli i Qaf Buallit, Ura e Vashës e Tuneli i Gurit të Bardhë dhe Tuneli i Murizës, për të cilat nuk ka filluar ndërtimi i tyre, propozojmë që të rishikohet e përmirësohet projekti duke bërë edhe krahasimet me projektet e hartuara. Mendojmë se marrja parasysh e këtij propozimi do të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së ndërtimit të rrugës, për t'ju afruar sa më shumë standardeve të kohës", mbyllet letra për Ministrin Edmond Haxhinasto.

Letra është e shoqëruar edhe me një relacion teknik, detajet e së cilës janë bërë publike në numrat e kaluar të gazetës "Rruga e Arbrit", por deri më tani, nga asnjë i zgjedhur apo institucion përgjegjës nuk është marrë asnjë përgjigje. Vazhdimi i punimeve në Qafën e Buallit është një tregues së qeveria nuk ka ndërmend t'i rikthehet projektit për ta përmirësuar, të paktën për segmentet që janë tenderuar që në vitin 2009.

Në projektin fillestar të rrugës, p.sh. ishte parashikuar që tuneli i Qafës së Buallit të ishte 850 metra i gjatë, por në fakt ai po ndërtohet vetëm 460 metra. Dhe për këtë askush nuk jep informacione më parë, por vetëm kur punimet janë drejt përfundimit. Kështu ka ndodhur edhe me pjesë të loteve të tjera të rrugës, gjë që ka sjellë deri më tani një rrugë pa standarde bashkëkohore ndërtimi.

Por ndërsa qeveria deklaron nga njëra anë se po vazhdon negociatat, për publikun nuk është bërë e ditur asnjë pikë e këtyre marrëveshjeve, çfarë do parashikojnë kontratat, si do gjendet financimi, kush do ta ndërtoje rrugën, sa është përqindja e interesit të kredisë që do merret, sa parashikohen pagesat për makinat, etj.

SHOQËRIA CIVILE: PRESIONI VAZHDON

Gëzim Alpion, profesori i Universitetit të Birmingamit, i cili 21 muaj më parë nisi peticionin online për ndërtimin së më shpejt të rrugës së Arbrit, konfirmon për gazetën se peticioni vazhdon të mbledhë akoma firma.

Gjatë turit të veprimit në maj në Tiranë, ai dhe mbështetësit e peticionit nuk arritën ta dorëzonin peticionin pranë qeverisë, megjithë kërkesat e vazhdueshem për z. Rama për një takim formal.

Alpion thotë se së shpejti do të bëjë një prononcim publik në lidhje më këtë çështje, dhe thekson se ka ardhur koha që petët ti hiqen lakrorit. 'E vërteta është e hidhur dhe depresionuese'.

"Ne kemi premtuar se do ta vazhdojmë peticionin deri në metrin e fundit të rrugës, dhe kështu po bëjmë", - thotë Alpion në një prononcim për gazetën "Rruga e Arbërit".

Në projektin fillestar të rrugës ishte parashikuar që tuneli i Qafës së Buallit të ishte 850 metra i gjatë, por në fakt ai po ndërtohet vetëm 460 metra. Dhe për këtë askush nuk jep informacione më parë, por vetëm kur punimet janë drejt përfundimit. Kështu ka ndodhur edhe me pjesë të loteve të tjera të rrugës, gjë që ka sjellë deri më tani një rrugë pa standarde bashkëkohore ndërtimi.
Por ndërsa qeveria deklaron nga njëra anë se po vazhdon negociatat, për publikun nuk është bërë e ditur asnjë pikë e këtyre marrëveshjeve, çfarë do parashikojnë kontratat, si do gjendet financimi, kush do ta ndërtoje rrugën, sa është përqindja e interesit të kredisë që do merret, sa parashikohen pagesat për makinat, etj.

reportazh

Përurohet në Laçes të komunës Fushë Çidhën memoriali



Në foto: "Vallja e shpatave" nga grupi i SHKA Komaran - Drenicë. Foto: © Bujar Karoshi

HUZRI HOXHA: "Përmendorja kushtuar "Betejës së Torviollit"... u konceptua dhe u projektua në funksion të plotësimit të disa parametrave historikë të domosdoshëm, të cilët do ta bënin këtë përmendore t'i qëndrojë kohës për të cilën flet si dhe të arrijë të përcjellë mesazhin e duhur brezave të sotëm dhe atyre që vijnë..."

Një **përmendore** për **Betejën e Torviollit** *dhe luftërat për liri*

Nga **MUSA RIÇKU**
BUJAR KAROSHI

Krahina e Çidhnës i takon njërit nga Nëntë Malet e Dibrës. Ajo ndodhet në Dibrën e Poshtme dhe shtrihet në të dy krahët e Drinit të Zi dhe përfshin tre komuna: Kastriot, Arras dhe Fushë Alie. Në këtë krahinë, në fshatin Sinjë, ndodhet dhe muzeu i vetëm i vendlindjes së Kastriotëve.

Mëngjesi i 23 nëntori të këtij viti fshati Laçes në Fushë Alie u zgjua nga këngët dhe vallet patriotike. Në vendin e quajtur Kodër Laçes, shoqata etnokulturore "Çidhna dhe Kastriotët" përuroi përmendoren "kushtuar Betejës së Torviollit dhe luftërave për liri e pavarësi në shekuj".

Në këtë veprimtari ishin të pranishëm banorë të zonës, drejtues të pushtetit lokal, anëtarë të shoqatës, deputetë, grupi i Shoqërisë Kulturore dhe Artistike "Komaran" - Drenicë, ardhur posaçërisht për këtë veprimtari. Gjithashtu, nderuan me pjesëmarrjen e tyre edhe këshilltarët ushtarak të Presidentit Gjeneral Pirro Ahmetaj dhe Sajmir Kodra, dekani i Fakultetit të Arteve të Bukura, prof. Artan Peqini, etj.

Krahina e Çidhnës i takon njërit nga Nëntë Malet e Dibrës. Ajo ndodhet në Dibrën e Poshtme dhe shtrihet në të dy krahët e Drinit të Zi dhe përfshin tre komuna: Kastriot, Arras dhe Fushë Alie. Në këtë krahinë, në fshatin Sinjë, ndodhet dhe muzeu i vetëm i vendlindjes së Kastriotëve.

PËRURIMI I PËRMENDORES

"Sipas dokumenteve, tha në ceremoninë e përurimit nënkryetarja e shoqatës "Çidhna dhe Kastriotët", poetja Rajmonda Maleçka, tashmë të vërtetuara historikisht nga historian shqiptar dhe të huaj, në këtë vendlindje të Kastriotëve janë zhvilluar beteja dhe besëlidhje të rëndësishme, të cilat konfirmojnë traditat e vyera historike të kësaj treve për liri e pavarësi në shekuj. Ndër to, më e rëndësishme, është "Beteja e Lidhjes së Lezhës, komanduar nga Skënderbeu kundër ushtrisë së Sulltan Muratit II-të, më 29 Qershor 1444, e njohur si Beteja e Torviollit. Nga dokumentet e reja historike, kjo betejë, në mbështetje të studimeve të Institutit të Historisë së Akademisë së Shkencave, është zhvilluar në fushën e Dibrës së Poshtme".

Në Gusht të vitit 1466 në Çidhën ka ndodhur masakra e njohur në histori si "Masakra e Çidhnës", si hakmarrje e Sulltani Mehmetit të II, pas dështimit për pushtimin e Krujës. Sipas Barletit, "...në viset e Skënderbeut që quheshin Kidna shkoi në thikë 8000 burra, veç grave dhe fëmijëve...".

Kryengritje dhe luftëra të tjera të rëndësishme janë kryengritjet antiosmane të viteve 1560, 1690, 1711, 1833, 1844 (Gjoricë), 1872, 1909 dhe fillimi i kryengritjes së përgjithshme antiosmane për Pavarësi më 26-27 Mars 1912 në Arras,

Luftërat dhe kryengritjet kundër pushtuesve serbosllave: 22 shtator 1913 në Fushë Alie, 13 gusht 1920 në Arras (Qeveria e Arrasit), 20-21 shtator 1921 në Sinë, 28 tetor 1921 në Lanë Lurë.

"Kryesia e Shoqatës "Çidhna dhe Kastriotët", në kuadër të 570 vjetorit të Betejës së Torviollit, me datë 4 qershor 2014 vendosi ngritjen e një përmendoreje kushtuar luftërave dhe rezistencës së popullit të Krahinës së Çidhnës për liri e pavarësi në shekuj, në vendin e quajtur Kodra e Laçes të Komunës Fushë Çidhën. Për këtë u mor miratimi i Këshillit të Komunës dhe Prefekturës Peshkopi, tha në ceremoninë e hapjes Rajmonda Maleçka.

"Ky memorial përfaqëson historinë e luftërave për liri dhe pavarësi në shekuj të popullit të Çidhnës e Kastriotit, - tha në përshëndetjen e tij, kryetari i shoqatës, Muhamet Bitri. Ky memorial është një përfaqësim që simbolizon luftërat e popullit të Dibrës për liri dhe pavarësi". Gjithashtu, kryetari i shoqatës i falënderoi të gjithë ata që kontribuan për ndërtimin e saj, si dhe dhanë ndihmë financiare për ndërtimin e kësaj përmendoreje.

Kryetari i komunës së Fushë Alies, Aranit Skepi,gjatë fjalës së tij, tha se "Sot do të përurohet memoriali që i kushtohet Betejës së Torviollit, një ndër betejat më të famshme të historisë së shqiptarëve dhe heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu"

Mr. Rruzhdi Lata, kryetar i komunës së Dibrës së Madhe, gjatë përshëndetjes së tij citoi rilindësin Sami Frashëri, i cili thotë se "një popull që nuk mëson nga e kaluara e vet historike është i dënuar ta përsërisë historinë". "Nuk guxojmë të harrojmë historinë tonë që e kemi më të pasur nga të gjithë popujt e Ballkanit, sepse kemi të bëjmë në mesin tonë me një personalitet që nuk e ka asnjë komb, asnjë popull, asnjë shtet, të paktën në trojet e Ballkanit, siç është Skënderbeu", theksoi ai.

"Dikur në vitet 1970, në Odat e Shehrit, pleqtë bisedonin gjithmonë tematikën e Nëntë Maleve të Dibrës, por që për ne ishte ëndërr të lexojmë diçka për ta ose t'i shohim ata ashtu siç i shohim sot. Në traditën shqiptare, gjithmonë, kanë ekzistuar burra, mirëpo burrë i vërtetë është ai që paguan borxhin. Dhe sot, Ju paguani një borxh të historisë dhe meritonit që të jeni sot përfaqësues të burrnisë dibrane", theksoi Mr. Lata. "Dibra është vend unikal, gjithmonë oborrin e vet e ka pastruar vetë, nuk kanë ardhur të tjerët të pastrojnë në Dibër. Kurse Dibra ka luftuar në të gjithë trojet shqiptare".

A ka nder më të madh po qe se ne realisht dhe shpirtërisht të rikthejmë historinë tonë? Skënderbeu është brenda qenies tonë dhe ne duhet të vazhdojmë ta kujtojmë e rikujtojmë, pasi jemi nipërit e tij, ashtu po jetojmë dhe punojmë".

"Është një ambicie e përjetshme që këto vlera historike të na çojnë në një drejtim, i cili duhet të ketë një përfundim: të ndjehemi shqiptarë, të jetojmë si shqiptare. Kemi një histori, kemi një traditë, kemi kulturë, dashtë perëndia të kemi edhe një shtet", mbylli përshëndetjet e tij Mr. Ruzhdi Lata.

Ilir Krosi, kryetar i Bashkisë Peshkopi foli për bashkëpunimin me shoqatën "Çidhna dhe Kastriotët" në lidhje me disa veprimtari të rëndësishme me karakter historik, veçmas në lidhje me këtë përmendore. "Si dibran, si intelektual, por edhe si i zgjedhur i qytetit të Peshkopisë nuk mund të rrija pa ju bashkuar kësaj nisme me një kontribut modest".

Deputeti i Dibrës, i pranishëm në ceremoni, Sherefedin Shehu tha në fjalën e tij se "ky është një moment i rëndësishëm i historisë së Dibrës. Nëpërmjet këtij monumenti, ne sot mësuam për një nga ngjarjet e rëndësishme të asaj periudhe. Ky monument do ta përjetësojë këtë ngjarje, por njëkohësisht na tregon se Skënderbeu nuk ka qenë një figurë e rastësishme e kohës.

"Është privilegj, por edhe emocion i veçantë të jesh i pranishëm në një ngjarje të tillë si kjo e sotmja në nderim të figurës së heroit tonë kombëtar dhe strategut të përmasave botërore, Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Personalisht, tha kolonel Bilbil Bitri, ndjehem thellësisht i privilegjuar edhe për faktin se si bir i kësaj krahine më jepet mundësia që të përcjell te ju përshëndetjet e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Gjeneral Major Jeronim BAZO".

"Kombet pa heronj janë të destinuar të vdesin. Dihet, dhe në fakt ndjehemi fatlum, që kombi ynë e pati dhe e ka Skënderbeun. Heronjtë nuk mund të jenë fizikisht të përjetshëm, por vepra e tyre është gjithmonë inspirim për brezat. E tillë ishte edhe vepra e Skënderbeut.

Pavarësisht viteve të errëta të sundimit otoman, kujtimi i Skënderbeut shërbeu për të mbajtur gjallë ëndrrën e shqiptarëve për pavarësi", thotë në përshendetjen e dërguar me këtë rast Gjeneral Major Jeronim Bazo.

"Fakti historik që pikërisht këtu në Çidhën të Dibrës së Poshtme, ku janë origjina, trojet dhe gjaku e farefisi i Skënderbeut, përbën argument se nuk ka qenë e rastit planifikimi që nga Stambolli, për ta filluar sulmin e parë ushtria osmane kundër shtetit shqiptar të formuar nga Skënderbeu...

Emri i Dimitër Kastriotit, si banor i Sinës së Poshtme në defterin kadastral të vitit 1467, vërteton jo vetëm origjinën e Skënderbeut në këtë krahinë, por edhe praninë e njerëzve të gjakut e të fisit të Kastriotëve këtu, në Çidhën", tha Ali Hoxha, historian, i cili ka luajtur një rol të rëndësishëm që kjo përmendore të ngrihej sot në Kodër të Laçes.

Pas këtyre përshëndetjeve, u zbulua për të pranishmit përmendorja. Në ballë të saj është vendosur pllaka ku shkruhet "Kushtuar Betejës së Torviollit dhe luftërave për liri e pavarësi në shekuj".

Në një tjetër pllakë, vendosur në një nga bedenat anësore shkruhet citimi i Marin Barletit se "Beteja e Torviollit më 29.06.1944 u zhvillua në fushën e Dibrës së Poshtme, ku 15000 arbër të lidhjes së Lezhës, të komanduar nga Skënderbeu mundën 25000 kalorës osman". Në një pllakë tjetër, citohet sërish Barleti për Masakrën e Çidhnës në gusht 1466,: "... në viset e Skënder-

Beteja e Torviollit në botimet amerikane

Në një libër të botuar në Miami të autorëve Jesse Russell dhe Ronald Cohn, me titullin Beteja e Torviollit (Battle of Torvioll), ne shenimin permbledhës të botimit thuhet se "Beteja e Torviollit gjithashtu e njohur si beteja e Dibrës së Poshtme, ndodhi më 29 qershor 1444 në Shqipëri.

Skënderbeu ishte një kapiten otoman me origjinë shqiptare që vendosi që të kthehej në vendlindje dhe të fillonte një rebelim të ri shqiptar.

Ai, bashkë me 300 shqiptarë të tjerë luftuan në betejën e Nishit dhe shkretuan ushtrinë otomane që të mund të vazhdonin drejt Krujës, e cila ishte pushtuar shumë shpejt nga otomanët. Ai më pas formoi aleancën e Lezhës, një konfederatë princërish shqiptarë të bashkuar në luftë kundër Mbretërisë Otomane. Murati II e kuptoi rrezikun dhe dërgoi një prej kapitenëve të tij më të afërt, Ali Pashën, që të shtypte rebelimin me nje forcë prej 25,000 burrash.".

beut që quheshin Kidna... Mehmeti i II... shkoi në thikë 8000 burra, veç grave dhe fëmijëve". Ndërsa një një tjetër shkruhet: "Kushtuar kryengritjeve antisomane në vitet 1560, 1690, 1711, 1833, 1844 (Gjoricë), 1872, 1909 dhe "fillimit të Kryengritjes së përgjithshme me 26-27 Mars 1912 në Arras"... (K.Frashëri). Ndërsa në pllakën e katër shkruhet "Kushtuar Luftërave dhe kryengritjeve kundra pushtuesve serbo-sllavë: 22 shtator 1913 (Fushë Alie, 13 gusht 1920 (Arras), 20-21 shtator 1921 (Sinë) dhe 28 tetor 1921 (Lanë Lurë).

DEBATE MBI VENDIN E NDËRTIMIT. SIMBOLIKA E PËRMENDORES.

Mustafa Tola, Hysen Repa, Huzri Hoxha dhe Haki Përnezha kanë qenë më të angazhuarit gjatë këtyre muajve. Jo vetëm se kanë qenë vazhdimisht gjatë debateve të vazhdueshme që kanë shoqëruar ndërtimin e memorialit, por se edhe kanë marrë në maksimumin e mundshëm gjithë komentet dashamirëse, në mënyrë që përmendorja kushtuar Betejës së Torviollit dhe luftrave për pavarësi të krahinës së Çidhnës të jetë më së miri i realizuar.

"Përmendorja kushtuar "Betejës së Torviollit" dhe kryengritjeve të krahinës për liri e pavarësi në shekuj, e vendosur në Koder Laçes, u konceptua dhe u projektua në funksion të plotësimit të disa parametrave historik të domosdoshëm, të cilët do ta bënin këtë përmendore ti qëndrojë kohës për të cilën flet si dhe të arrijë të përcjellë mesazhin e duhur brezave të sotëm dhe atyre që vijnë, duke ju thënë:"mos harroni kurrë ato me të cilat jemi krenarë", thotë Huzri Hoxha, piktori që ideoi dhe skicoi përmendoren që ngrihet madhërishëm në shpatin e Kodrës së Laçes, me vështrim drejt rrjedhës së Drinit të Zi.

Huzriu ka punuar shumë për idenë, skicimin dhe realizimin e përmendores. "Ajo përmban disa element themelorë, të cilët mendoj se kanë kënaqur qëllimin dhe parametrat historik të kohës. Konkretisht, thotë Hoxha, përmendorja është paraqitur si një figurë "Mbretërore". Kjo, jo pa qëllim: Si një mbret në fushën e betejës, i cili lëviz ose jo brenda kësaj fushe. Që do të thotë, edhe sikur të anatemohet nga historianët se beteja u zhvillua këtu apo atje, por në një gjë ato konvergojnë që të gjithë: ajo u zhvillua në Dibren e poshtme, në brigjet e Drinit të zi, në viset e Dinastisë së Kastriotëve".

Duke vazhduar idenë e tij mbi të cilën është realizuar në fakt përmendorja, Uzri Hoxha thotë se "në qendër të kësaj beteje qëndron figura legjendare e Skënderbeut, e cila veç të tjerave paraqitet me një ballinë të gjërë në kraharor si dhe elementët e kokës janë përfaqësuar me elegancë përmes dy brinjëve të përkrenares së famshme.

Gjithashtu, një element i rëndësishëm janë simbolikat e rezistencës shekullore përmes paraqitjes së bedenave-tipar dallues po thuaj i të gjitha kalave historike. Dy shpata të farkëtuara me tiparet e kohës, si armë tipike të asaj periudhe, paraqiten të kryqëzuara në gjoksin e përmendores si shenjë beslidhje për luftë si dhe të frymëzuara në kokë me shqiponjën dykrenare", thekson realizuesi artistik i veprës, Huzri Hoxha.

"Përmendorja është mbështetur në një bazament të gjërë, si element i qëndresës, dhe, për ta plotësuar misionin e kësaj përmendorje, u mendua dhe u vendosen katër pllaka të tjera guri të shkruara me momentet më të rëndësishme historike të krahinës, të cilat u vendosen në ngjitje, konformë kronologjisë së ngjarjeve, deri sa arrihet përballë përmendores".

"Përmendoren e shoqërojnë një sërë shkalloresh e sheshesh prej guri në një siperfaqe prej afro 80 m2, të cilat e plotësojnë më së miri kurorën e saj të vendosur në atë peisazh kodrinor", thotë Hoxha.

"Nëse do të kishin qenë burimet financiare më të mëdha, do të qe më mirë që përmasat e saj të ishin dy herë më të mëdha dhe atëherë ndërtimi mundej të realizohej me gurë të mëdhenj natyrorë të zonës. Megjithatë, u përdorën rrasa guri ngjyrë okër për tu përshtatur me gurin e vjetër arkeologjik, i cili është i zbuluar nga toka (dheu)", mbyll komentin e tij për përmendoren Huzri Hoxha.

(Vijon në faqen 6)

Në foto: Një foto pas përurimit: (Nga e majta në të djathtë) Ali Hoxha, Aranit Skepi, Muhamet Bitri, Sherefedin Shehu, Rajmonda Maleçka, Bilbil Bitri, Ruzhdi Lata dhe Hysen Repa. Foto: © Bujar Karoshi



KONTRIBUTORËT:

Abaz Deda	Haki Përnezha	Musa Riçku	Shefqet Hoxha
Albert Laçi	Hasan Bara	Mustafa Tola	Sheh Mehmeti
Ali Hoxha	Haxhi Krrashi	Medi Ajazi	Shemsi Prençi
Ali Koçeku	Haziz Sava	Nazmi Bushi	Ulsi Manja
Avdi Braka	Hysen Repa	Nazmi Çerpja	Uzri Hoxha
Bajram Krrashi	Ilber Koltraka	Përparim Noka	Vebi Gjeka
Bashkim Lleshi	Ilmi Dani	Rajmonda Maleçka	Xhafer Martini
Bujar Karoshi	Ilmi Loka	Ramazan Kaloshi	Xhelal Kukeli
Enver Kaloshi	Imer Bitri	Rruzhdi Bitri	Xhevdet Kacani
Faik Bruçi	Liman Hoxha	Sadin Bitri	Xhevdet Kariçi
Ferat Pali	Medat Zoku	Sali Tërshalla	Zabit Lleshi
Gani Braka	Mevlud Buci	Shaban Bitri	Zyber Gjoni
Hajredin Toca	Muhamet Bitri	Shaban Zhuka	

Shënim: *Për arsyen se disa kontributorë nuk dëshirojnë të deklarojnë shumën e dhuruar, renditja në këtë listë është bërë sipas rendit alfabetik. Shuma e mbledhur për lapidarin deri më tani është afërsisht 8.5 milionë lekë të vjetra, kështu që ftohen anëtarët e shoqatës dhe miqtë që t'i vazhdojnë kontributet. Për çdo kontribut shoqata lëshon një mandat arkëtimi.*

Fjala përshëndetëse e Gjeneral major Jeronim Bazo, Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë*

Dibra - djepi i Kastriotëve

Inderuar kryetar i shoqatës "Çidhna dhe Kastriotët" dhe të nderuar pjesëmarrës!

Ndjehem i keqardhur që e kisha të pamundur ti përgjigjesha ftesës suaj për të qenë i pranishëm në përurimin e përmendores kushtuar "Betejës së Torviollit dhe luftrave për liri e pavarësi", por çmoj thellësisht përpjekjen tuaj për të përjetësuar në vepër arti këtë moment të rëndësishëm në historinë e kombit tonë. Asnjë burrë i mençur e trim nuk mund të presë që historia ta çojë në të ardhmen, përkundrazi, - thotë Eisenhower, - ato e projektojnë të ardhmen.

Skënderbeu ishte njëri prej atyre burrave që i kontribuoi të ardhmes së historisë dhe jo vetëm për kombin e tij, por për një qytetërim të tërë, siç ishte dhe është ai perëndimor.

Ne, shqiptarët, ndjehemi të gjithë krenar për një fakt të tillë, por Dibra e në veçanti krahina juaj kanë një arsye më shumë për tu ndjerë krenarë, pasi janë djepi i Kastriotëve.

Kombet pa heronj janë të destinuar të vdesin. Dihet, dhe në fakt ndjehemi fatlum, që kombi ynë e pati dhe e ka Skënderbeun. Heronjtë nuk mund të jenë fizikisht të përjetshëm, por vepra e tyre është gjithmonë inspirim për brezat.

E tillë ishte edhe vepra e Skënderbeut. Pavarësisht viteve të errëta të sundimit otoman, kujtimi i Skënderbeut shërbeu për të mbajtur gjallë ëndrrën e shqiptarëve për pavarësi.

E ndërsa historianët me fakte, e penëartët me prozë kanë përjetësuar në letër veprën e Skënderbeut dhe të qindra burrave e grave të krahinës, kishte ardhur koha që një gjë e tillë të bëhej dhe me përmendore.

Nuk mund të mos vlerësoj dhe simbolikën që i jep kësaj ceremonie edhe koha e zgjedhur: nëntorit të parë të Skënderbeut dhe atij të dytë të Ismail Qemalit e Isa Boletinit, i shtohet ky nëntor i tretë i përmendores.

Ideatorët dhe ato që mundësuan kthimin e saj në realitet, i falënderoj që përjetësojnë historinë në monumente, për ne dhe brezat që vijnë.

Me përulje të thellë para veprës së heroit tonë kombëtar dhe heroizmit të burrave e grave të kësaj krahine që me gjakun e tyre shkruan historinë, si dhe me respekt e mirënjohje për ata që përjetësuan Betejën e Torviollit në monument,

** Kjo përshëndetje u lexua nga kolonel Bilbil Bitri.*



Në foto: Ndërsa shkrepen foto para lapidarit të sapopëruruar, grupi artistik "Çidhna dhe Kastriotët" jep një koncert artistik.
Foto: © B.Karoshi

Një **përmendore** për **Betejën e Torviollit** *dhe luftërat për liri*

(Vijon nga faqja 5)

Hysen Repa, ish ushtarak, e ka analizuar në një shkrim të botuar para pak muajsh në gazetën Rruga e Arbërit betejën e Torviollit. Duke komentuar betejën dhe përmendoren e ngritur me këtë rast, ai thotë se "570 vjet histori rezistencë, luftëra pa kompromis, gjakderdhje e mbijetesë është një historia e gdhendur në këtë përmendore lavdie". "Kjo përmendore e vendosur në Fushë-Alie, thekson Repa, nuk është vetëm e krahinës së Çidhnës. Aty janë mbledhur bashkë Nëntë Malet e Dibrës, Topalltia, Dibra e Madhe, Golloborda. Kjo është përmendorja e gjithë Luginës së Drinit të Zi, nga Struga deri në Shkodër. Ajo është dhe përmendorja e Kosovës, pasi në Fushën e Torviollit luftuan bashkë nën komandën e Skënderbeut, Topias, Muzakë, Dukagjini, Zaharia e dibranë". "Në këtë përmendore është dhe Aidin Muzaka, nipi i Skënderbeut (djali i motrës Jellës) që vdiq pas plagëve të marra në këtë luftë. Këtu janë burrat që bënë kuvendin te Ferra e Pashës, në Mazhicë e Gjoricë. Janë viktimat e burrave, grave nga e gjithë krahina e Kaonisë, që Sulltan Mehmetit i dytë i theri në grykën e Çidhnës, janë krerët e nëntë maleve dhe "parlamenti" i krahinës së Çidhnës. "70 shtëpitë e Has Përnezhës" janë ata trima që zbrapsen e thyen me dhjetëra pashallarë turq e pushtues serb e bullgarë".

Në këtë përmendore përkujtohen simbolikisht gjithë ajo histori e dhimbshme gjaku, por e lavdishme, thekson Hysen Repa, që të gjithë i thërrasin "Gjenerali", për shkak të karrierës së tij ushtarake. Në këtë përmendore janë kulmet e historisë së Dibrës si kalaja e Grezhdanit, Stelushit, Qaf Kalaja, Gjorica, Arrasi, Lanë Lura, Kalaja e Dodës, Grama e Korabi. Për 570 vjet këta trimëri u nderuan dhe u kujtuan odë më odë, në mort e dasmë, por pak u shkrua e pak u bë, thekson ai. Repa kërkon që njëkohësisht të nderohen edhe ata intelektualë, rilindas e të mëvonshëm, që dokumentuan këto përpjekje për liri e pavarësi në shekuj të gjithë kësaj treve.

Haki Përnezha, mësues, një nga mbështetësit e ndërtimit të përmendores, thotë se vendi i vendosjes së saj ka kaluar përmes debatesh, por në fund, demoratikisht është vendosur me votë. Kudo që të vendosej, prap do të kishte sugjerime të tjera. Hakiu është marrë edhe me studime mbi etnokulturën e krahinës, kështu që shpjegimin e tij e lidh edhe me legjenda dhe mite. "Vendi ku është vendosur lapidari është shumë pranë Ferrës së Pashës, vendit të besatimeve të shumta të të gjithë Dibrës që nga koha e Skënderbeut e deri më sot... Është afër atij vendi ku filluan dy beteja kunder serbit. Lapidari ndodhet përballë Kodrës Kanush (Canos), që do të thotë sipas Çabejt, Kodra e Bardhë. Poshtë lapidarit, vetëm 50 m larg, ndodhet Rrasa e Bolles, e cila sëbshku me atë që ndodhet afër Topuze, lidhen me legjenden se si një "...ordi turke që kish qenë e stacionuar në Shatorre të Topuze, zë një bollë të madhe dhe e sjell të trembë banorët e kësaj ane. Pas përleshjes që u zhvillua te Ferra e Pashës, bolla ikën nga mbajtësit e saj dhe largohet poreneve. Pas përfundimit të luftës banorët e gjejnë këtë bollë duke u ngrohe në diell tek rrasa poshtë shtëpisë seë Besim Bitrit, dhe që atëherë ai vend u quajt Rrasa e Bollës..."



Shpëtim Buci, mjeshtri i punimit të memorialit

"Shoqata kulturore "Çidhna dhe Kastriotët", thotë kryetari themelues i saj, Mustafa Tola, e ka patur që në themelim synimin për ta përjetuar këtë ngjarje. U deshën gati një vit përpjekje, diskutime, argumente historike dhe ide për ta përjetësuar. "E nisëm "pa një lek në xhep", projektet e para ishin modeste. "Shto ujë e shto miell" nga një projekt modest, përfundoi në një përmendore dinjitoze. Ju deshën ditë dhe muaj artistit Huzri Hoxha që të ulej në kompjuter dhe të bëjë me dhjetëra variante deri në atë përfundimtar. Së bashku me Ali Hoxhën kemi grisur e projekte pa fund të Huzriut, derisa arritëm në një version final.

Mustafai nuk harron të kujtojë dhjetëra takime, mbledhje, konsulta në kafe me anëtarë e miq të shoqatës, intelektualë e biznesmenë, për të bërë të mundur realizimin e kësaj vepre.

Ai thotë se kompleksi i përmendores ka kushtuar mbi 11.500.000 lekë dhe deri me tani, nga anëtarë dhe miq të shoqatës janë mbledhur rreth 800 000 lekë. Ai përmend për një kontribut të rëndësisshëm financiar në këtë proces Shaban Bitrin, Musa Rickun, Muhamet Bitrin, Huzri Hoxhën, Bashkinë Peshkopi dhe dhjetra të tjerë, të cilët bënë të mundur realizimin e këtij projekti. Tola thotë se disa punime për memorialin nuk janë kryer akoma ose disa punime nuk janë paguar, kështu që ftesa mbetet e hapur për ata që duan të kontribuojnë në këtë proces."

"Shoqata "Çidhna dhe Kastriotët" nuk e ka përfunduar detyrën e saj, thotë ai. Ajo do të vazhdojë në nxitjen e mëtejshme dhe përfshirjen e historianëve për argumentin e ngjarjeve historike të Dibrës nëpërmjet sesioneve shkencore dhe propozimin që duhet t'ua drejtojmë institucioneve vendimmarrëse, që datën 29 qershor ta kthejmë në një festë lokale, në kujtim të kësaj beteje të njohur të kohës.

Punimet e firmës i ka kryer firma ndërtuese me president Baudin Ramën, ndërsa një pjesë të madhe të punimeve i ka kryer Shpëtim Buci dhe Xhevat Marku, specialistë të njohur në Fushë Alie. Punimet nisën në fund të shtatorit dhe brenda një kohe të shkurtër u bë e mundur realizimi i saj. Gdhendjet e gurëve dhe shqiponjës janë bërë nga djali i Shpëtimit, Besmiri, një artist i vërtetë dhe duarartë.

Grupi folklorik "Çidhna dhe Kastriotët" drejtuar nga Haki Përnezha dhe grupi i shoqërisë kulturore -artistike Komaran - Drenicë dhanë në fund të veprimtarisë një koncert më këngë e valle patriotike.

* * *

Vendi ku është vendosur ky memorial vazhdon të ketë akoma diskutime, të cilat nuk do të mbarojnë kurrë, ashtu siç vazhdon edhe debati nëse ajo betejë e madhe është zhvilluar në këto anë apo jo. Por e rëndësishme në këtë proces mbetet dëshira e banorëve për të mos e harruar historinë, jo vetëm se na bën krenar për origjinën tonë, por edhe se na bën të vetëdijshëm se ajo që po bëjmë për vendlindjen është shumë më pak se gjaku i derdhur në beteja.

Dhe ky memorial do t'na e freskojë kujtesën çdo herë kur ta vizitojmë ose kur të dëgjojmë e lexojmë për të.

Kjo **përmendore** *na kujton se të parët tanë këtë* **truall** *e kanë mbrojtur* **me gjakun** *dhe jetën e tyre*



Nga **ALI HOXHA**

Trualli ynë arbëror, në këtë pikë strategjike të globit tokësor, ka qenë gjithmonë shesh betejash ndërmbjet Lindjes dhe Perëndimit.

Kjo përmendore, simbol i rezistencës në shekuj të popullit të krahinës së Çidhnës e të mbarë Dibrës, në luftrat e tij të pandërprera për liri e pavarësi kundër pushtuesve të të gjitha kohërave, kryesisht kundër pushtuesve të epokave të fundit, si ndaj atyre osmanë për rreth 600 vjet pa ndërprerje, duke filluar që nga koha e Skënderbeut e deri në vitin 1912; kundër pushtuesve të mëpasëm serbo-sllavo-maqedonë, dhe atyre austriakë gjatë viteve 1913-1921, përfshirë këtu Luftën e Parë Botërore, si dhe ndaj pushtuesve të fundit nazifashistë gjatë Luftës së Dytë Botërore (1939-1944) , ngrihet këtu në qendër të Dibrës së Poshtme në Fushë të Çidhnës, pikërisht atje ku quhet "Ferra e Pashës", ku 570 vjet më parë, më 29 qershor 1444, u zhvillua beteja e parë e ushtrisë kombëtare shqiptare, të komanduar nga Skënderbeu, ushtria e shtetit të parë kombëtar shqiptar, të dalë nga Kuvendi i Lezhës i 2 marsit 1444, e cila ka hyrë në histori me emrin "BETEJA E TORVIOLLIT". Ajo betejë shënon, njëherësh, edhe fitoren e parë të Skënderbeut kundër ushtrisë së superfuqisë më të madhe botërore të asaj kohe, Perandorisë Osmane. Ushtria osmane prej rreth 25.000 kalorësish u shpartallua plotësisht, ndërsa komandanti i saj, Ali Pasha, shpëtoi gjallë duke u fshehur në një ferrë, prej nga ku më pas lindi toponimi "Ferra e Pashës".

Fakti historik që pikërisht këtu në Çidhën të Dibrës së Poshtme, ku janë origjina, trojet dhe gjaku e farefisi i Skënderbeut, përbën argument se nuk ka qenë e rastit planifikimi që nga Stambolli, për ta filluar sulmin e parë ushtria osmane kundër shtetit shqiptar të formuar nga Skënderbeu, si dhe fakti tjetër, në gusht të vitit 1466, kur ushtria osmane prej rreth 200.000 forcash, e komanduar nga vet Sulltan Mehmeti i dytë në rrethimin e Krujës, në pamundësi për të pushtuar Kalanë e Krujës, gjatë tërheqjes për në Stamboll, Sulltani e ndërroi drejtimin duke bërë një kthim nga Elbasani dhe u kthye mbrapsht deri në Dibër të Poshtme, në skajin më veriperëndimor të saj, këtu në Çidhën dhe, për të shfryrë inatin dhe urrejtjen ndaj Skënderbeut, bëri një masakër të tillë, që në histori ka hyrë me emrin "Masakra e Çidhnës", duke vrarë mbi 10.000 gra, fëmijë e pleq të strehuar në qytetin e Çidhnës, në Çidhën të Poshtme të sotme. Emri i Dimitër Kastriotit, si banor i Sinës së Poshtme në Defterin kadastral të vitit 1467, vërteton katërcipërisht jo vetëm origjinën e Skënderbeut në këtë krahinë, por edhe praninë e njerëzve të gjakut e të fisit të Kastriotëve këtu, në Çidhën.

Nisur nga fakti se zhvillimi i betejës së parë ndërmjet ushtrisë kombëtare shqiptare të komanduar nga Skënderbeu dhe ushtrisë së Perandorisë Osmane, betejë e cila në histori njihet me emrin BETEJA E TORVIOLLIT, me vendin se ku u zhvillua ajo betejë, ka lidhje dhe përbën argument lidhur me origjinën dhe trojet e Skënderbeut e të Kastriotëve, si dhe për faktin se sot nuk ekziston asnjë vend që të njihet me emrin "Torvioll"; së dyti, nisur nga disa mospërputhje për çështje të vogla anësore me ndonjë toponim, qoftë edhe për ndonjë "lapsus" (gabim shtypi), siç është rasti kur ndonjë historian, nga të hershmit, si Biemi, i cili ka përmendur gabimisht lumin Shkumbin (Scambino) në vend të lumit Drin, i cili kalon përmes gjithë trevës së Dibrës, disa studiues të ndryshëm të kohës sonë, nisur dhe nga ana emocionale dhe interesa lokale, kanë shfaqur pikëpamje të ndryshme të cilat janë shumë larg së vërtetës lidhur me lokalizimin e vendit se ku u zhvillua Beteja e Torviollit.

Qysh në vitin 1979 në studimin me titull "Mbi lokalizimin e fushës së Betejës së Torviollit" botuar në revistën e Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë "Studime Historike" Nr.3, viti 1979, është argumentuar shkencërisht dhe përfundimisht se "... beteja e parë e ushtrisë shqiptare, e komanduar nga Skënderbeu, kundër ushtrisë osmane, me 29 qershor 1444, e njohur me emrin "Beteja e Torviollit", është zhvilluar këtu, në Fushën e Çidhnës, në Dibrën e Poshtme".

Për pasojë dy hipotezat: se ajo betejë na qenka zhvilluar në Domosdovë të Prrenjasit, gjithashtu dhe hipoteza e dytë, se ajo betejë është zhvilluar në Fushë të Bulqizës, në Valikardh, që të dyja janë të pasakta.

Dokumenti kadastral "Defteri emëror i vilajetit të Dibrës i vitit 1467", sipas të cilit vërtetohet se ndarja mesjetare e Dibrës, në Dibër e Epër dhe në Dibër e Poshtme, me kufij konvencionale Kodrat e Çenokut dhe Gurrën e Mazhicës, përputhet plotësisht me ndarjen e kohës sonë të Dibrës me të njëjtët kufij, i ka asgjësuar që të dyja ato hipoteza, së bashku me lapidarët e tyre, thënë me një term sportiv, i ka nxjerrë në "pozicion jashtë loje", sepse ata për të përligjur hipotezat e tyre, përcaktonin lumin Drin si kufi ndërmjet dy Dibrave.

Prandaj, në këtë këndvështrim, ashtu siç e kam thënë edhe më parë në një kumtesë, referuar në një sesion shkencor në Peshkopi, me 6 maj 2008, kam kërkuar, dhe e përsëris edhe sot këtu, duke iu drejtuar autoriteteve kompetente të rretheve Dibër dhe Bulqizë, se "përmendores që është ngritur në Fushën e Valikardhit, t'i ndërrohet pllaka, në të cilin është shënuar "Beteja e Torviollit" dhe ajo të zëvendësohet me një pllakë tjetër, në të cilën të shënohet një nga betejat e tjera të zhvilluara nga Skënderbeu në atë krahinë, konkretisht, Beteja e vitit 1465.

Kjo përmendore do t'u shërbejë brezave në vazhdim si pikë referimi për t'u kujtuar atyre se të parët tanë, këtë truall e kanë mbrojtur me gjakun dhe jetën e tyre.

Tani, në kohën tonë, për aq kohë sa Shqipëria është e anëtarësuar në NATO, integriteti territorial i saj është i garantuar nga ndonjë sulm i mundshëm nga jashtë, por në sistemin e sotëm botëror të ekonomisë së tregut është krijuar një sistem i ri, ai i pushtimin ekonomik, e thënë ndryshe, globalizimi. Në këtë kontekst lind natyrshëm pyetja nëse banorët e sotëm të pellgut të Dibrës, në të dy anët e Drinit, a do t'ua falin Dibrën dhe gjithë historinë e saj firmave të huaja të ndërtimit të hidrocentraleve që kanë vërshuar në Shqipëri këto dekadat e fundit, të cilat, për interesat e tyre pragmatike, synojnë ta asgjësojnë edhe Dibrën për ta fundosur përjetësisht nën ujë, me çmimin qesharak "Shqipëria një Euro".

**Fjala me rastin e përurimit të Përmendores kushtuar Betejës së Torviollit, Laçes, 23.11.2014*

aktualitet

HIDROCENTRALI I VALIKARDHËS, REAGON KRYETARI I KOMUNËS ZERQAN, DEFRIM FIKU

Nuk rrezikohet Liqeni i Zi!



"Hidrocentrali do të sjellë të mira për ekonominë lokale. Ndërtimi i tij nuk është më një çështje e komunës, por e institucioneve të larta qeveritare. Nuk ka pasur "ndëshkim" me taksa për asnjë protestues. Vaditja e tokave është e garantuar".

Nga **BUJAR KAROSHI**

Pas shkrimit "Valikardha, fshati i trazuar nga ndërtimi i një hidrocentrali: Liqeni i Zi "nxin" mbi të ardhmen e Zerqanit, botuar në gusht 2014 në gazetën Rruga e Arbërit, ka reaguar kryetari i Komunës së Zerqanit, Defrim Fiku.

Gjatë një bisede me të, ai ka shpjeguar se nuk është dakord me shumë gjëra në shkrim. Shkrimi bazohet mbi disa deklarime të banorëve, por, sidomos pjesë ku flitet për kryetarin e komunës, janë krejt të pavërteta.

"Unë nuk kam vendosur asnjë gjobë për asnjë individ apo biznes që ushtron veprimtarinë në komunën e Zerqanit", - thotë Fikut. Ai tregon një fotokopje të një njoftimi për shlyerje taksash dhe tarifash ndaj subjektit "Xhemal Toska - përpunim druri". "Në shkrim bëhet fjalë se këtij subjekti i janë dërguar taksat për këtë vit në shumën 1.2 milionë lekë të vjetra. Siç tregon edhe kjo shkrese, ky subjekt i detyrohet Komunës Zerqan shumën prej 110.750 lekë, dhe në këtë shumë janë të gjitha taksat e pastrimit, ndërtesës së biznesit, taksa e tabelës dhe tatim fitimit të papaguara që nga viti 2007 e deri më sot. Të gjitha këto taksa për këtë subjekt kanë qenë mesatarisht 15.500 lekë në vit dhe gjatë këtyre tetë viteve ai nuk ka derdhur asnjë taksë në zyrën e financave të komunës".

"Ndërtimi i hidrocentralit nuk është më një çështje e komunës, por është një çështje e institucioneve të lartë të qeverisë dhe ministrive përkatëse", - thotë Defrim Fiku.

"Ndërtimi i Hidrocentralit nuk është një vendim i Komunës, por është një vendim i institucioneve qeveritare, dhe unë si drejtues i Komunës dhe Këshilli Komunal e kemi mbështetur ndërtimin e tij, pasi Hidrocentrali do të sjellë vetëm të mira për komunitetin".

"Shqetësimi i një pjesë të banorëve, - thotë ai, ka të bëjë me ruajtjen e rezervave ujore për vaditje si dhe ruajtjen e pyjeve nga prerja dhe dëmtimi. Me ndërtimin e këtij hidrocentrali, deri më tani, të gjitha punimet kanë treguar se këto do të jenë të garantuara".

"Nuk do të ketë ndërprerje të ujit të vaditje dhe pyjet nuk do të priten, por vetëm do të shtohen. Firma ndërtuese do të rikuperojë çdo dëm të shkaktuar gjatë punimeve. Ndërsa lidhur me postobllokun që është në rrugën për nga Liqeni i Zi, është një masë e domosdoshme, e cila i ka dhënë efektet e veta në ruajtjen e mjedisit natyror në zonë", - thekson gjatë një bisede të drejtpërdrejtë Defrim Fiku.

Fiku, i cili do të mbahet mend edhe për faktin si kryetari i fundit i komunës së Zerqanit, për shkak të reformës së re territoriale, - thotë se procesi ka qenë transparent dhe është shoqëruar vazhdimisht me debate. "Ne kemi qenë në çdo rast si mbrojtës të së mirës së komunitetit, por jo gjithmonë kemi qenë të lirë të kryejmë detyrat që na janë caktuar me ligj".

"Nuk është në natyrën time dramatizimi i gjërave, por po ju njoftojmë që po përjetojmë terror, shkatërrime të pronës dhe të investimeve, kërcënime deri në jetë, gjëra pra që Komuna Zerqan, e dalluar për qytetari



Në foto: Defrim Fiku. Lart: Pamje e fshatit Valikardhë ku po ndërtohet hidrocentrali

e tolerancë nuk i ka përjetuar asnjëherë", - ka shkruar ai në një letër drejtuar komisariatit të policisë së Bulqizës, drejtorisë së policisë së Qarkut Dibër, Drejtorisë së Pushtetit Lokal, Prefektit të Dibrës dhe për dijeni Ministrit të Brendshëm, Sajmir Tahiri.

"Shkatërrimi i një investimi të huaj që po ndërtohet në fshatin Valikardhë të komunës Zerqan, rrethi Bulqizë, nga disa banorë të këtij fshati, që për fatkeqësinë tonë të përbashkët, po veprojnë ditën me diell, sikur këtu nuk ekziston shteti dhe strukturat e tij. Kjo situatë përbën shqetësim që i kalon kufijtë e Komunës Zerqan dhe Qarkut Dibër", - vazhdon letrën kryetari i Komunës.

Në letër, ai shkruan se "ka vënë re indiferencën e strukturave të policisë në këtë proces, madje edhe duke u bërë palë me disa banorë, duke nëpërkëmbur kështu, sipas tij, dinjitetin e institucioneve".

"Nuk ka si shpjegohet kërcënimi deri me jetë i Kryetarit të Komunës, presioni që ju bëhet anëtarëve të Këshillit Komunal, punonjësve të administratës, e deri te dhuna fizike e ushtruar ndaj Përgjegjësit të Zyrës së Shërbimeve, të cilit, disa persona, pas të cilëve nuk dihet se kush fshihet, i kanë dalë edhe në rrugë dhe, përveç dhunës fizike i kanë shkatërruar edhe makinën. Policia bën indiferentin ose bën sikur ndërmerr veprime", shkruan ai në kërkesën për ndërhyrje dërguar institucioneve të lartpërmendura më 16 qershor 2014.

"Janë mbi dhjetë denoncime të subjektit ndërtues dhe një nga ana e punonjësit të komunës për goditje për shkak të detyrës dhe punonjësit e policisë nuk veprojnë sipas ligjit, duke ngjallur dyshime se pas strukturave që duhet të merren me çështjen, fshihen synime të grupeve të caktuara".

"Në qoftë se strukturat shtetërore nuk marrin masa për mbrojtjen e institucionit të komunës dhe administratës së saj, nuk ushtrojnë kompetencat e tyre në mbrojtje të ligjit, atëherë do të mblidhet Këshilli i Komunës dhe do të marrë masa, deri në pezullimin e shërbimeve për qytetarët", mbyll letrën e tij Kryetari i Komunës së Zerqanit, Defrim Fiku.

Po me këtë datë, në shkresën me nr. prot. 3566, zëvendësministri i Energjisë dhe Industrisë, z. Ilir Bejtja, në një shkresë drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, thekson nevojën për mbështetjen për ndërtimin e HEC-eve "Tërnovë" dhe "Zalli i Bulqizës" në Komunën Zerqan.

"Sipas shoqërisë "Teodori" sh.p.k. vlera e investimit të realizuar deri më sot arrin në 14 milionë euro, ku janë ndërtuar godina e HEC-it, janë montuar turbinat dhe gjeneratori, është ndërtuar diga për liqenin e Fushës së Zogut, e cila do të shërbejë vetëm për vaditjen e tokave bujqësore, por muajt e fundit protestat në këtë komunë kanë qenë të vazhdueshme duke penguar ecurinë e projektit si dhe duke shkaktuar dëme financiare", thuhet në letrën e zv.ministrit Bejtja.

"Sipas shoqërisë, vazhdon ai, këto veprime kanë arritur kulmin në datën 09.06.2014, ku është tentuar t'u vihet flaka kamionëve, të cilët sillnin tubacione për projektin, makinerive si dhe të organizohej një revoltë duke djegur kantierin e rrezikuar jetën e personelit. Gjithashtu është prishur postblloku i Liqenit të Zi dhe është goditur roja e shkatërruar vendroja e këtij objekti të rëndësisë së veçantë."

"Në këto kushte, kërkojmë mbështetjen tuaj për sigurinë e jetës së punonjësve dhe për vazhdimin normal të punës në këtë objekt, për përmbushjen e detyrimeve të kontratës koncensionare dhe mbrojtjes së investimeve të huaja që po kryhen për realizimin e këtij projekti", mbyll shkresën zëvendësministri i Energjisë dhe Industrisë, Ilir Bejtja.

Rreth një muaj më vonë, më datë 8 korrik 2014, me shkresën nr.prot. 4076/1, është vetë Ministri i Energjisë dhe Industrisë, z. Damian Gjiknuri, që i drejtohet Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë që të marrë në mbrojtje dhe të garantojë vazhdimin e investimit në hidrocentralin e Valikardhës.

"Ndërtimi i këtyre HEC-eve po realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, në respekt të të gjithë kërkesave për mbrojtjen e ambientit dhe, ndër të tjera, edhe në përmirësim të plotësimit të nevojave për ujë të pijshëm dhe për bujqësinë", thekson ministri Gjiknuri.

"Kohët e fundit, vazhdon shkresën ai, nga ana e shoqërisë koncesionare dhe organeve të qeverisjes vendore, pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, janë ngritur shqetësime për problemet e krijuar ndërmjet komunitetit të banorëve të fshatrave Valikardhë dhe Strikçan të Komunës Zerqan në rrethin e Dibrës dhe vetë shoqërisë, për të cilat jeni vënë në dijeni.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në rolin e Autoritetit Kontraktues dhe përgjegjës për zbatimin e detyrimeve në emër të Qeverisë Shqiptare, është angazhuar, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme për të trajtuar dhe zgjidhur të gjithë problemet e akumuluara deri më tani.

Por me kushtet e krijuara kohët e fundit aktiviteti normal i shoqërisë koncesionare është cenuar dhe për pasojë në bazë të Marrëveshjes Koncesionare Qeveria Shqiptare mund të pësojë penalitete me kosto të lartë financiare", mbyll shkresën ministri Gjiknuri.

***

Nga Valikardha nuk ka pasur lajme muajin e fundit. Duket se situata është qetësuar dhe banorët dhe firma ndërtuese kanë mundur të gjejnë pika bashkëpunimi. Por nëse Liqeni i Zi rrezikohet apo Liqeni i Fushës së Zogut do të mjaftojë për vaditje, vetëm koha do ta tregojë.

Ndërtimi i një hidrocentrali në Valikardhë dhe dhjetëra të tjerëve në Dibër do të jenë gjëra të mira për ekonominë lokale, por ato do të jenë edhe më efektive kur të respektojnë natyrën, tokën bujqësore, pyjet, ujërat. Kështu do të jetë mirë për të gjithë. Në qoftë se tokat rrezikohen nga thatësira dhe pasuritë natyrore shkojnë drejt degradimit, atëherë është ë nevojshme që institucionet të ndëshkojnë ata që i kryejnë këto masakra mjedisore, pavarësisht kush investon dhe nga vjen investimi.

Rruga e Arbërit nr. 103

Refleksion rreth lajmit mbi mbylljen e Filialit të Peshkopisë të Universitetit "Aleksandër Moisiu"

opinion

Filiali që "u mbyt" në baltën që krijoi vetë

Nga **HYSEN UKA**
pedagog

Përtej marrëdhënieve personale që kam pasur me Filialin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Peshkopi, lajmi për ndërprerjen e veprimtarisë së tij, në përfundim të semestrit të parë të vitit akademik 2014-2015, më trishtoi së tepërmi.

Është i kuptueshëm trishtimi im për gjithkënd që ka ushtruar ndonjëherë detyrën e pedagogut, për çdokënd që ka pasur marrëdhënie me auditorin dhe veçanërisht për çdokënd që ka provuar vëmendjen dhe respektin e studentëve. Në aq kohë sa unë e kam kryer punën e pedagogut, kënaqësia që më kanë krijuar këto marrëdhënie dhe eksperienca ime si pedagog do të mbeten për gjithë jetën e pashlyeshme. Studentët, kudo-qofshin dhe të çfarë do niveli qofshin ata, e ndjejnë efektin e të thirrurit si të tillë, dmth të thirrurit student dhe me të gjithë qenien e tyre përpiqen ta paraqesin e ta manifestojnë atë, në të gjithë diapazonin e marrëdhëniet shoqërore, familjare, qytetare etj.

PEDAGOGËT, TË PARËT QË NDIHMUAN DËSHTIMIN

Nëse gjendja e arsimit te lart në vendin tonë u rrëzua aq keq, e gjithë përgjegjësia është në radhë të parë e atyre që ishin vënë në krye të punës për ta ngritur lart këtë sistem, përgjegjësia është e pedagogëve. Dhe kur them pedagogët, këtu kam parasysh të gjithë prerjen e hierarkisë, në radhë të parë rektorët, dekanët, shefat e departamenteve, të cilët, në të shumtën e rasteve, të parët dhanë modelin e përdorimit të personalitetit dhe të autoritetit të pedagogut për të bërë para. Rasti i një rektori me 9 lista pagesash shtangu të gjithë opinionin qytetar, por jo atë vetë. Ai ende sot e kësaj dite e ka gëlltitur me heshtje e shpërfillje çdo akuzë të mediave dhe të opinionit. Kur hierarku i rektorateve nuk shqetësohet, nuk zverdhet dhe as nuk skuqet nga lumi i akuzave në drejtim të tij, nuk mund të presim sjellje e qëndrim tjetër nga hallkat përbërëse të sistemit. Të gjithë hallkat tjera gradualisht u përkulen dhe u thyen para këtij realiteti, ndaj kemi situatën që tashmë njohim të gjithë, një sistem të arsimit të lartë kombëtar thuajse të rrënuar.

Konformizmi, mungesa e kurajos, ngushtimi i lirisë në marrëdhëniet ndër akademike, është fatalitet për të gjithë shoqërinë, është fatalitet për të ardhmen e demokracisë dhe të përparimit të vendit. Sigurisht, në një realitet të tillë kur është virusuar i gjithë sistemi, nuk mund të pretendojmë puritanizm në Filialin e Peshkopisë. Për dekanë, shefa departamentesh dhe pedagogë makutë, tregohen shembuj e barsoleta pa fund nga studentë e prindër, jo vetëm në Dibër, por anekënd Shqipërisë. Por pasojat nuk janë të njëjta. Nëse një virus i rrezikshëm, një të rrituri i rëndon gjendjen shëndetësore, një të sapolinduri i rrezikon jetën, e vdes atë, nëse nuk ka njeriun e duhur, përkujdesin prindëror për ta mbrojtur e shpëtuar. Dhe ky fat i keq, fati i fëmijës që mbeti në dorë të njerkës, i qëlloi të parës foshnje të arsimit të lartë në qarkun e Dibrës, Filialit të Peshkopisë.

A KANË FAJ STUDENTËT?

Etheksoj edhe një herë se për të gjithë këtë situatë, për këtë rrëzim e gërmisje, faji nuk është aspak i studentëve, qoftë edhe i atyre që kanë shkelur në atë prag (pragun e Filialit), pasi kanë kaluar arsimin e mesëm nga dritarja! Edhe ata meritojnë respekt e



Në foto: Lule për Shën Valentin para hyrjes së Universitetit: © Foto: www.facebook.com/PeshkopiDiberAlbania

vëmendje, edhe ata duheshin ndihmuar e shtyrë përpara, (Jam i sigurt se ata e vlerësojnë më së shumti përpjekjen dhe çdo gjest mirëdashje të pedagogut. Kam raste të shumta për këtë) nuk duhen poshtëruar e të shiheshin si pré, si preja më fatkeqe, më e pambrojtur, duke i marrë peng me pamundësinë dhe dobësinë e tyre e më pas duke e shkarkuar gjithë përgjegjësin e dështimit mbi ta. Unë e kam bindje se të gjithë studentët, pa përjashtim janë të mirë, por midis tyre ka shumë të mirë dhe të talentuar. Por vetëm të talentuarit dhe shumë të mirët nuk mund ta mbajnë të vetëm mbi shpatulla as peshën dhe as përgjegjësinë e zhvillimit e të progresit të Shqipërisë. Edhe nëse sot kemi të ashtëquajtur studentë me dobësi, korrim pikërisht atë që kanë mbjellë kolegët tanë në gradët e mëparshme të formimit arsimor të këtij brezi.

Dhe në rastet më rudimentale, të thirrurit e dikujt "student" ka efekt në personalitetin, sjelljen dhe tërë qenien e çdokujt. Veçanërisht ky efekt është i magjishëm, bën mrekulli tek ata që mantelin e studentit e meritojnë përmes përpjekjesh e rezultatesh nga një nivel arsimimi në tjetrin.

Student të tillë, me shumë ëndrra e pasion për mësim e shkencë gjenden kudo, por unë e kamë të njohur personalisht këtë fakt fatlum, dëshirën dhe pasionin e madh të brezit të ri e të mbarë shoqërisë arsimdashëse të Dibrës. Ky fakt ka qenë shtysa që në kuadrin e hapësirave të reja që krijonte ligji për reformimin e sistemit të arsimit të lartë në Shqipëri, një grup intelektualësh strukturuam dhe i shërbyem fort, nismës për hapjen e një institucioni të arsimit të lartë në qarkun e Dibrës, institucion publik apo privat, por që do t'i përgjigjej nevojave dhe kërkesave të këtij mjedisi social-kulturor për stade të reja arsimimi.

NISMA QYTETARE, HAPJA E UNIVERSITETIT DHE ANGAZHIMI I MUNGUAR

Vendimi i KM, të 5 gushtit të vitit 2009, përtej çdo simpatie e lenteje politike, na ngazëlleu dhe na frymëzoi pa masë, për t'iu përkushtuar ngritjes së një institucioni serioz të arsimimit e të kërkimit shkencor në Dibër. Këtu është vendi që unë, personalisht, të përmend e t'i shprehim mirënjohjen të thellë, intelektualit, profesorit, dibranit të mirë Agim Kukeli, i cili me mprehtësinë, vullnetin e tij të mirë dhe dashurinë për Dibrën, vlerësoi në kohë të gjithë kushtet dhe rrethanat, sociale, juridike, politike, përfshirë edhe nismën tonë qytetare dhe, duke përdorur autoritetin e tij shkencor dhe administrative, ndikoi te Qeveria shqiptare të marrë vendimin për hapjen e Filialit të Universitetit "A. Moisiu" në Dibër. Me largimin e profesor Kukelit nga drejtimi i UAMD, edhe për Filialin e Peshkopisë erërat frynë në krah të kundërt. Se si e çfarë ndodhi nuk është vendi këtu për enumeracine faktesh e fajesh, kur në dorë kemi "vendimin e ekzekutimit të Filialit".

Dhe t'i "këndosh" vendimin këtij qyteti, këtyre studentëve, prindërve të tyre, nxënësve që ëndërronin të ishin nesër studentë në ato auditore, në institucionin e tyre të arsimit të lartë, është si t'i prekësh në zverk me tehun e ftohtë të thikës. Lajmi për shuarjen e kësaj vatre të parë të arsimit të lartë në Dibër vjen pikërisht atëherë kur shumë nga ne shpresonim të angazhoheshim e të punonim fort në rilindjen e vërtetë të këtij institucioni, në shndërrimin e tij në një qendër iluminimi shoqëror e përparimi ekonomiko-kulturor, për një nga rajonet më të margjinalizuarta të vendit, mbi të cilin kanë rënduar e lënë gjurmë të gjitha shkreptimat e historisë sonë të rrëmetshme. Dhe, nëse një ditë ky rajon do të prosperojë, kjo do të vijë vetëm përmes rritjes së nivelit e cilësisë së arsimimit të shoqërisë në tërësi, i prirë nga elitat e krijuara nga ky sistem.

"PEDAGOGË A GJAHTARË!"

Në këto sa shtrova në asnjë rast dhe në asnjë aspekt nuk rrekem të justifikoi gjendjen në të cilën kishte rrëshqitur vit pas viti ky Filial. Tashmë është e njohur nga të gjithë se aty problemet kanë qenë të shumta e të gjithanshme, por në asnjë rast nuk kanë qenë për fajin dhe përgjegjësinë e studentëve dhe të prindërve të tyre, taksapagues që kanë mbajtur mbi shpatulla dhe kanë paguar shtrenjtë për një projekt surrogato, për një aspiratë arsimimi, që e dëshironin dhe e ëndërronin aq shumë, por që përkundrazi u shpërdorua e u përdhos keqas nga politizimi e provincializmi deri në dështim. I parë pa emocion dhe me gjakftohtësi, performanca e këtij institucioni, pra e Filialit, e kish ngarkuar vetë në derën e tij, kryqin e mbylljes. Një institucion ku vërshimi i madh i studentëve (rreth 4500), përdorej nga një pjesë e konsiderueshme e të ashtquajturve pedagogë, gjahtarë të sprovuar të lekut, si një pyll ku mund të ngrije leqe e të gjuaje gjithçka dhe çfarë të duash, pa paguar dhe pa dhënë askund llogari. Dhe s'kish si të rridhte ndryshe fati i këtij Filiali, kur "nderi i të qenit pedagog", rekomandohej nga zyrat politike lokale, për nëpunës të administratës vendore, pa grintë e nojmë jo më për pedagog, por as për nëpunës të thjeshtë komune. U rekrutuan në staf njerëz "pa shpenzime", që ishin të aftë të krijonin të vetë të ardhura, për vete dhe për "shefat", njerëz që, pasi varnin në kunj kapelen e doganierit a të llogaritarit në institucionet vendore, vishnin mantelin e pedagogut, duke krijuar në të vetmen shëtitore të Peshkopisë, paradën më karnavaleske të asaj larushie burokratiko-akademike, që ditë pas dite humbiste edhe dukjen edhe përmbajtjen, gjersa u shndërrua në një batak, në një baltë e bërllog, ku duhet të përvishte duart për të bërë punën e saj policia.... Atëherë kish ardhur fryma e fundit, vdekja e Filialit, dhe e këtij projekti....

Këtë fund, këtë funeral e kishin e kishin përgatitur ditë pas dite, ata të ashtuquajturit pedagogë, që nuk kishin dëshirë e as kohë për të qenë më parë se mësimdhënës, nxënës e studiues të pa epur, aktivë në tribunat e mendimit e të nxitjes së ideve, të pranishëm në shtyp e në debatet elitare, që shtynë shoqërinë përpara me idetë e projektet e tyre kërkimore.

Larushia e prurjeve dhe eksperiencave, e formimit dhe përvojat, valenca të ndryshme morale, profesionale dhe e interesave, e perceptimeve për institucionin dhe arsimin e lart në tërësi, nuk lejuan që këto vite të funksionimit të Filialit, të krijohej një kastë pedagogësh dhe personalitetesh të denjë dhe në nivel , për të krijuar akademizëm.

Sjellja e vrazhdët me studentët, trajtimi i tyre pa kujdes e respekt, mungesa e besimit, shpërfillja e aftësive dhe kapacitetit të tyre, manifestimi i mendësive provinciale të nëpunësisë lokale, prepotente dhe të prapambetur, e kthyen gjithçka me kokë poshtë në këtë institucion. Gradualisht gjendja ishte rënduar. Pedagog të skeduar, të hetuar e deri të ndaluar për pazare e shitje notash, pra, për këto e shumë e shumë fakte, që me kohë kanë kërkuar analiza e masa të duhura, të gjithë vijnë në qëndrimin se ashtu si ishte gjendja në atë institucion, nuk mund të vazhdohej më. Filiali kish mbytur veten në baltën që kishte krijuar vet.

Këto ditë ka pasur edhe disa protesta nga studentët në qytetin e Peshkopisë, që kërkojnë anulimin e vendimit për ndërprerjen e veprimtarisë së Filialit. Kemi parë studentë "jetim", por jo pedagogët a thua se interesat e tyre nuk kanë as një pikë përkimi... Kemi parë edhe pedagogë që e ndiqnin protestën nga pas xhameve të kafeneve, por jo aty ku kanë vendin, në krye të studentëve... Tinëzisht, dikush nga këto të ashtëquajtur pedagogë, u kujton studentëve se ai e ka të zgjidhur punën e tij, se fundja fundit vendin e mësuesit e ka të sigurt, por ju duhet "të protestoni kundër paudhësisë së Rilindjes, që e ka me sy të keq Dibrën..." →

arsim



Studentët e Peshkopisë: Mos e mbyllni Universitetin!

Ne duhet të luftojmë për të pasur një institucion të arsimimit të lartë në Dibër, në themel të të cilit do të derdhet kontributi akademik i mbi 150 profesorëve e pedagogëve dibranë, që kanë rrezatuar dije e kompetencë akademike në universitete e qendra kërkimore e shkencore në Shqipëri e në botë. Këta personalitete kanë shprehur vullnet për të kontribuar për Filialin e Peshkopisë, por janë ndeshur në heshtje, shpërfillje, mungesë respekti e injorim. Tashmë është radha të nisim betejën ne, që kemi qëllim iluminimin shoqëror dhe përparimin e Dibrës. Ne duhet të luftojmë fort për të pasur jo një Filial, por një Institucion të Arsimit të Lartë, në kapacitete reale me qëllime e objektiva të menduara mirë e mbi kritere shkencore. Kjo është një ftesë për të gjithë ata që ndjejnë vërtetë dhimbje për dështimin një institucioni arsimor, si Filiali...

→ STUDENTËT DHE PROTESTA

Në të vërtetë, a duhet të protestojnë studentët? A është e drejtë protesta e tyre?

Për të gjitha dilema ka vetëm një përgjigje: Po! Studentët që nuk ngrenë krye kundër padrejtësisë, në mbrojtje të lirisë dhe dinjitetit të tyre, nuk e meritojnë emrin student. Studentët, shpirti i lirisë dhe i protestës janë sinonime, nënkuptojnë njëri-tjetrin.

Por pyetjes: a janë në kohë këto protesta? Do t'i përgjigjeshim me dëshpërim: janë shumë të vonuara, aq vonë, sa tashmë dëmi është kryer... Këto protesta duhet të kishin filluar shumë më herët, që atëherë kur pedagogët e tyre, i fyenin, i shpërfillnin, i rripnin duke u shitur nota... Kur në mjediset e Filialit ngriheshin zyra të forumeve rinore të një partie politike, kur detyroheshin të votonin për një subjekt e të refuzonin një subjekt tjetër, kur për një miting i nxirrnin në rresht në shesh e për një miting tjetër i kyçnin me shtatë palë dryna dhe i shantazhonin me militantët politikë të forumit rinor...

Dikush nga studentët protestues, tek më shihte "indiferent", më kërkoi të përfshihesha, të isha edhe unë aty me ta, në mes tyre, ku luftohej për të shpëtuar "kalin e ngordhur". Por si mund të isha unë aty kur pas xhameve të kafeneve, hienat që ishin ushqyer nga ajo kërmë, bënin sehir....

SË BASHKU PËR NJË INSTITUCION TË ARSIMIT TË LARTË QË E MERITOJMË

Sigurisht, ne duhet të luftojmë për të pasur një institucion të arsimimit të lartë në Dibër, por një institucion të vërtetë, në themel të të cilit do të derdhet kontributi akademik i mbi 150 profesorëve e pedagogëve dibranë, që kanë rrezatuar dije e kompetencë akademike në universitete e qendra kërkimore e shkencore në Shqipëri e në botë. Të gjithë këta personalitete vazhdimisht kanë shprehur dëshirë e vullnet për të kontribuar për ta shëndoshur Filialin e sëmurë të Peshkopisë, por janë ndeshur në heshtje e shpërfillje, mungesë respekti e injorim.

Por tashmë është radha të nisim betejën ne, që kemi qëllim iluminimin shoqëror dhe përparimin e Dibrës dhe jo një nënshkrim në listën e pagave. Ne do të luftojmë fort për të pasur jo një Filial, me kurrikula të improvizuara, por një Institucion të Arsimit të Lartë, në kapacitete reale me qëllime e objektiva të menduara mirë e mbi kritere shkencore. Kjo është një ftesë për të gjithë ata që ndjejnë vërtetë dhimbje për dështimin një institucioni arsimor, si Filiali...

Urdhëri i lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për mbylljen e Filialit të Universitetit "Aleksandër Moisiu"- Durrës në qytetin e Peshkopisë, ka hedhur në protestë rreth 1500 studentëve të këtij Filiali. Kështu, më 21 nëntor 2014, studentët të mbështetur edhe nga qytetarët, bojkotuan mësimin në auditore dhe zhvilluan një protestë para godinës së Filialit në qendër të qytetit.

Studentët kanë kundërshtuar urdhërin e MAS-it, për mbylljen totale të këtij Filiali pas 31 marsit të 2015-tës. Studentët i kërkojnë Ministrisë që ta rishikojë edhe njëherë urdhërin e dhënë për mbylljen e këtij Filiali, pasi sipas tyre ai është absurd.

Në këtë vit akademik në këtë filial vijojnë studimet 1500 studentë edhe pse sipas vendimit të qeverisë, nuk u hap viti i parë ashtu si dhe në shumë filiale të tjera universitare të vendit. Mbyllja e dyerve të këtij filiali, sipas urdhërit të lëshuar nga MAS-i gjatë semestrit të dytë, është dhe mbetet selektiv, thanë studentët në fjalën e tyre. Kjo pasi ky urdhër është lëshuar vetëm për këtë filial dhe jo për të gjitha filialet në mbarë vendin.

Dibra është rajoni më i varfër i vendit, ndaj mbyllja e menjëhershme e Filialit në

> Studentët e Filialit të Universitetit "Aleksandër Moisiu" protestojnë kundër urdhërit për mbylljen e Universitetit.

mes të vitit akademik universitar, do lejë në pamundësi për vijimin e studimeve në Durrës një numër të konsiderueshëm studentësh, pasi familjet e tyre janë në skemën e mbrojtjes sociale dhe nuk mund të financojnë për këtë qëllim.

Studentët që morën fjalën në këtë tubim proteste, rreshtuan një sërë argumentash për mosmbylljen e këtij Filiali. Kështu, sipas tyre, mbyllja e filialit në mes të vitit akademik, nuk është parë e dëgjuar ndaj i bëjmë thirrje Kryeministrit Rama, që të mos na diferencojë duke na veçuar nga studentët e tjerë në Tiranë, Durrës, Vlorë, Gjirokastër etj.

Ndërkohë, sipas Urdhërit të mbërritur, bëhet fjalë për transferimin e të gjithë studentëve deri në datën 31 mars 2015 në Durrës. Por, një gjë e tillë sipas studentëve është absurde pasi programet e studimit janë totalisht të kundërta me ato që zhvillohen në Durrës, ndaj kjo lëvizje edhe për këtë arsye bëhet absurde dhe e pamundur që të zbatohet.

Studentët deklaruan se nga dita e sotme nuk do të frekuentojnë më auditorët, por do të protestojnë për çdo ditë deri në anullimin e këtij urdhëri të MAS-it.


Kundër mbylljes së universitetit, studentë dhe qytetarë të Peshkopisë po firmosin një peticion që do t'i dorëzohet Ministres së Arsimit dhe Sportit, znj.Lindita Nikolla.

Universiteti i Durrësit hapi filialin e tij në Peshkopi 5 vite më parë dhe në vitin 2013 arriti në 4500 studentë. Pas një investimi prej rreth 1 milionë eurosh godina e universitetit u kthye në një nga godinat më të mira të universiteteve në vend. "Urdhëri për mbylljen e tij pa asnjë argument bindës, kur plot universitete të tjera që nuk kanë as ambiente e as numër studentësh funksionalë, hedh dyshime se qeveria e Kryeministrit Rama po bën një hakmarrje krahinore", thanë disa studentë gjatë protestës.

Studentët kanë pasur mbështetjen e partive opozitare, ndërsa asnjë autoritet qeveritar, lokal apo qendror, nuk është takuar me ta për t'u shpjeguar arsyen e këtij vendimi.

Hysen Likdisha

Botim i ri



Frano Prendi - Adem Bunguri
STUDIME PËR PREHISTORINË E SHQIPËRISË

Botimet M&B. ISBN: 978-9928-172-18-1. Çmimi: 15 Euro

Pesëdhjetë vjet më parë, kur Frano Prendi do të fillonte gërmimet në vendbanimin shumështresor të Maliqit, Shqipëria ishte pothuajse një hapsirë e bardhë në hartën prehistorike të Europës Juglindore...

Nga pikëpamja strukturore, ky punim përbëhet nga 5 kapituj, të paraprirë nga një hyrje e shkurtër, pozita gjeografike dhe historiku i kërkimeve prehistorike. Pastaj, sipas kriterit kronologjik e tematik vijnë kapitujt me radhë: Paleoliti dhe Mezolitit, Neoliti i hershëm, Neoliti i mesëm, Neoliti i vonë dhe Eneoliti.

Punimi mbyllet me konkluzionet dhe një apendiks që përfshin listën e vendbanimeve sipas periudhave, tabelën e sipërfaqes së përafërt dhe të sipërfaqes së gërmuar, tabelën e datimeve radiokarbonike të kulturave prehistorike në Shqipëri dhe në rajon, listën e ilustrimeve, bibliografinë dhe indeksin e emrave.

E veçanta e kësaj monografie është trajtimi i kulturave neo-eneolitike sipas grupeve dhe komplekseve kulturore, kriter që e ka çliruar botimin nga përshkrimet e tepërta.

Botimi i këtij libri, thotë në hyrjen e librit Prof. Adem Bunguri, plotëson një amanet të Prof. Frano Prendit dhe përbën njëherësh edhe një homazh ndaj veprës së tij shkencore dhe kontributit të jashtëzakonshëm të tij në studimet prehistorike...

Rruga e Arbërit nr. 103
blogger



"Land Art" për të ruajtur Radikën

Nga Adem Sulejmanoski, Nikola Pisarev dhe Goce Ljubinovski.

Një skelet peshku i ndërtuar me gurë dhe shoqëruar me nënshkrimin në anglisht "Save Radika" (Ruaj radikën) u ndërtua më 10 nëntor në një pjesë të tharë të liqenit të Dibrës, duke u përpjekur në sensibilizimin e organeve vendimmarëse që të ndalojë ndërtimin e hidrocentraleve mbi lumin Radika dhe Fushë të Lukovës.

Aktivistë të shoqërisë civile njoftuan para pak ditësh se 95 shoqata qytetare nga Dibra, Reka, Gostivari dhe nga gjithë Maqedonia janë duke dërguar kërkesë një organizate ndërkombëtare ekologjike, nga e cila kërkohet që të bëhet një studim i pavarur lidhur me ndikimin negativ të dy hidrocentraleve të planifikuara të ndërtohen në Parkun Kombëtar të Mavrovës mbi vetë parkun, lumin Radika dhe liqenin e Dibrës. Drejtues të shoqërisë civile njoftuan se kjo kërkesë pritet të marrë edhe mbështetjen e kryetarëve të komunave të Dibrës dhe Gostivarit. (Burimi: Grupi "Të mbrojmë lumin Radika" në Facebook)

Ditari i një vajze...



Nuk ka nder në vrasje!

Po sikur ty ditar të të marrë dikush në dorë dhe të të shfletojë.. Ka ndodhur the?! I ke faqet dhe kapakun të zhubrosur? Kapakun?! Kapakun që e shohin të gjithë?! Na turpërove! Na prishe nderin! Po unë ty të kam bërë more! Unë të vras! Na!

Qetësohu ditar se nuk e kam me ty jo, por jam e tmerruar një herë nga një ngjarje makabër, që ka ndodhur në Dibër së fundmi, dhe e tmerruar një mijë herë nga mentaliteti, që e justifikon këtë makabritet.

Një vajzë vetëm 21 vjeç është vrarë. Personi që në jetë bëhet idhulli dhe shembulli i sigurisë për një vajzë, e vrau atë të pambrojtur, me 8 plumba. U vra nga i ati, nën vështrimin e vëllezërve të saj. U qëllua 8 herë me foshnje të rritur 5 muaj në bark. U vra për nder...

Po ç'nder është ky që të lejonka të marrësh jetë? Çfarë lloj nderi është ky, në emër të të cilit një baba ngre dorë mbi vajzën e tij të vetme. Brenda së cilës rritet një tjetër jetë, që më vonë do i thërriste „gjyshi!" me gjithë dashurinë e pafajësinë e tij. Nga na ka mbirë ky nder i pandershëm?

Doni të flisni për nder? Nder është dituria dhe është e pandershme që shumë vajzave iu ndalohet të vazhdojnë shkollën, se iu ka ardhur "mosha për burrë". Nder është puna dhe është e pandershme që disa vajzave iu refuzohet të kenë një profesion. Nder është liria dhe është e pandershme që shoqeve të mia nuk iu dëgjohen mendimet e dëshirat. Është e pandershme që ato të mos jenë të lira të ndjekin ëndrrat e tyre. Nder është respekti dhe është e pandershme t'iu gresh nënave lapidare kashte mbi themele të rënda gjykimi e nënshtrimi për çdo femër që rron mbi tokë. Kjo është thjesht hipokrizi! Edhe jeta është nder dhe është e krim i pandershëm të vrasësh një të pafajshëm.

Mirëpo, goditja më e madhe vjen pas gjëmës, kur dëgjon fjalët e disa qënieve pseudo-njerëzore të fajësojnë viktimën:

- "Mirë ia bëri", thoshte dikush. Ti ditar nuk do më besosh, por kjo ishte një vajzë, që me siguri vuan nga ajo që quhet "sindroma e Stokholmit".

Një djalë tjetër pasi shpalosi injorancën e tij në të shkruar, në fund tha:

- "Pa ofendim, por të gjithë femrat janë të flliçta."

U shokova në fillim, por pastaj mendova që mbase ka kaq neveri ndaj femrave se është 'gay' dhe ka vendosur më në fund ta pranojë hapur. Kurajo, i them, dil në të hapur, se bën vaki edhe nuk të vrasin!

E kam ditur gjithmonë që ka diçka që seriozisht nuk shkon me shoqërinë tonë, por kësaj here është kaluar çdo parashikim i absurditetit mendor. Egziston një mentalitet i sëmurë, që ve fjalët e botës para jetës së fëmijës. Ka si duket njerëz që iu shkon në ment që është më mirë të vrasin pjellën e tyre, se sa të përballen me llafet e komshijve. Se mos komshijtë u kënaqën pasi ky vrau fëmijën e tij "për nder"?! Po jo mor të gjorë! Ajo iku, tani do merren me këtë.. për atë punë, ata do merren me ju të gjithë. Mos keni ndërment të vriteni të gjithë me njëri-tjetrin për thashethemet e botës që ju rrethon dhe e rrethoni?

Praktikimi i thashethemeve është thjesht një hob i mendjeve të vogla dhe qënieve kurioze të pazëna me gjëra më të mira për të bërë. Nuk e kuptoj se si mund t'i merrni aq seriozisht! Nuk e kuptoj se si një gjë kaq pa vlerë mund ta ktheni në vlerë më të madhe se vetë vlera e jetës. Si mundeni që thashethemet t'i konsideroni si tregues të integritetit tuaj, apo "nderit" tuaj? Kjo është e pandershme ndaj nderit tuaj. Është e pandershme të vrasësh për një nder, që bazohet në pritshmëritë e një mase njerëzish që nuk i pëlqen asgjë që është e ndryshme me ta. Nuk e kuptoj se pse doni të bëheni si gjithë të tjerët... shumica kanë dështuar!

Është e çuditshme se si njerëzit kthehen në marioneta dhe fijet që iu kontrollojnë veprimet ia lënë totalisht në dorë llafazanëve të fshatit. Ku dinë gjë ata se ç'po bëjnë! Ata thjesht hedhin fjalë në tym për triblim – të tjerë i marrin dhe i fryjnë me ajër – pastaj ka budallenj që i kapin, i mbushin me gurë dhe ia venë vetes mbi kurriz, si "nder"...

Egzistenca e këtij nderi të pandershëm tregon rëndësinë e parëndësisë sonë si qënie të paqëna që jemi.

***

Në respekt dhe nderim të vajzës dhe foshnjës që u vranë pa jetuar ende.

Ndiq linqet e mëposhtëme në Web dhe Facebook për më shumë foto dhe komente nga Peshkopia e Dibra...

http://peshkopidiberalbania.wix.com
https://www.facebook.com/PeshkopiDiberAlbani

Ç'kemi ásaj Dibre!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Edi që të kam munguar, por herën e kaluar dola jashtë rruge... Ndoshta edhe për faktin se nuk kisha asnjë dëshirë të shkruaj... Të shkruaja për varret e hapura në verë në Bulqizë, gati për dimrin në prag apo për ata banditët anonimë që prenë brenda natës një pemëtore me mbi 400 rrënjë të një bashkëfshatari të tyre...

Qeveria ka marrë një vendim të rëndësishëm këtë muaj: Ka ulur moshën e pensionit të minatorëve, njërin nga premtimet e mbajtura, siç u pëlqen deputetëve dhe qeveritarëve. Por për vdekjet e radhës në galeritë e Bulqizës janë jashtë premtimeve: Ngushëllime, varrimi, një lugë hallvë në fund për shpirtin e tyre dhe kaq! Prit vakinë tjetër...

Në Rrugën e Arbërit kanë nisur punimet vrullshëm. Thonë që qeveria u ka dhënë ca lekë dhe po vazhdojnë punimet nga ura e vashës deri në Bulqizë. Madje, edhe tuneli aq shumë i përfolur në Qafë të Buallit po punohet për t'u hapur. Por askush nuk flet se pse tuneli i projektuar 850 metra do bëhet 460 dhe se rruga me dy korsi, me dy do vazhdojë të mbetet. Si pjesa tjetër...

Kinezët po na mbajnë me shpresa.. Sa del një lajm që kanë ikur, vjen një lajm që do vijnë. Marrëveshja ishte gati që në gusht, pastaj thanë në shtator, u shty për tetor, iku dhe nëntori... Po nuk u firmos edhe në dhjetor, me siguri vitin tjetër do firmoset. Por, edhe po nuk u firmos, nuk ka problem, se është bërë rrugë kjo punë: vetëm premto, por llogari s'jep kush... E rëndësishme është se ca kinezë shfaqen ndonjëherë, sa për të na rritur shpresat...

Ky muaj është muaji që më së shumti shfaqemi atdhetarë: Taksat s'i paguajmë, dritat i duam pa lekë, uji është pasuri e jona, punën e shtetit e duam, qeverinë e shajmë dhe opozitën nuk e njohim, ama "o sa mirë me qenë shqiptar o hej" e dimë përmendësh. Sidomos kur ngremë lart flamurin, me llapën e gjatë kineze...

Një hoxhë diku, na ka dalë në you tube dhe ka ba një deklaratë: Flamurin në Vlorë e ngriti Vehbi Dibra, jo Ismail Qemali... Vehbi Agolli përdori mësimet e fesë për të ndërtuar shtetin, këta fetarët e sotëm i vënë minat shtetit për të mbajtur popullin nën kontrollin fetar... Dikur thuhej del një budalla dhe hedh një gur në lum dhe mijëra të tjerë nuk e nxjerrin dot, tani budallai del me zë dhe fytyrë në you tube dhe bën lëmsh dynjanë...

Universitetit të Peshkopisë i erdhi mandata. Njëherë e mbyllën, pastaj e hapën, pastaj e mbyllën, pastaj e hapën, tani e transferuan... Sa të mërzitur janë pedagogët dhe prindërit: të parët nuk i shesin dot më provimet, të dytët nuk dinë sa është pagesa për një provim në Durrës. Me fat qenë ca të tjerë që janë diplomuar dhe presin tani të bëhen drejtora, pavarësisht se të mesmen s'e kanë marrë akoma.

Muajin që shkoi u zhvillua një panair libri në Peshkopi, për herë të parë. Morën pjesë shkrimtarët që kishin bërë nga një, dy apo tre libra. Ata që kishin bërë nga 10 libra e përkije u mërzitën që s'u ftuan dhe nuk morën pjesë fare! Ndoshta edhe u mërzitën, se donin stendë veçan dhe postera sa një bojë burri t'u vareshin bulevardit...

Ka dhe çështje të tjera, por po s'përtove hyr ndonjëherë në Facebook. Ti tregon të gjitha lajmet që nuk duhet ti dishë!

skicë

Dea risjell dashurinë në familjen e Vera Laçit



"Çohu Rexho, çohu djalë o', çohu i miri nanës o', Se s'ka nana tjetër o'".

Vargje rrënqethëse që bëhen akoma më emocionuese kur këndohen nga mjeshtrja e këngës dibrane Vera Laçi.

Sapo dëgjon këtë këngë e lidh menjëherë me figurën e saj dhe si për ironi të fatit sot kjo elegji personalizohet tek Vera. U bënë gati dy vjet që këngëtarja humbi djalin e sa të vetëm, Denin! Ishte një aksident automobilistik që i preu në mes ëndrrat e 20 vjeçarit dhe mbushi me dhimbje jetën e dy prindërve të tij. U duk se Vera do ta ndërpriste aty karrierën e saj, nuk do ta dëgjonim më duke kënduar e do na mungonte në ekranet tona.

Por, në qershor të këtij viti, këngëtarja vjen sërisht për publikun, po tashmë jo me këngët e dasmave siç ishim mësuar, por me një këngë vaji, dhimbjeje "Lotët mos mi fshini" kushtuar djalit të saj, e veshur e gjitha në të zeza, në kulmin e dëshpërimit.

Krejt e kundërta ndodhi para disa ditësh kur këngëtarja ishte e ftuar në një emision në Top Channel për t'i prezantuar publikut të renë më të fundit nga jeta e saj. Birësimi i një foshnje ka bërë që Vera të shohë dritë në fund të tunelit. Dea, vajza e vogël e nga Shtëpia e Foshnjës, duket se është *Kepi i Shpresës* së dy prindërve fatkeqë. "Dea erdhi në familjen Duka ditën e lindjes së Denit, nuk e di se c'emër t'i vë kësaj, vetëm më bën të besoj tek ekzistenca e Zotit dhe jo rastësisë". Ky vendim duket se e ka lumturuar pa masë këngëtaren, e cila ka rrëfyer me një frymë për jetën e re që ka sjellë në familje Dea.

E pyetur nga gazetaria pse zgjodhën për të birësuar një vajzë dhe jo një djalë, Vera u shpreh: "Unë djalin e kam, e di që është diku dhe një ditë do ta takoj sërish. Vajzën që nuk e pata kurrë shpresoj ta gjej tek Dea." Lidhja e fortë që ekziston mes nënës e bijës, duket se kishte ndodhur shpejt mes Verës dhe Deas. Gjatë gjithë intervistës vogëlushja përqafonte të ëmën, sikur donte t'i thoshte: "Ne gjetëm njëra-tjetrën. Tani duhet të mbahemi fort".

Videon e bisedës së këngëtares së njohur dibrane mund ta gjeni në linkun e mëposhtëm:

https://www.youtube.com/watch?v=mQSZ5nfl-NU

Sashenka Ndreka

Skicë

E qeshura që më erdhi nga **Luan Pacani**

Dhe më ndezi mallin për Dibrën time...

Një zile telefoni. Një buton i shtypur dhe një zë i njohur. Erdhi nga larg, përmes tokës dhe detit, mbi ishuj njeri më i bukur se tjetri. Më erdhi nga një qytet që unë nuk e kam parë por e kam dëgjuar. Ishte zëri i Luan Pacanit, bir Përmeti e dhëndër Dibre. E kam takuar një herë në Iraklio, ulur pranë e pranë në një teatër veror me veshët ngrehur pas këngës dhe humorit që vinin nga larg, nga Shqipëria që e kemi në shpirt e në zemër. E kam takuar edhe në " Vatrën Shqiptare ", ditën e përurimit të saj. Kishte ardhur drejt nga Kreta për t'iu bërë krah gëzimit të një mbrëmjeje të bukur. E kërkova në arkivin fotografik dhe e gjeta. Edhe në Kretë, edhe në Athinë...

Po pse më telefonoi të mërkurën në mëngjes Luan Pacani ?

Thjesht për të këmbyer disa fjalë për shëndetin dhe punët, punët e tij me "makineritë e rënda" dhe punën time të "viteve të pleqërisë".

Jo vetëm kaq. Kërkonte mendimin tim për "të qeshurën". Kjo më bëri t'i shkruaj këto radhë, të komunikoj me të por edhe me të tjerë, me njerëz që qeshin dhe gëzojnë.

Në Rethimno do të bëhet një takim. Tema ishte me të vërtetë interesante "E qeshura që bashkon njerëzit". Të qeshësh, të bësh dhe të marrësh humor, është shëndet, gëzim... Luani më kujtoi një shokun tim të viteve të rinisë, BaftjarShahinin, një njeri që nuk i varej kurrë buza, një njeri që i qeshte nuri dhe shpirti. Ai thoshte gjithnjë "I dua njerëzit kur qeshin". Vdiq i ri, pa i mbushur të pesëdhjetat. Vdiq nga një aksident automobilistik pas një takimi me "njerëz të qeshur" në malet e Pratit të Selishtës. Fëmijët dhe e shoqja, mbi mermerin e bardhë, poshtë fotografisë shkruan : "I dua njerëzit kur qeshin !"

U ktheva shumë në kohë e hapësirë. Nuk e kam fajin unë, e ka Luan Pacani që më kujtoi



gazin dhe harenë, njerëzit që qeshin...

Më pyeti për humorin dhe të qeshurën njerëzore në Dibër. I tregova për "Auditorin e Universitetit Popullor" të Dibrës.I fola për këngët dhe vallet humoristike, për vallen e Xhafer Kabës që cenin natyror të fizikut të tij, të shqepurit, e shndërroi në një perlë të vallëzimit popullor. I fola edhe për lojërat – valle e këngë të "Djemve të Pollozhanit". I fola edhe për "Kalanë Dibrane"...

Më tha se në atë festival të humorit dhe qeshjes njerëzore do të paraqiteshin emigrantë nga të gjitha vendet dhe kontinentet. Donte që të paraqiste edhe "Qeshjen Shqiptare", qeshjen dhe humorin nga të gjitha krahinat, nga Jugu në Veri. Më tha se ndërkohë që do të fliste para atij auditori të gjerë, në një ekran të madh do të përcilleshin aspekte të humorit dhe të qeshurës së popujve. Ishte duke përgatitur një CD nëpërmjet së cilës të përcillte të qeshurën shqiptare...

Luan Pacani nuk drejton ndonjë shoqatë dhe nuk është pjesë e asnjë shoqate në Rethimno dhe në Kretë. Është thjesht një njeri, një intelektual që don ta vendosë buzëqeshjen shqiptare krahas buzëqeshjes së popujve të tjerë. Sepse qeshja dhe humori bashkojnë njerëzit, lidhin shpirtërisht në një nyje të fortë popujt... E qeshura e Luan Pacanit më mori e më hodhi me "parashutë" në qiellin gazmor të Dibrës time, qiell e tokë që më mungon e më mundon tash tetëmbëdhjetë vite larg... Mbase një ditë do të ulem në bisedë me shoqen e jetës të Luanit në rrëfimin e saj për të parët e vet nga Luznia, Lishani i Epërm...

Luan Pacani nuk drejton ndonjë shoqatë dhe nuk është pjesë e asnjë shoqate në Rethimno dhe në Kretë. Është thjesht një njeri, një intelektual që don ta vendosë buzëqeshjen shqiptare krahas buzëqeshjes së popujve të tjerë.

E qeshura e Luan Pacanit më mori e më hodhi me "parashutë" në qiellin gazmor të Dibrës time, qiell e tokë që më mungon e më mundon tash tetëmbëdhjetë vite larg...

Abdurahim Ashiku

Athinë, 26 nëntor 2014

Rruga e Arbërit

Njoftim për bashkëpunëtorët

Na shkruani email:
<**rrugaearberit@gmail.com**>

Të nderuar bashkëpunëtorë,
Për të pasur një bashkëpunim të suksesshëm, ju lutemi të kini parasysh disa kritere për materialet që sillni pranë redaksisë.
- Shkrimet duhet të jenë të daktilografuara, jo më shumë se 1500 fjalë (10000 karaktere, përfshirë hapsirat). Shkrimet duhet të përmbajnë shkronjat "ë" dhe "ç". Shkrimet me më shumë fjalë, do ti nënshtrohen procesit të redaktimit.
- Fotografitë për shkrimin duhet të jenë me diçiture dhe më emrin e fotografit.
- Materialet me karakter aktual dhe problematikën e ditës kanë përparësi botimi.
- Materialet historike, recensat apo portretet, nuk do pranohen për botim, n.q.s. ato konstatohen se janë botuar në ndonjë media tjetër apo rrjete sociale.
- Shkrimet duhet të jenë origjinale dhe të respektojnë të drejtat e autorit.
- Shkrimet duhet të sillen nëpër nëpërmjet Postës Shqiptare në adresën e gazetës, postës elektronike në e-mail <**rrugaearberit@gmail.com**>, ose mund tu dorëzohen personave të autorizuar nga redaksia.
- Shkrimet që janë jashtë platformës së gazetës, nuk botohen dhe redaksia nuk është e detyruar të japë shpjegime për çdo rast.

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, ju përcjellim konsideratat më të mira për bashkëpunimin e deritanishëm.
Për sqarime më të hollësishme mund të na kontaktoni me email në adresën <**rrugaearberit@gmail.com**>

reportazh

Udhëtim në Limjan, takime me nxënësit, mësuesit dhe njerëzit e besimit



Me libra mes fëmijëve

Nga **BUJAR KAROSHI**

Limjani është një nga fshatrat më të njohur dhe më të bukur të Dibrës. Të njohur për besimin fetar me ndikim në gjithë Dibrën, por edhe me pozicionin gjeografik. Vendosur në një shpat mali, gjithë lugina e Drinit duket si në pëllëmbë të dorës, madje me dylbi mund të shohësh deri në Runjë dhe Lurë. Kur pyet se sa banorë ka fshati, një bashkëfshatar i Musait e përkthen me numër votuesish: rreth 400, kështu që me një aritmetikë të thjeshtë Limjani dhe dy fshatrat më të afërt, Vranji dhe Voleza kanë sot rreth 1200 banorë.

Limjani është larg nga Peshkopia rreth 11 km. Një pjesë e rrugës është e asfaltuar, një pjesë e zgjeruar shumë mirë, por makinat e vogla është vështirë të ngjiten. Kohë më parë, një firmë italiane investoi në hapjen e rrugës, pasi kërkonte të shfrytëzonte gjipset në masivin e Vranjtit, por nga investimi i premtuar vetëm tabani i rrugës ka mbetur: firma u largua dhe në fshat dëgjon legjenda urbane që luhaten mes të vërtetave, thashethemeve, paradokseve, korrupsionit të ndodhur e të pandodhur, dyshimeve mes "hallatit" dhe "haramit", sa të krijojnë idenë se janë më shumë tregime fantastike sesa një realitet i dhimbshëm.

Por këtë radhë, udhëtimi drejt shkollës 9-vjeçare, e cila ndodhet në mes Vranjtit dhe Limjanit u bënë librat. Librat e shkruar më së shumti nga autorët dibranë, ku një pjesë e tyre, subjektin e marrin edhe nga këto anë.

NJË SHKOLLË E RE, QË DUKET SI E VJETËR

Në hyrje të shkollës na pret Abdi Shehu, drejtor prej shumë vitesh i kësaj shkolle. Ndërsa librat vendosen në një tavolinë në hyrje të shkollës, Abdiu na shpjegon historikun. Shkolla e Limjanit mbush sivjet 50-vjetorin dhe ai po përpiqet që së shpejti t'i mbledhë ish-mësuesit e shkollës, ata që jetojnë akoma. Shkolla është e re, por dyshemeja e shtruar keq dhe dyert e klasave të gërvishtura e të arnuara me copa kompesatash, të krijojnë idenë se kjo shkollë është e vjetër sa vetë historia e saj.

"Kjo shkollë është ndërtuar në vitet 1995-1996", - thotë drejtor Abdiu. Dhe, pasi vë re habinë tonë, se si kaq e re është dëmtuar kaq shumë, nxiton të shpjegojë se cilësia e ndërtimit është si në atë kohë. "Kur u inaugurua shkolla, - thotë Abdiu, na thanë që do të vinin nga Drejtoria Arsimore për të marrë pjesë. Ne dolëm disa veta t'i prisnim në krye të rrugës, kur shohim vargun e makinave që vinin njëra-pas tjetrës. Mbi 10 makina. Ne ishim gjithsej në atë kohë 20 mësues, ata ishin mbi 40 veta... Nuk kishim ku t'i ulnim. Baza materiale e shkollës nuk kishte ardhur akoma. Kështu që për t'u ulur, përdorëm trupat e ahut që kishin ardhur për t'u përdorur për ngrohje gjatë dimrit. Njëri nga drejtuesit e arsimit, kur pa cilësinë e keqe të shtrimit të pllakave, bërtiti, por ndërtimi kishte përfunduar. Nuk u mor kush me më to".

Në sallën e mësuesve ku jemi ulur, një sobë e ndezur qëndron ngjitur me murin, ndërsa pranë saj, një hartë e prerjes skematike të rruzullit tokësor ka mbuluar një hartë politike të Europës. Shkolla ka gjithsej 14 mësues, bashkë me dy shkollat fillore në Vranjt dhe Limjan.

Drejtori i shkollës na fton për një vizitë në mjediset e klasave. Një klasë është mbushur me dru për ngrohje, që të kujton se në këto anë dimri zgjat 6 muaj. Soba është në çdo klasë, madje në ndonjë prej tyre e ndan dërrasën e zezë përgjysmë. Disa vizitime nxënësish janë ngjitur në ndonjë cep dhe në korridore janë vendosur këndet e gjeografisë, letërsisë, historisë, etj., por edhe qeveria e nxënësve...

Në klasën e fizkulturës një kaluç qëndron i vetmuar, ndërsa shumica e xhamave të dritareve në katin e parë janë të thyera, për të mos thënë se nuk ka fare. Pyesim për internetin dhe kompjuterët në shkollë, por drejtori shpjegon se nuk janë më. "Ishim shkolla e fundit që na i vodhën", - thotë drejtori, sikur kjo të ishte një lajm i mirë. Shumë shkolla të tjera në Dibër ishin vjedhur para saj. Një hartë në sallën e kompjuterave që tregon tërmetet dhe vullkanet, duket sikur do të na dëftojë tërmetin që ka rënë këtu ...

NJË NXËNËS - NJË LIBËR

Musa Riçku, një biznesmen i njohur në Tiranë dhe Dibër, një mik i shkrimtarëve dhe artistëve, një dashamirës i shoqatave dhe organizatave joqeveritare, botues i gazetës "Rruga e Arbërit", këtë herë kishte marrë përsipër të dërgonte libra për fëmijët e bashkëfshatarëve të tij. Duke marrë shkas nga suksesi i Panairit të parë të Librit në Peshkopi, Musai shprehu dëshirën që të blinte një sasi të konsiderueshme librash për shkollën e vendlindjes.



Librat për shkollën janë të zgjedhur cilësorë dhe nga autorë dhe personalitete, shumica e të cilëve me origjinë nga Dibra. "Një pjesë e atyre nxënësve do të bëhen dikush nesër në jetë, dhe është e nevojshme që shembulli që vjen nga autorët dibranë, Shaban Sinani, Agron Tufa, Ramiz Gjini, Naim Plaku, Xhafer Martini, e shumë të tjerë, duhet t'i frymëzojë dhe t'u hapë dritaret për të ardhmen e tyre".

Nxënësit janë rreshtuar të gjithë para shkollës. Librat e dhuruar nga Musai janë vendosur mbi tavolinë. Nxënësi i shohin dhe, duket se nuk kanë durim për t'i parë. Drejtori i shkollës, thotë se në shkollë ka një nismë: Të gjithë të blejmë nga një libër, por sot ne na ka sjellë dhuratë të gjithëve nga një libër Musa Riçku, bashkëfshatar i yni. Ai i fton nxënësit ta lënë mënjanë celularin dhe të merren më shumë më librin.

Në fillim u tregoj pak nxënësve për iniciativën e Musait. Pastaj ju bëj një panoramë të librave të cilët ata do të kenë mundësi t'i shfletojnë. Në pakon dhuratë për shkollën ka libra edhe për mësuesit, edhe të vlefshëm për programin e shkollës, por edhe për kohën e lirë. Kriteri kryesor i përzgjedhjes kanë qenë autorët dibranë. Dhe shumë botime nga Shaban Sinani, Agron Tufa, Xhafer Martini, Ramiz Gjini, Arian Kadiu, Eqrem Basha, Faruk Borova, Lutfi Hanku, Mimoza Tola, Naim Berisha, Abdurrahim Ashiku, Petrit Fetahu, Shaqir Skarra, Xhemal Domi, Zenel Sula etj., kanë hyrë tashmë në bibliotekën e shkollës. Por me kërkesë të drejtorit janë shtuar edhe disa botime ndihmëse të programit mësimor. Libra nga Asdreni, Çajupi, Faik Konica, Fan Noli, Gjergj Fishta, Jeronim de Rada, Mitrush Kuteli, Naim Frashëri, Ndre Mjeda, Sami Frashëri, Kristo Frashëri etj., kanë pasuruar bibliotekën.

Vetë Musai e ka të vështirë të flasë para nxënësve. "Nuk kam gjë për të shtuar, tha Musai, por vetëm do të doja që ju të rriteni pranë librave dhe t'i doni librat. Kënaqësia ime më e madhe është kur ju t'i përdorni këto botime, për të mësuar më shumë dhe për t'u kulturuar më shumë".

"Nëse nga drejtoria e shkollës do të kemi informacione, se mes jush ka nxënës të mirë që duan të studiojnë, janë të talentuar dhe kanë prirje në fusha të caktuara, unë do të jem i gatshëm t'i mbështes ata edhe në të ardhmen", - tha Musai.

Pas kësaj ceremonie të shkurtër nxënësit u afruan pranë librave dhe u mrekulluan prej tyre. Në pamje të parë dukej sikur nuk kishin parë libra me sy, por kur shikon bibliotekën e shkollës me libra të vjetër, ndoshta edhe sa vetë shkollë, e kupton gëzimin e tyre.

Kjo shkollë ka sot rreth 140 nxënës, - thotë Abdiu. Në fakt, pa e ditur, numri i librave dhuratë është rreth 140, që do të thotë se sot çdo nxënës ka mundësi ta marrë një libër me vete për ta lexuar në shtëpi...

NJË BIBLIOTEKË ME LIBRA "IDEOLOGJIKË" - MES TYRE EDHE SHEKSPIRI

Pas një kokteji të shkurtër më mësuesit e shkollës, një vizitë në bibliotekën e shkollës nuk mund të mos bëhej. Një raft të vjetër me kanate, në një cep të klasës që shërben si bibliotekë, janë vendosur libra që kushedi sa kanë mbyllur brenda kanateve. Drejtori thotë se këto libra janë shumica të kohës së kaluar, dhe kur afrohesh nga kurioziteti shikon se

cyan magenta yelloë black

libri





Në foto: Nxënësit e shkollës së Vranjit të rreshtuar gjatë ceremonisë së dhurimit të librave. Poshtë: Nxënësit shletojnë librat së bashku. Djathtas: Musa Riçku dhe imami i xhamisë së Limjanit, Mexhit Shehu. Foto tjetër: Një foto me Musain në bibliotekën e shkollës. Foto në fund të faqes: Nxënësit rregullojnë librat e dhuruar.

© Foto: B.Karoshi

> "Do të doja që ju të rriteni pranë librave dhe t'i doni librat. Kënaqësia ime më e madhe është kur ju t'i përdorni këto botime, për të mësuar më shumë dhe për t'u kulturuar më shumë". "Nëse nga drejtoria e shkollës do të kemi informacione, se mes jush ka nxënës të mirë që duan të studiojnë, janë të talentuar dhe kanë prirje në fusha të caktuara, unë do të jem i gatshëm t'i mbështes ata edhe në të ardhmen", - tha Musai.

aty, mes librave me përmbajtje ideologjike, ka serinë e veprave të Shekspirit, libra nga Balzak, Çajupi, Çehov dhe plot të tjerë.

Librat e dhuruar janë vendosur në disa rafte të tjerë në anën tjetër të klasës, që mbyllen me disa kanate pa xhama, sikur duan të tregojnë lirinë e tyre... Nxënësit i kanë rregulluar me kujdes, por shpresojmë që ky rregull të jetë sa për fotografi...

NË XHAMINË E FSHATIT LIMJAN - LIBRA TË TJERË DHURATË

Musai ka një lidhje të pashmangshme me Limjanin. Vjen vazhdimisht këtu. Shtëpinë e tij të vjetër e ka rikonstruktuar, por ashtu ka ndihmuar edhe në ndërtimin e xhamisë së fshatit. Fshati është i njohur në gjithë Dibrën për lidhjen e fortë me fenë islame, por edhe për ndikimin e saj në të gjithë Dibrën. Teqja e Limjanit është e njohur në Dibër për forcën e saj ndikuese në jetën e banorëve. Mbi 26 imamllarë kanë shërbyer në zona të ndryshme të Dibrës, duke u shërbyer njerëzve dhe duke u mësuar atyre besimin islam.

Musai ka ndërtuar të re xhaminë e fshatit. Në fillim ndërtoi minaren e xhamisë dhe më pas financoi gjithë ndërtimin e saj. Mexhit Shehu, imami i xhamisë, thotë se me këmbënguljen e Musait dhe me përkrahjen e popullit të Limjanit, u bë e mundur që xhamia të përfundonte brenda 31 ditësh. Punimet nisën me 3 qershor të vitit të kaluar dhe me date 7 korrik u krye përurimi i saj.

Musai këtë radhë hyri në xhami me libra mbi besimin islam, kryesisht disa abetare për fëmijë të moshave 6-10 vjeç.

"Janë libra shumë të mirë, - thotë Imam Mexhiti. Këto libra do na ndihmojnë shumë të kuptojmë besimin e vërtetë, në këtë periudhë të vështirë për fenë islame, ku terrorizmi dhe luftërat kanë krijuar përshtypje të gabuar. Feja islame është fe e mirëkuptimit, respektit, bashkëjetesës. Predikon paqen dhe dashurinë për njëri-tjetrin".

Musai ka një lidhje shpirtërore me Teqenë e fshatit dhe xhaminë, që janë ngjitur me njëra tjetrën, krah për krah, sikur duan të tregojnë lidhjet e ngushta mes njëra-tjetrës, por edhe të banorëve të Dibrës me to. Xhamia dhe Teqja janë mbi 500 vjeçare në këtë fshat. Musai para ca vitesh ka botuar edhe një libër që ua ka kushtuar Klerikëve që kanë shërbyer në këto dy tempuj të besimit dhe kulturës.

Pasi dalim nga xhamia, me ne bashkohet edhe Jahje Maha, një burrë rreth të 50-tave. Biseda me të është e këndshme, e hapur dhe me plot humor. "Limjani është një fshat i qetë, njerëzit janë punëtorë dhe shkojnë shumë mirë njëri me tjetrin". Ai ngre shqetësimin e rrugës, e cila është e keqe dhe pengon lëvizjen e makinave të vogla. "Në qoftë se rruga do të ishte e mirë, fshati do të ripopullohej. Njerëzit do të rikthehesin të rregullonin shtëpitë dhe gjallëria në fshat do të ishte e vazhdueshme".

***

"Një ditë me Musain, në fshatin e tij të lindjes, ishte një ditë e këndshme, e paharrueshme - thotë Hysen Uka, pedagog, mik i Musait, i cili së bashku me Redonin si shofer, na shoqëruan rrugës për Limjan. Ishte një ditë e mbushur me plot dashuri e respekt që nga fëmijët e deri tek më pleqtë. Bisedat e shtruara e të ngrohta na shoqëruan ngado, që nga mjediset e shkollës, biseda këmbëkryq me imam Mexhitin në shtrojet e xhamisë, shakatë e kafeja në shtëpinë e Besnik Mahës. Ngado ku shkuam e këdo që takuam, u pritëm me respekt dhe morëm shumë dashuri. Por, ndërvete kjo ditë me Musain, kjo marrëdhënie e ky respekt, më bënte të ndjehesha me faj. I beja pyetje vetes: a do të më kishte kushtuar shumë mua, të bëj një gjest si Musai, a do të kisha humbur shumë kohë unë të shkoja një ditë në Lishanin (tim) të Epërm, një fshat shumë i ngjashëm me Limjanin, ku të takoja pleq e fëmijë e të fitoja atë që kish fituar Musai? Respekti është gjëja që kushton më lirë, por ne e japim shumë të shtrënguar, me shumë kopraci, jo nga mos dashja por nga përtesa... Të gjitha ata fëmijë që e njihnin dhe e thërrisnin me emër, nuk do ta harrojnë kurrë ditën e gëzueshme të librit që ai u dhuroi dhe do t'ia kujtojnë Musait edhe kur ai të jetë bërë 100 vjeç... Por jo të gjithë ne dimë të sillemi e të bëjmë punë që mbahen mend... Kjo e dallon Musain dhe për këtë duhet t'i themi Faleminderit!

Nga fshati largohemi në këmbë, duke bërë fotografi për kalendarin e radhës së Musait. Vjeshta ka rrethuar bukur fshatin me ngjyrat e arta, por imazhi i fëmijëve që u lumturuan nga librat është i pazëvendësueshëm...



Lista e librave dhuruar shkollës nga Musa Riçku

Autori	*Titulli i Librit*
	Përralla Magjike - Mirësia
	Përralla magjike - Bujaria
	Përralla Magjike - zgjuarsia
	Mirësevini në Dibër
	Çelësi i Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe
	Steve Jobs - Njeriu që ndryshoi botën
Abdurrahim Ashiku	Rrëfimet e Komshiut
Abdurrahim Ashiku	Shkolla shqipe e Selanikut
Abdurrahim Ashiku	Shkolla shqiptare e Athinës
Abdyl Sulaj	Larushia e fjalës në gojën e popullit
Agron Tufa	Nga hiri i të vdekurve
Agron Tufa	Dibra me sytë e të huajve
Agron Tufa	Dueli
Agron Tufa	Fryma mbi ujëra
Arian Kadiu	Hape portën e artë të leximit
Arian Kadiu	Adoleshentët dhe tranzicioni
Arian Kadiu	Dibra e Madhe dhe një vështrim në Dibrën e Vogël
Arian Kadiu	Kur dremiste sahati i Tiranës
Arian Kadiu	Edhe 100 figura dibranësh
Asdreni	Poezi të zgjedhura
Çajupi	Baba Tomori
Demir Osmani	Këshilla praktike për përdoruesit e rrugës
Demir Osmani	Edukata Rrugore
Eqrem Basha	Shtëpia e mallit
Faik Konica	Shqipëria si mu duk
Fan Noli	Album
Faruk Borova	Dinastia shqiptare që sundoi Misirin
Gjergj Fishta	Mrizi i Zanave
Jean Racine	Andromaka
Jeronim de Rada	Këngët e Serafina Topia
Kristo Frashëri	Historia e Dibrës
Kristo Frashëri	Etnogjeneza e shqiptarëve
Kristo Frashëri	Abdyl Frashëri
Mitrush Kuteli	Shenime letrare
Mitrush Kuteli	Havadan me Havadan
Mitrush Kuteli	Poem Kosovar dhe Poemi i Shendaumit
Mitrush Kuteli	Xinxifilua
Mitrush Kuteli	Proze dhe vargje të zgjedhura
Leka Ndoja	Komentari i Letërsisë
Lutfi Hanku	Marsi i vrarë
Lutfi Hanku	Gjokë Doçi
Lutfi Hanku	Loti rebel
Mimoza Tola	Nuk është më si më parë
Mimoza Tola	Rend pas së tashmes sime
Naim Berisha	Zëri i malit të Shën Mërisë
Naim Berisha	Sagë e vjedhur kohe
Naim Berisha	Pengu i nëndheshëm
Naim Berisha	Lejlekët e lumit tim
Naim Berisha	Kur grinden skeletet
Naim Berisha	Shpirti i heshtur
Naim Berisha	Vdekja e deles
Naim Berisha	Haiku
Naim Berisha	E drejta e padrejta dhe kadiu
Naim Berisha	Luleçelur në degë të mollës
Naim Berisha	Sonetet e Shekspirit
Naim Frasheri	Ëndërrime
Naim Frasheri	Fjalët e Qiririt
Naim Plaku	Po të mos ishte Drini
Naim Plaku	Fllad e frullizë
Naim Plaku	Krojet e zanave
Naim Zoto	Antologji për gjuhën shqipe
Ndre Mjeda	Juvenilja
Nikollai gogol	Tregimet e Peterburgut
Petrit Fetahu	Studime folklorike dibrane
Petrit Fetahu	Pasione në kohë
Petrit Fetahu	Bilbili dhe korbi
Petrit Fetahu	Mishmash
Ramiz Gjini	Bibollasit
Ramiz Gjini	Posta që sjell era
Ramiz Gjini	Atdheu prej dëbore
Ramiz Gjini	Mendjet e njerezve
Sami Frasheri	Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe çdo të bëhet
Sazan Goliku	Grenza dhe mjalti
Sazan Goliku	Bariu i vogël, ujku dhe bora
Shaban Sinani	Midis dy rilindjesh
Shaban Sinani	Letërsia në totalitarizëm
Shaban Sinani	Pyetje në albanologji
Shaban Sinani	Mitologji në eposin e kreshnikëve
Shaban Sinani	Camaj i paskajuar
Shaban Sinani	Hebrenjtë në Shqipëri
Shaban Sinani	Tradita gojore si etnotekst
Shaban Sinani	Ndajfoljet përemrore
Shaban Sinani	Njerëzit e krisur e Dritëro Agollit
Shaqir Skarra	Gurrat e Korabit
Sofokliu	Antigona
Vellezerit grim	Na ishte njëherë
Viron Kona	Dëgjoni ç'thotë ky papagall
Viron Kona	Dielli është i imi
Viron Kona	Drithërimat e yjeve
Viron Kona	Zonja nga Borasi
Viron Kona	Kontroll i befasishëm i një inspektori
Viron Kona	Të fshehtat e një mrekullie
Vladimir zoto	Balada Shqiptare
Vladimir Zoto	Enciklopedia gjeografike e botës
Xhafer Martini	Hilmi Kolgjegja, një vend në panteon
Xhafer Martini	Proza popullore në prerjet rrethore
Xhafer Martini	Novela
xhafer Martini	Optika e Shmitit për Skëndërbeun
Xhafer Martini	Gjenerali me shajak
Xhemal Domi	Dibra në hulli të historisë (Tre vëllime)
Zenel Sula	Përjetime, Meditime



Eltion Seferi: "familja, kombi, shoqeria, puna janë ato që më inspirojnë gjatë gjithë jetës time"

28 vjeçari dibran - *në rrugën e suksesit* **në Amerikë!**

Nga **BEQIR SINA**

NEW LONDON CT: Eltion Seferi - është një nga biznesmenët shqiptar ndoshta edhe nga më të rinjët në Amerikë, që mund të futet në listën e rrugës së biznesmenve të sukseshëm. Megjithëse, i ri në moshë dhe në biznes, por me punën e tij - ai ka arritur të bëj emër dhe të këtë sukses, të paktën në qytetin ku ai jeton - në një zonë të New London të Connecticut. 28 vjeçari nga Peshkopia - i cili 8 vjet më parë emigroi në SHBA - është bërë tashmë shumë i suksesshëm në karrierën e tij, pavarësisht, se ai nuk ka dëshirë të flasë për këtë gjë, nga thjeshtësia që e karakterizon.

Lidhur me suksesin e tij - një nga supermerkatet më të mëdha në SHBA - "Home Depot", në hyrje të saj vendosi fotografinë dhe logon e firmës LT Construction - duke e mbajtur atë për një vit - Aty duket Eltion Seferi i dalë në fotografi me presidentin e Home Depot, i përshkruajtur nga kjo firmë e madhe amerikane, si i dalluar për punën e LT Construction - e cila punon kryesishtë me materialet ndërtimore të këtij rrjeti gjigand për furnizimin e kompanive me materiale ndërtimore, si krenarinë e suksesit të saj.

Eltioni qysh në bangot e shkollës, pra paralel me të, edhe ka studiuar por edhe ka punuar në Tiranë. Ai përfundimisht, do ta "braktiste" vendlindjen e tij - duke emigruar fillimisht fare i ri në Itali (Venecia) në vitin 2002 - Teksa në moshën 16 vjeçare, ai mori rrugën e kurbetit, për të studiuar dhe punuar njëkohësisht. Pavarësisht, moshës, dhe vështërsive, që i kan dalë përpara si çdo emigrant, me punën e firmës së tij ai ka arritur për t'u bërë një biznesmen shumë i suksesshëm.

Ai thotë se suksesi i tij ka ardhur nga përballja me vështërsitë, dhe "betejat" e fituara deri tani me emigrimin - ashtu si çdo emigrantë, që e përfshijn së pari ato vështirësit e fillimit që nisin me atë për të komunikuar me gjuhën Angleze, dhe më pa në fushën e biznesit apo edhe njohja e këtij apo atij lloj biznesi.

I lindur në Peshkopi, në vitin 1986, ai ka jetuar në Tiranë deri në vitin 2002. Në Shqipëri, pasi mbaron shkollën ai ka punuar si Elektroauto në një qëndër për riparimin e automjeteve tek stadiumi Qemal Stafa, me një mjeshtër të njohur në Tiranë - Gezim Dino.

Si shumë shqiptarë të tjerë - i përfshirë në "rrugën e kurbetit" - në vitin 2002, ai ka emigruar për në Itali, ku mbasi iu aprovua e drejta e qëndrimit, ka jetuar si emigrant legal (me dokumenta te rregullta) në Venezia duke punuar atje tek kompania Berengo spa dhe vazhduar studimet.

Megjithse, në Itali, jetonte si emigrant i rregullt dhe pa probleme - synimi i tij ishte për të jetuar e punuar në "Tokën e Premtuar" - "Eldoradon", pra në shtëpinë e dytë të shqiptarëve, në SHBA , ku vendoset afër vëllait të tij Denisit, i cili ka emigruar më parë se ai në Amerikë.

Duke folur për gazetën tonë, Eltioni nuk e fsheh atë sepse zgjodhi Amerikën :" Unë vendosa të vijë në SHBA - sepse, jeta dhe emigrimi në këtë vend - ka ndryshim të madh nga qendrimi në Europë. Këtu ndodhej vellai im i madh, i cili me dha mbështetje, që unë të emigroja në SHBA në vitin 2006".

SI NISI JETA NË AMERIKË?

"Unë në fillim erdha tek vellai im Denis Seferi, thotë Eltioni dhe vazhdova duke punuar tek kompania e tij në sektorin e ndërtimeve. Dy vitet e para ishin të vështira për mua, sepse, nuk dija gjuhën Angleze dhe jetesa ndryshonte shumë nga vendet, ku unë kam qenë përpara se të vija në SHBA- pra integrimi ishte pak më i vështirë" sqaron ai..

Mirëpo, shprehet ai me vullnet dhe i bindur në atë se çfare është të kesh një firme ndërtimesh në biznesin Amerikan - dhe sa është e "lehtë" të besh biznes të tillë në SHBA, në kushtet e një konkurrence "të egër", ai nisë e shpjegon për suksesin.

"Si në çdo vend të botës për t'u bër një biznesmen të merr kohë e shumë punë, thotë Eltioni, duke shtuar se ndryshimi me qenë një biznesmen në Amerikë, është që të jepen mundësite në çdo fushë pune.Këtu tha ai vlerësohet puna dhe zgjuarsia, duke patur këto pika, suksesi vjen e rritet çdo ditë e më shumë".

Krenar për punën

-"Kompania ime, quhet LT Construction LLC, dhe ndodhet në pjesën juglindore të Konektikët e qujtur New London. Megjithatë, ne punojmë në të gjitha zonat e Easter Connecticut. Ndërsa, punët që ne bejmë janë: Specialist stucco- Rinovues shtëpish - Marangos krijues -Shërbime për ndërtime me beton - Planifikime dhe dizajnime shtëpish".

Kurse shton se :"Në kompaninë LT Construction për një periudhë kohore 3 vjeçare kemi berë mbi 400 klientë -costumere, të kënaqur me punët tona, si nga ana profesionale, korrrektesa, shpejtësia dhe cilësia e lartë e punës, dhe ne atë që ju prmetojmë klienteve tanë, ua kemi kryer ashtu si edhe kemi kontraktuar me ta. Kështuqë, kemi fituar edhe respektin e shumë kilenteve, duke i bërë ata për vete.

Por, do të veçojë shtoi ai se disa nga punët që janë të veçanta në llojin e tyre, jemi duke i paraqitur nëpërmjet këtyre fotografive"



NGA ELTI NË LT, NJË IDE PËR EMRIN E KOMPANISË

"Që në moshën e re më kanë thirrë siç i thonë këtu në Amerikë në nick name - Elti, dhe kur erdha në SHBA më thirrnin eLTi,. Kurse, kur unë vendosa të hap kompaninë time, mendova që ishte shumë e lehtë për komunikim dhe zgjodha emrin e kompanis, që të më prezantojë mua dhe ia vura emrin - LT Construction, emër që kompania mban edhe sot.

Kompania e tij në këtë zonë, ka bërë shumë punë edhe për familjet shqiptare, në këtë zonë ku ai me kompaninë e tij punojnë në ndërtimtari,ka provuar punën e mirë të kompanisë LT, duke mbetur shumë të kënaqur. Dhe, natyrishtë, që kjo i ka vlejtë atij - të njihet edhe me shumë shqiptarë që jetojnë në këtë zonë ose kan shtëpitë e tyre.

Një nga ata - është edhe nënkryetari i Vatrës, zoti Agim Rexhaj, i cili e ka provuar vetë rezultatin e punës së shkëlqyer të "dorës" së rikonstruimit të shtëpisë së tij dhe biznesit tek pizza restoranti, e cila tani mbas punës së LT, dhe sidomos ushqimit të saj e ka rradhit këtë biznes si një ndër picerit më të mira në zonë, e vlerësuar kjo nga 33 mijë dëgjues të radios Q105; " Si peceria më e mirë".

ELTION SEFERI - ANËTARI MË I RI I VATRA

"Vatra, është një organizatë e vjetër e shqiptarëve të Amerikës, tregon Eltioni, duke shtuar se, kam lexuar se atë e krijuan kolosët e kombit, Noli dhe Konica e të tjerë, në vitin 1912. Vatra kam lexuar se na ka mbrojtur historikisht, edhe atëhere ku mungonte shteti shqiptar, sidmos me të drejtat e Shqiptarëve nga Shtetet e Bashkuara, duke e ngritur zërin në Uashington, qysh në atë kohë. Papermendur këtu edhe kontributet e saj, sidomos, ndihma e saj, qysh atëhere me afro 200 mijë dollar. Vatra ka dërguar qysh në atë kohë trupat e saj me simbolin TV(Trupat e Vatres) për të mbrojtur vatanin dhe nga Amerika. Ajo është përpjekur në lobimin e saj në Kongresin e SHBA për të drejtat e Shqiptarëve në mbarë botën, gjatë gjithë historisë së saj." shprehet Eltioni.

Ndëra shton se në këtë këndëvështrimin tim, por edhe duke u inflencuar nga nënkryetari i Vatrës, zoti Rexhaj, dhe duke parë organizimin e Vatrës, dhe historinë e rëndësishme të saj - "unë vendosa që të bëhem anëtar i Vatrës me një dëshirë të madhe, dhe me këtë rast gjej vend tju bëjë thirrje edhe shumë shqiptarëve të rinjë si unë, të anëtarësohen - dhe që të gjithë bashkë të mbajmë afërsinë me njëri tjetrin dhe historinë tonë, jo vetëm këtu në emigrim - por edhe në Shqipëri, Kosovë dhe kudo ku flitet e këndohet shqip, por edhe në vëndet ku mbarë Shqiptarët kan emigruar".

Ai vetë në saj të punës së mirë me cilësi dhe çmime të volitshme , në zonën New London të Konektikët, ku jeton një komunitetet i vogël shqiptarësh dhe ku ai vetë jeton me famijen e tij - gruan dhe vajzën, ka arritur të ket nji lidhje shumë të mirë me komunitetin, dhe komunitetin e biznesit, atje.

Eltioni është një djalë shëmbullor, ai është nga ata shqiptarë që jeton me kohën, dhe punon me kohën, ku ju jeta është, familja, kombi, shoqëria, puna dhe biznesi, aty ku ai po e shikon tashmë edhe të ardhmen e jetës së tij.

Çka ai vetë e pranon duke thënë se : "Unë të ardhmen time e shikoj tek, familja, kombi, shoqeria, dhe puna në kompanin LT Consruction, në zgjerimin e kompanies dhe në përhapjen e emrit të mirë që ajo ka marrë - deri tek suksesi, natyrishtë". Së fundi Eltion Seferi nga kompania LT Constriction, përcjell edhe një mesazh urimi me rastin e ditës së Flamurit - 28 nentorin 102 - Vjetorin e Shpalljes së Pavarsisë së Shqipëris, duke thënë se: " Të gjithë shqiptarëve kudo që janë urojë përzemërsisht :-Gëzuar 28 Nëntorin - festën e Flamurit të gjithë shqiptarëve kudo që janë....!"

botime


Botohet fjalori Shqip-Arabisht i Sulejman Tomçinit

Pas botimit të disa viteve më parë të Fjalorit Arabisht-Shqip me rreth 80 mijë fjalë e shprehje, specialisti i gjuhës arabe z.Sulejman Tomçini u paraqit kohët e fundit me një fjalor të ri, këtë herë shqip – arabisht. Ashtu si dhe i pari edhe ky është i pari fjalor i këtij lloi në trevat shqiptare.

Fjalori është botuar nga Shtëpia Botuese LOGOS-A në Maqedoni dhe permban rreth 35 mijë fjalë e shprehje gjuhësore.Ai eshte botuar në nje format te bukur dhe terheqës.

Shpresojmë që ai të mbushë boshllëkun që ka ekzistuar ne vëndin tonë për një fjalor të tillë,duke ndihmuar gjithëata që mësojnë apo duan të mësojnë gjuhën arabe,që është edhe gjuha e Kuranit fisnik,librit te shenjtë të muslimanëve.

Për sqarime të mëtejshme, të interesuarit mund të hyjnë në lidhje me Shtëpinë Botuese në adresën elektronike: **www.logos-a.com**



Promovohet **"Testamenti i atdhedashurisë"**

Në kuadrin e 70-vjetorit të çlirimit të atdheut, Qendra Kombëtare e Artit dhe Kulturës "NACIONAL" dhe OBVL organizuan në sallën e Akademisë së Shkencave "Aleks Buda" në Tiranë promovimin e librit "Testamenti i atdhedashurisë" i gazetarit dhe shkrimtarit Halil Rama.

Në çelje të këtij takimi promovues morën pjesë miq, bashkëpunëtorë të autorit, por dhe personalitete të artit dhe kulturës.

Mujë Buçpapaj, drejtor i Qendrës Kombëtare të Artit dhe Kulturës "NACIONAL" përgëzoi autorin për punën e bërë, duke sjellë për lexuesin një vepër mes publicistikës dhe letërsisë.

Kryetari i OBVL-së, gjeneral Rrahman Parllaku, Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit u shpreh se "Titulli i librit i shkonte moshës sime, jo Halilit, por kur lexon librin e tij e kupton që TESTAMENTI ka lidhje me përmbajtjen, me atë çfarë sjell në libër e që e lë të shkruar për publikun...". "Artikujt e Halilit vijnë kryesisht nga treva e Dibrës, vendlindja e tij, thotë Parllakui. Ai e mbyll librin me të vërtetën e madhe se atdheu fillon nga familja...e pas familjes vjen ambienti krahinor. Unë me Halilin po punoj mbi 15 vite. E kam njohur si karakter të drejtpërdrejtë e të hapur; punëtor e studjues skurpuloz. Halili, si kryeredaktor e ka bërë gazetën "VETERANI"të këndshme për lexuesit. Na ka dhënë pesë libra, presim prej tij libra të tjerë.

Dr.Shpëtim Cami foli për tematikën e librit, tematikë e përzgjedhur dhe trajtuar me mjeshtri. "Testamenti i atdhedashurisë" është kurora e shkrimeve të tij duke kaluar sprovat letrare e publicistike e duke margjinalizuar kështu mendimet e idetë në një letërsi të mirëfilltë, të shprehura këto në essetë e refleksionet për Bujanin historik nga ku 70 vjet më parë u projektua vetëvendosja për Kosovën e lirë e të pavarur.

Vlerësime pozitive shprehën gjithashtu për këtë libër



edhe Fisnik Sina - kritik letrar, prozatori Andon Andoni, muzikologu dhe publicisti Shaqir Rexhvelaj, Dr.Hajri Mandri-poet dhe kritik arti, Dr.Astrit Memia – Drejtor i Fondacionit "Imazh-Media", vëllai i autorit, Selman Rama si dhe Besim Ndregjoni, kryetar i Shoqatës mbarëkombëtare të ish të përndjekurve politikë.

Duke iu referuar krijimtarisë, jo vetëm produktive por dhe mjaftë cilësore të Halil Ramës, ata thanë se ky autor dëshmon se dera drejt artit e letërsisë është e çelur kurdoherë për të gjithë ata që duan t'i testamojnë dijet e njohuritë si diçka të vyer për shoqërine. Por, siç do të shprehej poeti i ri Dikë Daci – student i Universitetit të Durrësit, rruga drejt kësaj dere është e gjatë e plot peripeci, madje duke i ngjarë mitit te Sizifit, por që në rastin konkret, falë dhuntisë e vullnetit, H.Rama arrin ta shembë duke korrur sukses në fushën e letrave. Ata vlerësuan Tematikën e librit të ri të Halil Ramës, si të mbrujtur me lëndë jetësore nga e cila buron një letërsi e mirëfllitë.

Ky promovim u moderuar në mënyrë brilante nga gazetari i njohur Defrim Methasani.

Botim i ri



Agron Tufa - **NGA HIRI I TË VDEKURVE**

Botime M&B. **ISBN: 978-9928-172-39-6**. 164 faqe. Çmimi: 700 lekë

"Nga hiri i të vdekurve" - një libër me ese kulturologjike. Në këto ese shkrimtari trajton raportet e tij me fëmijërinë, vendlindjen, kulturën, traditën, ideologjinë, gjuhën, historinë dhe artin e të shkruarit. Përmes stilit të tij ekspresiv, dinamik e sugjestiv, Tufa në këto ese bën një guidë meditative nëpër stacione të trazuara të së shkuarës dhe bashkëkohësisë dhe në sëmundjet e qytetërimit tonë.

Libra të tjerë nga Agron Tufa që i gjeni në librarinë e Botimeve M&B:
"Dueli" - Roman, "Frymë mbi Ujëra"- Poezi, "Dibra me sytë e të huajve"

Tel: + 355 4 22 33 283 / + 355 692068603 / + 355 686508441 / + 355 673073265
email: mbbotime@gmail.com

Fjalë arabe që qarkullojnë në të folurën e Dibrës

Nga **SULEJMAN TOMÇINI**

Ashtu si në mbarë gjuhën shqipe,edhe në të folurën e Dibrës përdoren shumë fjalë arabe,qe kane hyrë nëpërmjet turqishtes.Disa prej tyre ruajnë kuptimin dhe domethënien e tyre origjinale,ndërsa disa të tjera jane transformuar.Këte transformim mund ta kete bere gjuha turke,nga e cila erdhën tek ne,ose edhe vete gjuha shqipe gjate viteve.Unë nuk e njoh gjuhën turke,që të mund të japë ndonjë mendim të specializuar për përdorimin dhe kuptimin e këtyre fjalëve në këtë gjuhë.Por po mjaftohem duke i rënditur një pjesë të madhe të tyre,se mund të ketë edhe të tjera,duke dhënë kuptimin e tyre në gjuhën arabe. Ndërkohë mund të ketë edhe ndonjë fjalë shqipe që rastësisht ngjason me atë arabe,gjë që mund të sqarohet nga studime te mëtejshme nga specialistët e fushës.

Them se disa prej këtyre fjaleve mund të ishin zëvendësuar me kohë me fjalë të shqipes,disa të tjera tashmë jane rrënjosur dhe janë bërë pjesë e fondit të saj leksikor.Megjithate, me pakë përpjekje, shumica e tyre mund te zëvendësohen me fjalë shqipe.

* * *

Abdall – i dalë jashtë funksionit, i ndaluar
Abrash – 1.lebroz; 2. pullali. Ne te folmen e Dibrës kjo fjalë përdoret në kuiptimin e njeriut të keq por edhe njeriut të shkathtë.
Adalet –drejtesi; Është adalet- është i drejtë. Në të folmen e Dibrës: njeri i zoti a i shkathtë
Adet– zakon
Ahiret –bota e pertejme, bota pas vdekjes
Ajet –shenjë, shembull,provë. Ajetet e Kuranit – Provat a shenjat e Kuranit
Akraba - i afert. Prej ketu akraba + llëk – farefisni,lidhje familjatre.
Akrep – skorpion; akrep ore
Ala - mbi,si. Ala francezçe – si francezçe
Alamet– shenjë, markë prodhimi, distinktiv
Alifimatrak –fjalë e përbërë nga fjala **alif**,që është shkronja e parë e alfabetit arabe, dhe fjala **matrak** qe mund të vijë nga fjala mitraka,që do të thotë: çekiç . Në të folmën e Dibrës do të thotë i paditur a i trashë.
Allah – Zot. Prej këtu fjala allah-allah - O Zot,O Zot!, që shpreh çudi, si dhe shprehjet: Allah qerim - Zoti eshte bujar; Allahu Akbar – Zoti eshte me i madhi.
Ama – por
Aman – siguri, qetësi,garanci, mbrojtje. Në Dibër ka kuptimin e lutjes për diçka.
Amanet - porosi që i besohet dikujt
Amel – punë, biznes, veprim, aktivitet. Amelkeq – punëkeq
Amin – 1. ashtu qoftë. 2. i besuar,besnik
Araba– karrocë
Asël - prejardhje, rrënjë, burim,origjinë
Ashik – i dashur
Ashure – gjellë e përgatitur për t'u ngrënë në ditën e dhjetë të muajit muharem (muaji i parë i kalendarit hënor arab)
Asqer - ushtri, ushtarë
Astar - mbulesë; perde; mbulojë
Atlas – pelhurë më shkëlqim(lloj tekstili)
Axhami - i paditur, i huaj që nuk e njeh mirë gjuhën arabe. Në Dibër përdoret me kuptimin i vogël, që edhe gabon.
Axhele – nxitim, ngut
Azeb – torture, vuajtje
Bahçe - gezim,hare. Në Dibër përdoret me kuptimin e kopshtit me pemë.
Bajat – i ndenjur për ujin a qumshtin
Bakall – shitës zarzavatesh.
Balash – pa asgjë, lirë në tregëti
Ballgam - 1. këlbazë; 2. jargë
Basiret – aftësi për të kuptuar a për të arsyetuar; dije; experience. Do ta shohim basiretin tend – Do ta shohim aftësinë tënde mendore
Batall – 1. që ka ndaluar,që nuk vepron. 2. trim, guximtar; hero; kampion
Batanije - mbulesë e leshtë
Be – betim besnikerie
Bedel – zëvendësues
Beden – mburoje e shkurtër; trup,trung.
Beharna – erëza
Bejte – varg poetik
Bela - fatkeqësi; sprovë

(Vijon numrin e ardhëm)

Rruga e Arbërit nr. 103

recensë

Zef Vladi sjell librin e titulluar “Plagë shtegtimi”, ku na pasqyrohet jo vetëm Lura, treva e bukurisë dhe karareve të vyera, por përshkruhen dukuri, ngjarje, jeta, vitet dhe njeriu...

“Plagë shtegtimi” i Zef Vladit, rrezatim i jetës dhe dhimbjes

Nga **MEVLUD BUCI**

Qysh në krye të herës, poetin e nderuar nga Pregj-Lura e trevës së Lurës së Dibrës, me banim në Tiranë, do ta quaj poetin që pasqyron përmallimin e traditat e vendlindjes, kronisti mjeshtër që gdhend brengat e kurbetit. Këto e plot motive të tjera dashurie për njerëzit, për trojet, për vëllazërimin fetar e krenarinë legjitime për popullin e vendlindjes, janë shpërfaqur në librin e dytë “I kemi borxh vendlindjes”, e cila është një vlerë e shtuar në letërsinë e re të viteve të demokracisë.

Pas librit të parë “Estref Gjoshi biri i Dumresë” (monografi), librit poetik “I kemi borxh vendlindjes” dhe librit “Brengat e kurbetit”, autori Zef Vladi sjell librin e katërt, të titulluar “Plagë shtegtimi”, ku me 163 faqet e tij rrezaton dhimbje, jeta njerëzore me gjurmët, fisnikërinë dhe tablotë e saj, ku na pasqyrohet jo vetëm Lura, treva e bukurisë dhe karareve të vyera, por përshkruhen dukuri, ngjarje, momente, mesazhet e heshtjes, “malet bashkë po kuvendojnë”, “avazet e shekullit njëzetë”, “dasmat në vendlindje”, “nderim për të ndjerët”, “gjakmarrja”, “jeta, vitet dhe njeriu” e plot të tjera, të cilat përbëjnë kapitullin e parë të këtij libri poetik –studimor.

“Vendlindja pjesa me dashur e Atdheut” përbën kapitullin e dytë, i cili mbyll tërë librin.

Zef Vladi sikur e ka marrë Lurën me vete, në Tiranë. Ai shkruan me realizëm e frymëzim, poezia e tij ka origjinalitet, dukuri të kohës e të traditës, përcjell mesazhe malli, dashurie, krenari për vendlindjen, dhimbje për plagët e shtegtimit. Autori Vladi, ky ish-mësues e drejtues shkolle në shkollat e vendlindjes, krahas shëmbëllimit prej mësuesi e organizatori të talentuar në mësimdhënie e drejtim (po ashtu edhe si mësues i nderuar e i përkushtuar në Tiranë, deri sa doli në pension), e njeh mirë profesionin, trevën e Lurës e me gjerë; njeh traditat e vyera të brezave, botën shpirtërore të njerëzve; njeh detajet e jetës. Pra, libri “Plagët e shtegtimit ”është një rrezatim i jetës e gjurmëve të saj, një pasqyrim dinjitoz i vlerave njerëzore, i bukurisë së shpirtrave të fisnikërisë, i motiveve të vendlindjes e mbi të gjitha i lartësimit të traditave e mallit njerëzor, i përshkrimeve poetike me thjeshtësi, qartësi e thellësi mendimi, duke na dhënë vargje epike-lirike me plot ide e mesazhe, me tone filozofike e krenari legjitime për njerëzit e vendlindjen, për kohën e brezat, për plagët e shtegtimit. Poeti Zef Vladi e nis librin e ri me poezinë e përmallshme e mjaft prekëse “Atë ditë që u larguam”. Kjo vlen edhe si thirrje që kurrë e asnjëherë nuk do harruar vendlindja, dheu ku ke lindur, trojet e lashta, mali, bjeshkët, lumi, kullat, oxhaku. Vargjet janë mjaft domethënëse dhe prekëse:

Ecnim me shikimin mbrapa
Oborret rënkonin nga vetmija
A duhet besuar se ishim ne
Apo shtegtonte vetëm hija...

Një retorikë e brendshme, një zë drithërues, por që përgjithëson këtë plagë të kohës :


O i bukur zog i verës
Kur të ik ai dimër i gjatë
Shko t’mi heqësh çelësin derës
Të hyjë lirisht flladi i pranverës...

Janë njëzetedy strofa të poezisë së parë që hapin librin, pra një poemth mjeshtëror që shpërfaq dallgë malli, plagë shtegtimi. Poeti Vladi e njeh jetën, i njeh dukuritë, gjithçka që përjeton e gdhend me mjeshtri në vargje:

...Rreth dy dekada kohe
Në ato vise mbijetese
Mister qenë rrugët e kurbetit
Por burim jetese e shprese....

(strofa e njëzetedytë e poezisë “Atë dite që u larguam”(fq. 9).

Poeti edhe natën në ëndërr e ka mendjen tek vendlindja. Jepen mjeshtërisht vargjet e poezive “Vargje malli e nostalgjie”, “Një recitim i përlo-



Poetin Vladi e frymëzon vendlindja, Lumi Malla, liqenet, bukuria e pyjeve, bjeshkët, kullat e mbi të gjitha njerëzit e traditat e vyera, miqtë e nderuar, mbresat e ekskursionit, gojëdhëna apo legjenda “Kastrioti si vetë emri” (I paharruari, heroi përballë ortekut), Kastriot Rajta, patrioti i shquar, nënkryetari e firmtari i Pavarësisë, diplomati e lurjani i arbërisë Dom Nikoll Kaçorri ...

tur”, “Kur u kthyen dallëndyshet ”, “Mesazhet e heshtjes”, ku midis te tjerash, z. Vladi shkruan :

Sipas rastit mund të vini
Në vere apo pranverë
Një tufë me lule mali
Mbi varre me na hedh...

Të një bukurie të veçantë janë poezitë: “Malet bashkë po kuvendojnë” , “Një mallkim i merituar”, “Avazet e shekullit njëzetë”.

Poeti Zef Vladi jeton me ngjarjet, vuajtjet, kohërat; me gjurmët e dhimbjes, të luftës së klasave dje (në monizëm); por edhe me dhimbjen tjetër se si kalvari i vuajtjeve të lëna pas nuk kanë të harruar.

Ajo nepërkë e zezë lufte klase
Si fantazmë na qëndroj mbi kokë
Na imponuan marrëdhënie të ngrira
Me farefis, miq e shok.....
(strofa 10, fq. 27)

Ndryshimet e viteve nëntëdhjetë
Historia i ka përjetësuar
Po kalvari i vuajtjeve që lan pas
Jo nuk kanë kurrë të harruar...

(Poezia “Avazet e shekullit njëzet”)

Në poezitë e poetit Zef Vladi gjen plot aludime, mendime të thella, vargje që në pamje duken herë-herë si prozaike, por në të vërtet kanë plot figura mjeshtërore, na përcjellin mesazhe mbresëlënëse, mesazhe të plagëve të shtegtimit, rrezatim dhimbjesh të jetës njerëzore. Autori Vladi na gdhend bukur inversionin (anasjellën), epitetet, metaforat, përshkrim mjeshtëror artistik, antitezat etj.

Janë shkruar me frymëzim e mall poezitë “Lura vendlindja ime”, “Atje ku natyra foli vetë”, (poemë epiko-lirike) njëzetepesë strofë:

..Përballë qëndron Bakullina
Më tej fusha dhe mali i Lanit
Një parajsë gjelbërim pa fund
Konkurrencë me fushën e Korabit... (fq. 64).

Poetin Vladi e frymëzon vendlindja, Lumi Malla, liqenet, bukuria e pyjeve, bjeshkët, kullat e mbi të gjitha njerëzit e traditat e vyera, miqtë e nderuar, mbresat e ekskursionit, gojëdhëna apo legjenda “Kastrioti si vetë emri” (I paharruari, heroi përballë ortekut), Kastriot Rajta, patrioti i shquar, nënkryetari e firmtari i Pavarësisë, diplomati e lurjani i arbërisë Dom Nikoll Kacorri (“Lurë e dashur mirë se të gjeta”, fq. 85-87)

Autori boton edhe një studim me vlerë: “Një vështrim rreth vlerësimit të figurës Dom Nikoll Kaçorrit” (fq. 88-93). Zoti Vladi e përfundon studimin me fragmentin:.....“Ne lurjanët nuk kemi qëllimin për ta privatizuar Dom Nikoll Kaçorrin, sepse ai është i të gjithë kombit, dhe gjithsecili ka nderin ta ketë pronë emrin dhe përmendoren. Po synojmë të vihet në vendin e duhur dinjiteti, vlerat dhe vepra e këtij burri të madh të kombit” (fq. 93).

Në këtë libër të çmuar, lexuesi gjen edhe poezinë për Heroin e Popullit, trimin e Lurës e të kombit, Gjok Doçi, i cili ra heroikisht për liri në Symizë të Mallakastrës. Po kështu, autori nuk harron edhe dëshmorët Ali Çupi e Dylejman Skana në vargjet poetike. Krahas tregimit “Anës Kurorës së Lurës”, Zef Vladi ka gdhendur edhe shkrimin “Rreth një veprimi intelektual dhe patriotik të një grupi intelektualësh lurjanë” (fq. 98-105).

Këtu, krahas problemeve e përshkrimeve, gdhenden e argumentohen rreth iniciatorit, ideatorit e financierit kryesor të bustit të Dom Nikoll Kacorrit, intelektualit human Atli Rasim Hoti, Ramazan Kalia, Naim Buci, Gjon Kaçorri, Sami Koceku, Hysni Gjoci, Hekuran Vladi, Nazmi Koceku, Ali Koceku, Defrim Methasani e të tjerë që ndihmuan në veprimtarinë për prijësin e firmëtarin e Pavarësisë, Dom Nikoll Kaçorri.

Autori me admirim shkruan për skulptorin patriot shkodran Pjerin Kolnikaj, dibranin Dylber Neziri, këngëtarët e mirënjohur dibranë Qerim Sula e Sherif Dervishi, këngëtarët virtuoz Zef Doci, Zaim Tollja, Hamit Batalli, Lodovik Rajta si dhe grupi artistik i shkollës 9-vjeçare Lurë, valltarët e talentuar Dali e Hysni Hoti. Autori Vladi e mbyll këtë shkrim: “Shpreh mirënjohje për atë që shkroi emrin në histori me pushkë e me penë të Dom Nikoll Kaçorrit .Po e mbyll këtë shkrim me thënien e të madhit Viktor Hygo: “Heronjve iu fillon jeta pas vdekjes.” Lavdi veprës dhe jetës së Dom Nikoll Kaçorrit (fq. 105).

Bashkë me poetin e studiuesin Zef Vladi, shtegton folklori i zonës së Lurës, figura e mësuesit në vështrimin e një nxënësi, mundësitë e zhvillimit të turizmit në zonën e Lurës, ku autori në këtë shkrim shpërfaq ide, fakte e mesazhe për Lurën e bukurive e të fisnikërive, për këtë vend që është model i vëllazërimit e bashkëjetesës së feve, vend i humanizmit, bujarisë, karareve të dheut e të bujarisë nëpër kohëra e mote.

Në kompozicionin e vendosur me mjeshtri nga autori para mbylljes, janë vënë poezitë: “Lurës”, “Dhe pak vargje mbi kurbetin”, “Shtigje drite”, “Mall dhe dhimbje”, “Në mes detit të trazuar”, “Nga historia e një rruge”, “Telefoni”, “Një moment trishtimi”, “Dallgët e shpirtit”, “Jetimët”, “Gjyshërit”...

Poeti flet me diellin, me stinët, me zogjtë shtegtarë “shpirti i digjet si prush”, ndjen përmallim për gjyshërit, për nipat dhe mbesat, për çdo cep të vendlindjes.

..Ti o diell, o yll i zjarrtë
Që kudo jep dritë e jetë
Atje ku kemi ne djem e vajza
Mos u ndal as nga retë...

Apostrofi, simboli dhe metafora, të vendosura me vend e në funksion të ideve, na japin qartë shpirtin e dallgëzuar të poetit Vladi, na pasqyrojnë mallin e dhimbjen për plagët e shtegtimit. Fakti që libri “Plagët e shtegtimit” mbyllet me shkrimin e spikatur “Mbresa nga një vizitë në Prekaz të Kosovës ” (fq. 145-151)

dhe poezinë “Ëndrrat drejt realitetit të plotë ” (fq. 152), tregon më së miri se poeti dhe studiuesi Zef Vladi e njeh thellë atë që shkruan, na ngjall emocione, na shpërfaq mendime të çmuara për njerëzit e jetën, për vendlindjen, dritën e atdhetarisë, amanetin e madh të korifeut të shekujve At Gjergj Fishtës, ku autori Vladi shkruan:

“Zoti thashtë që këtë shekull të ri që filluam, të realizohet thënia apidare e Gjergj Fishtës: “Kosova-Çamëri-Shqipëri”.

Mbresat nga Prekazi janë vërtet të shkruara me thjeshtësi e krenari, me frymëzim e shpirt-liridashësi, në dritën e zemrës luriane, me fisnikërinë prej biri të kësaj treve me histori te madhërishme luftërash, qëndrese, bujari, vëllazërimi e bukurie të pashoq: “Ajo vizitë e shkurtër në Kosovë la mbresë te ne, por dhe na shtoi krenarinë për emrin shqiptar. U kthyem me ndjenjën për të shkuar përsëri në atë vend ku zoti vetë e ka bekuar për begatitë që ka”, shkruan autori Vladi (fq. 151).

Në çdo poezi e shkrim është pothuajse shtegtimi, është shqiponja simbol që rri përmbi kurorën me dëborë në kopertinë, mjaft të arrirë, janë të njëzetetetë fotografitë me ngjyra, të cilat janë vënë me mjeshtri dhe sikur na flasin për Lurën, liqenin e luleve, Gurin e Kuq, përballë Pregj-Lurës, pamje nga Fushë-Lura, Lura e Vjetër, qendra e Lurës, Lura në horizont, grupi folklorik i Lurës (tek liqenet gjatë një xhirimi në TVSH), pamjet mahnitëse të liqeneve të Lurës në stinë të ndryshme, shtëpia e autorit Vladi, kulla dykatëshe në Pregj-Lurë, pamjet sot në Tiranë, në zonat ku u vendosën banorët e ardhur (viti 1995), pamjet në vitin 2012 (vilat trekatëshe), grupi folklorik i Lurës, të shquarin Visar Zhiti e Bilbil Billa me autorin Vladi, kolektivin e nderuar të mësuesve të shkollës “Halit Coka” në Bathore (1995), ku shërbeu së fundmi poeti e studiuesi Zef Vladi, fotot e vendit ku është lapidari i betejës së Lan-Lurës, pamje nga Lani (bjeshkë sipër fshatit Pregj-Lurë), foto të florës dhe faunës e kafshëve të egra, dhe mbyllet me fotot e Skënderbeut, Ismail Qemalit, Dom Nikoll Kacorrit në Lurë. Ky libër i autorit të nderuar Zef Vladi është një dëshmi e pasqyrimit të vlerave, një arritje e autorit, një shëmbëllim konkret me stil dhe gjuhë origjinale prej intelektuali, poeti e studiuesi.

Çdo lexues human e dashamir mëson shumë për plagët e shtegtimit .

Pra, pa as më të voglën hiperbolë, bazuar në tematikën e kompozicionin e këtij libri, theksojmë se autori na ka dhënë një libër të ri të arrirë, ku shpërfaqet rrezatimi i dhimbjes e mallit, rrezatimi i jetës njerëzore. Urime poeti dhe studiuesi Zef Vladi i Lurës, poeti i plagëve të shtegtimit.

Redaktoi: **Blertina Koka**

kujtime

Kujtimet historike (1912-1924) të Ismail Strazimirit
dhe 70-vjetori i çlirimit të vendit nga fashizmi

Dëshmori më i moshuar antifashist në shkallë botërore

Nga ARDIAN REÇI

Në nëntor të vitit 1943, pra, një vit para se Shqipëria të çlirohej nga pushtimi fashist, u vra nga nazistët Ismail Strazimiri. Duke iu referuar kësaj ngjarje, shkrimtari i njohur, Haki Stërmilli, në ditarin e tij të luftës shkruan: *"Katundarët thanë se gjermano-ballistat paskan djegë shtëpitë e Cen Elezit në Sllovë të Dibrës dhe në ndeshjen që qenka bam, paska ra dëshmor heroikisht Ismail Strazimiri, plaku 75-vjeçar që për sigurimin e lirisë së Atdheut kishte rrok armët dhe kishte dalë maleve. Sa hijshëm dhe lavdishëm e paska mbyll jetën ky atdhetar i ndershëm e i ndërgjegjshëm. Në këtë përpjekje gjermano-ballistët paskan vrarë e masakrue më shumë se 30 vetë prej katundarëve të pafajshëm që qenkan gjetur ndër shtëpija"*.

Kështu, me këtë shënim të shkurtër, do të shenjohej në histori fundi i jetës së një prej shqiptarëve më të mençur dhe më të emancipuar të gjysmës së parë të shekullit të 20-të, duke shënuar në të njëjtën kohë edhe një rekord: Ismail Strazimiri është, ndoshta, luftëtari antifashist më i moshuar në shkallë botërore, 75 vjeç. Përveç këtij fundi "me kapak floriri", Ismail Strazimiri do të mbetej në histori jo vetëm me aktivitetin e tij prej patrioti të flaktë, por, sidomos, me hedhjen në letër të kujtimeve të tij për Shqipërinë e viteve 1912-1924, të publikuara kohët e fundit nga shtëpia botuese "Naimi" nën titullin "Lufta kundër pavarësimit të Shqipërisë". Ai e shkroi këtë libër para 85 vjetësh, në vitin e largët 1931. Edhe pse për shumë dekada këto shënime mbetën si doreshkrim nëpër sirtare, koha që ka kaluar jo vetëm që nuk e ka pakësuar, por e ka rritur rëndësinë e tyre. E ka rritur deri në atë shkallë sa pyetja se cila mbetet ndihmesa më e madhe e këtij protagonisti zhvillimesh parësore të Shqipërisë: puna atdhetare apo përshkrimi i ngjarjeve të saj në këtë libër del e pashmangshme.

Nëse provat e njeriut janë nyjat kritike të jetës së vendit të tij, Ismail Strazimiri pikërisht në nyjat kritike të historisë shqiptare mbajti qendrimet më të denja. Shpallja e Pavarësisë; dy luftërat dhe dy paqet e paqendrueshme ballkanike; njohja e premtuar e një shteti shqiptar me kufij shumë në brendësi të hapësirës së vet historike; hapja e çështjes së caktimit të kufijve; projekti i Fuqive të Mëdha për një monarki të re pa monark në rajonin ballkanik; dorëheqja pa shpjegime e I. Qemalit; konkursi i princërve dhe shpërthimi epidemik i vullneteve vetjake dhe fisnore për kurorën e një shteti ende të panjohur ndërkombëtarisht; shpërthimi i Luftës së Parë Botërore dhe kryqëzimi i ushtrive të të dy palëve kundërshtare në Shqipërinë pa zot; janë zhvillime që çoroditin shumë lehtë edhe sot jo vetëm soditësin e historisë, por edhe studiuesin e saj. Ismail Strazimiri dëshmohet në gjithë këto rrjedha të turbullta atje ku i bëhej mirë atdheut të tij. Dhe kjo ndodhte vetëm në një grusht njerëzish idealistë, të cilët: nuk ishin pjesë e ndonjë projekti të të huajve për të sunduar në Shqipëri përmes duarve të zgjatura të tyre; nuk kishin ndërtuar plane vetjake për të shtënë në dorë Shqipërinë apo pjesë të saj dhe për t'i kthyer në pashallëqe; e donin sinqerisht atdheun e tyre pa ndonjë interes vetjak. Strazimiri paraqitet në jetën e vendit me vetëdijen e një rilindësi.

Gjëja e parë që mendon njeriu duke lexuar këto kujtime është se historia e fillimeve të shtetit shqiptar është një histori fatkeqe, apo e mbushur me protagonistë "fatzinj", sipas një shprehjeje të përdorur me parapëlqesë nga vetë Strazimiri. Elita e vjetër që kishte punuar për interesat e ish-perandorisë osmane pjesërisht e kishte kapërcyer të kaluarën, por pjesërisht kishte mbetur brenda idesë se perandoria e reformuar mund të ishte një strehë e shëndetshme për Shqipërinë. Një pjesë e kësaj elite, me mbarimin e "shekullit të romantizmit", ose ishte ndarë nga jeta fizikisht, ose ishte vendosur pa kthim në kryeqendra të mëdha europiane a gjetiu dhe mendonte ta ndihmonte çështjen e atdheut nga mërgimi. Shqipëria, në kuptimin e plotë të fjalës, pikërisht në kohën e themelimit të saj, kishte mbetur në



Ismail Strazimiri (1868-1943)


duar të dallkaukëve.

Ismail Strazimiri i shkroi kujtimet e veta vetëm për një periudhë prej 12 vjetësh: nga Shpallja e Pavarësisë deri te Revolucioni i Qershorit. Në këto 12 vjet, siç del edhe nga libri, ka mbrapshti sa për disa shekuj. Shqipëria u bë, por jo siç e deshën shqiptarët. Aq më pak siç e donte ai. U bë një Shqipëri që zyrtarisht thuhej se vërtitej në duart e Fuqive të Mëdha, por vërtetësisht rrotullohej sipas konkurrencës së parave të dhëna "krenëve" të saj nga Beogradi, Roma, Athina, Stambolli, Viena dhe kryeqendra të tjera të politikës botërore. Dhe pikërisht kjo është dhe dhimbja fisnike e Ismail Strazimirit: që Shqipëria u ndorua prej "krenësh pa krye", që e shisnin Jugun për "dishir" të Veriut e anasjelltas; që ia falnin dreqit të krishterët për një "Shqipëri të bekueme muslimane"; që i ndanin zotërimet e tyre prej Shkumbinit në Mat, prej Matit në Drin e kështu me radhë dhe në drejtimin jugor. Shqipëria e kujtimeve të Strazimirit është një republikë tribale, një shtet etnografik, ku për të kaluar nga një krahinë në tjetrën duhet "besa-besë" dhe asgjë tjetër! Eshtë një Shqipëri që, sipas shprehjes së Fishtës, nëse vërtet do t'ia dilte të përligjte pavarësinë e vet, kjo do të ndodhte "për inat të djallit dhe të shqiptarëve", që bashkëpunonin kundër saj.

Gati një shekull prej kohës që kanë ndodhur ato ngjarje; kur gjithsesi ekziston një përfytyrim konvergjent për rendin historik të kohës; pasi janë shkruar dhjetëra artikuj, studime e monografi për Ismail Qemalin; për Qeverinë e Vlorës dhe atë të Durrësit; për Esad pashën, rebelimin dumbabist të Shqipërisë së Mesme, Musa Qazimin dhe Haxhi Qamilin; për mbrojtjen e Shkodrës dhe luftën e Kolesianit; për dërgatën e Turhan pashës në Versajë dhe luftën e Vlorës; për atentatin në Paris dhe Kongresin e Lushnjes; është e lehtë të thuash se cili do të kishte qenë rreshtimi atdhetar më i denjë. Strazimiri dëshmohet në gjithë këto rrjedha të turbullta atje ku i bëhej mirë atdheut të tij.

Dhe kjo ndodhte vetëm në një grusht njerëzish idealistë, të cilët: nuk ishin pjesë e ndonjë projekti të të huajve për të sunduar në Shqipëri përmes duarve të zgjatura të tyre, domethënë vetë shqiptarëve; nuk kishin ndërtuar plane vetjake për të shtënë në dorë Shqipërinë apo pjesë të saj dhe për t'i kthyer në pashallëqe; e donin sinqerisht atdheun e tyre pa interes

"Katundarët thanë se gjermano-ballistat paskan djegë shtëpitë e Cen Elezit në Sllovë të Dibrës dhe në ndeshjen që qenka bam, paska ra dëshmor heroikisht Ismail Strazimiri, plaku 75-vjeçar që për sigurimin e lirisë së Atdheut kishte rrok armët dhe kishte dalë maleve. Sa hijshëm dhe lavdishëm e paska mbyll jetën ky atdhetar i ndershëm e i ndërgjegjshëm. Në këtë përpjekje gjermano-ballistët paskan vrarë e masakrue më shumë se 30 vetë prej katundarëve të pafajshëm që qenkan gjetur ndër shtëpija".



pragmatik. Ismail Strazimiri paraqitet në jetën e vendit të vet në kohën kur ai sa e kishte nisur historinë shtetërore, me vetëdijen e një rilindësi. Ai vetë është dëshmues i së vërtetës së pohuar, se ata që i kanë ndërtuar veprimet e tyre ashtu si do të kishin dashur të vepronin rilindësit, si rregull nuk kanë gabuar.

Shqipëria e viteve 1912-1924, siç na e dëshmon me dhimbje autori i këtij libri, ishte në kuptimin e plotë të fjalës një shtet etnografik-tribal, ku ligjin e bënin krerët e fiseve; një shtet që nuk ishte as monarki as republikë; një shtet ku krahinat shpallnin pavarësinë prej atdheut dhe ruanin me ushtarë vullnetarë "kufijtë" e tyre, urat, shtigjet e kalimit. Në shërbim të Qeverisë Kombëtare të Ismail Qemalit; mbështetës i princit europian Wied që kundërshtarët e paraqitnin si një katundar austriak dhe të dërguar të krishterimit; njohës dhe kundërveprues i drejtpërdrejtë dhe i ballëpërballtë ndaj politikave të ringjalljes së pashallëqeve, në krahun e revolucionarëve fanolistë në vitin 1924 dhe paralajmërues i rreptë i dështimit të tij; larg qeverisjes republikane dhe mbretnore; Ismail Strazimirit, megjithatë, i kishte mbetur dhe një sfidë e fundme: pjesëmarrja në luftën antifashiste. Ai njihet si dëshmori më i moshuar i kësaj lëvizjeje në shkallë botërore: ishte 75 vjeç kur u vra në Sllovë prej ushtrive të huaja dhe bashkëpunëtorëve të tyre, duke pasur në krah si bashkëluftëtarë të dy djemtë.

...është koha për t'u pajtuar...
KONTRIBUO PER GAZETEN
merr kopjen tende
email: rrugaearberit@gmail.com
vetëm 600 lekë në vit

Rruga e Arbërit nr. 103

Nëse do të shprehesha me një togfjalësh për qytetarin e Kalasë Dodës do të thoja - njeri i vetëndërtuar.

vendlindje

Kush është qytetari i Kalasë së Dodës?



Banori i Kalasë Dodës është patriot. Kur trojeve shqiptare u është kërcënuar ekzistenca, banorët e saj kanë luftuar kundër forcave osmane në mbrojtje të Lidhjes Shqiptare të Prizerenit...

Nga **METUSH SKEJA**

Kalaja e Dodës shtrihet mes dy përrenjve,Bistrica e Veleshica. Në përendim kufizohet me Drinin e ZI. Në Veri-lindje shkon deri mbi Gostivar. Ka sipërfaqe 274 km katror. Lartësia mbi nivel të detit fillon me 395m ku derdhet Veleshica në Dri të Zi dhe përfundon me majën e Korabit 2754m. Fshati më i ulët është Shullani 600m mbi nivelin e detit,ndërsa më I larti është Tejsi me 1250- 1300m mbi nivelin e detit.

Bimësia ka zonën e dushkut që shkon deri 1250m lartësi, zonën e ahut, halorët dhe kullotat alpine. Bimët e kultivuara janë misri, gruri të lashtat, patatja. Drufrutorët janë rrushi, molët kumbullat, arrat, dardhaetj. Me ndryshimet klimatike kultivohet edhe hurma, që më përpara nuk rezistonte nga dimri i acartë.

Për bukuritë e peizazhit të Kalasë e të Korabit unë do të sjell në vëmendje të lexuesit kujtimet e Eqrem Bej Vlorës. Ai e ka vizituar këtë zonë në verë 1912, dhe thotë se është unike për bukuri. Krahasohet vetëm me Tirolin. Në Shqipëri nuk ka si Korabi. (Eqrem Bej Vlora, kujtime f.274) Monteskie na mëson se një vend i bukur ndikon për mirë në karakterin e njerëzve. Si vendbanim Kalaja është i populluar para krishtit. Ka vijimësi pa shkëputje deri në ditët tona. Këtë na e tregojnë tumat, kishat katolike, toponimet, objektet e tjera të kultit. Në regjistrimet osmane të vitit 1571 të gjithë emrat e mbiemrat janë shqiptarë, asnjë sllav. Kjo përbën arsye për të shpjeguar personalitetin e banorve të kësaj zone.

Në perandorinë osmane ka pasur afro një milion krerë dele. Fisi Skeja ka patur 10.000krerë të imëta(dele) ose vetem familja e Dervsh Agës ka pasur 12.000 dele(Qamil Hoxha, kujtime, f.379) Sot djemtë e zonës Kalasë janë në gjithë kontinentet nga Alaska në Australi.

HANI, udhëtari austriak ,e ka vizituar Kalanë. Është mahnitur më pasurinë e madhe e luksin e jetesës. Ai thotë se është i vetmi vend në Shqipëri ku ka fjetur me çarçafë të bardhë e të pastër. Kjo ka ndodhur para 150 vjetësh. I solla vlersimet e të huajve se janë të paanshëm. Kalaja ka qenë konak për hasjanët, lumjanët, topojanasit, në rrugëtimin e tyre për në pazarin e Tiranës dhe Peshkopisë dhe për dibranët në pazarin e Prizerenit, Gostivarit, Tetovës. Por edhe ato na e kanë shpërblyer në mënyrë të ndërsjelltë.

Banori i Kalasë Dodës është patriot. Kur trojeve shqiptare u është kërcënuar ekzistenca banorët e saj kanë luftuar si dikushi. Kanë luftuar kundër forcave osmane në mbrojtje të Lidhjes Shqiptare të Prizerenit jo një e dy, por kanë marrë pjesë burrë për shtëpi. Edhe gjyshi i babait tim ka flakur gradat e ushtrisë osmane dhe është rreshtuar e më pas është vrarë në mbrojtje të Lidhjes. Po kështu i gjejmë të rreshtuar përkrah lumjanëve kundër Xhavit Pashës më 1909 e Dorgut Pashës më 1910. Në betejën e Drinit Nëntor 1912 kanë treguar heroizëm të veçantë. Në shtator 1913 kanë marrë pjesë kundër ushtrisë së Serbisë Parë në Pikllajmë dy javë ditë luftë pa pushim. Në tetor 1913 janë vrarë 42 veta nga Cereni e Ploshtani, 25 nga Shullani, 92vetë nga Kalisi nga ushtria serbe. Po më 1913 janë marrë peng 92 vetë,janë dërguar për tre muaj në Prizeren. Më 1920 e tërë zona i ka bërë rezistencë e më pas është djegur nga forcat e ushtrisë Serbisë Dytë. Është për tu kujtuar se Kalaja ka dy gra dëshmore, Bedrie Brikën të rënë më 1913 dhe Naxhie Murrakun të rënë më 1920, të dyja kundra forcave serbe. Nuk janë vrarë në shtëpi, por me pushkë në dorë në Sorokol.

Banorët e Kalasë janë njerëz puntorë. E kërkojnë mirëqenien me çdo çmim. Të aftë për jetë. Përshtatë mirë në çdo mjedis. Emigrantët në Britani e kanë mësuar shpejt gjuhën angleze. Po kështu edhe ata në SHBA, Itali, Gjermani. Në Perandorinë Osmane shtegtonin me dele dimrit në Selanik e Izmir. Verës kishin bjeshkët e shumta të Korabit për kullotë. Lufta e Parë ballkanike u shkatërroi 25.000 krerë dele. Në diktaturën komuniste kanë qenë belaxhinjë të regjimit e ky i fundit hakmerrej me format cinike të diktaturës, në radhë të parë, duke u dhënë status të ulët,ngrinte paragjykime që shoqëroheshin me sjellje diskriminuese. Qendrimet e sjellja fuqizonin negativisht në mënyrë të ndërsjelltë njeri- tjetrin.

Ndërtesat kanë qenë dy e tre kate. Mbulesa ka qenë me rrasa guri ose furde. Me ujë të pishëm në çdo lagje. Këtë ua lehtësonte burimet e shumta të ujtë. Ujësjellësat kanë qenë ndërtuar me gjyrez me rrasa guri të izoluara si lëndë lidhëse gëlqere me të bardhën e vezës. Kanë përdorur gëlqerën. Sot ndërtesat më të bukura rreth Tiranës janë të ardhurve nga zona e kalasë. Po paraqes dy banesa tipike të zonës në fjalë.

Banori i Kalasë Dodës ka edukatë qytetare. Nuk e kanë praktikuar luftën e klasave ashpër në diktaturë, siç urdhëronte ajo. Shumë më butë. Shkonin tek të ashtuquajturit të deklasuar e kulak pa asnjë pengim në raste fastash, dasma,mort,u jenin e u kërkonin ndihmë,borxh në para,punonin bashkë në kurbet. Kush ka dashtë ka agjëruar. Shpesh kanë falur toravi të organizuar. Ritualin e mortit e kanë kryer siç ua kërkonte feja. Në dasma nuk e kanë ngritur dollinë e parë për partinë, kurse në rast fatkeqësish fare nuk e kanë përmendur fjalën parti. Ndoshta, edhe për t'i bërë karshillëk regjim. Kur këto kanë qenë të ndaluara më ligj. Krizat, kur vendi ka qenë pa pushtet, i kanë përcjellë qetë. Pa trazira. Merren me punët e veta. Kanë pranim e unitet rreth vlerave bazë humane. Argument tjetër plus është qëndrimi ndaj gruas e femrës. Në asnjë kohë nuk i kanë përdorur gratë për barrë shpine, siç ka qenë e është rëndomtë ves i keq, në shumë zona të tjera të veriut e jugut të vendit tonë. Gruan e kanë veshur me mëndafsh e trajtuar si zonjë.

Janë njerëz stoikë në personalitet, karakter, edukatë, sjellje, metoda, temperament.Aspak epikurianë. Kanë miq, pastaj interesa, dhe jo e kundërta. Nuk I bien kujt në gjunjë. U shkojnë punëve deri në fund me vullnet e nerva të forta. Atë që duan ta realizojnë e realizojnë. Ato munden, sepse besojnë se munden. Perceptojnë rezultatin si të kontrolluar brenda mundësive e veprimeve të tyre. Optimist në punë, e jetë. Me ndjenja të forta vetefikasiteti. Me vetëvlersim të lartë. Diskret. Besojnë se janë përgjegjës për vetën, familjen, fëmijët, shtëpinë, Atdheun. Përmbushës. Mendjehapur, por jo të shfrytëzuar. Shpesh herë skeptik, por nuk jetojnë brenda dyshimit e për dyshimin. Aspak cinikë. Kanë pak nga heroi i Nietzche. Bëjnë gjërat që u pëlqejnë, pa pyetur për pazarin e opinionet. Kanë dashuri për jetën, kjo u jep energji e vullnet për veprim. Me vetëdije marrin përsipër peshën e fatit vet. I gjejmë sot në të gjitha kontinentet. Jo individualist të ashpër . Të vetëdisiplinuar. Kanë skrupuj moral. Nuk u bien askujt në gjunjë. I kanë borxh vetvetes e as njeriu tjetër. Shtëpitë më të bukura përreth Tiranës i kanë të ardhurit nga zona e Kalasë. Kanë makina luksi. I ngasin fort makinat. Paguajnë. Pa vese. Me vetëpëlqim të lartë. Njerëz të pashëm. Më të gjatë se mesatarja. Vishen me rroba të shtrenjta. Si për paradoks, nuk kanë paragjykime ndaj të tjerve, për përkatësinë grupore, krahinën, qytetin, besimin fetar, bindjet politike, punën që bën, por i vlerson njerzit nga vlerat e peronalitetit që kanë në mënyrë individuale. Historikisht, duke qenë në lëvizje e me kontakte të shumta nuk i gjykojnë njerzit nga grupi ku bëjnë pjesë. Kalaja e Dodës ka qindra veta me arsim të lartë. Me tituj e grada shkencore nga më të lartat. Me studentë të shumtë në universitetet e vendit dhe në SHBA, Londër, Itali. Do të përmend F.A. një vajzë e Kalasë Dodës ka zënë vendin e dytë në botë në një konkurs fizike të zhvilluar në SHBA. Futen në lokalet e shtrejta të Nju-Jorkut, Romës e Londrës siç futën në arët ku zgjasin mustaqet misërat. Paguajnë.

Kanë obidiencë të ulët. Shpesh u kanë bërë e u bëjnë sfidë urdhrave e pushtetit të pushtetarve. Kam qenë i pranishëm në mars 1981, kur banorët e fshatit Kullas i kanë bërë kundërshtim të hapur sekretarit të parë të partisë rrethit, për mostufëzimit të bagëtive të imta. Ai pasi e pa dështimin e tij e mbylli mbledhjen mënjëherë e iku. Ky nuk është një shembull i vetëm.

Në raportet tregtare e politike banori i Kalasë Dodës shpesh anon nga aritmetika. Nuk i pëlqen shumë algjebra. Fare thjeshtë, më jep, të jap. Shumë veta më përpara për shkak të shkollimit të pamjaftushëm nuk e kanë njohur filozofinë e pragmatizmit, por jeta e trazuar, në lëvizje i ka mësuar të anojnë nga llogaritja e interesave, duke vendosur simetri e raporte kontraktuale, por jo matrapazë. Fisnikë. Në perandorinë osmane, kanë prodhuar më shumë se vetëmjaftushëm, kryesisht produkte blegtoriale. Tepricat i shisnin në pazar si bulmetin, qengjat, delet e skarcitetit. Blinin kullotat, tagjirat. Tregu ka qenë në hapësirat e paanë të perandorisë osmane. Sot teknologjia të lejon duke qenë në Londër të blesh mallra në Tokio. Por pazari kërkon maksimalizim të fitimitI. Kjo të çon në pragmatizem. Qytetari i Kalasë i qëndron marrveshtjeve, derisa kushtet e mirëkuptuara të fillimit, nuk kanë ndryshuar.

Banori i Kalasë Dodës ka sjellje prosociale. Janë të gatshëm të ndihmojnë nevojtarin, se janë të shqetësuar për të tjerët,pa përfitim për vete. Lumturia e atij që ka nevojë bëhet përgjegjësi e tij. Ndihma kthehet në kënaqësi. Solidar. Sociabël. Në komunikim përdorin fjalor të pastër e fjalë fisnikërie. Gjuha e thartë, acide, sulfurore është e huaj. Përdorin shumë foljen e mënyrës dëshirore, si tipar mitologjik i shqipes.

Çfarë dëshiron për mirë bëhet. Kanë shumë idioma e shprehje frazologjike. Kënga burimore ka muzikalitet, dhe këndohet kudo ku ka shqiptarë. Mjafton të kujtoi këtu këngën e Fushës Korabit për nga tematika, melodia muzikore të kujton" Mbetsh, more shok, mbetsh përtej Urës së Qabes". Nëse do të shprehesha me një togfjalësh për qytetarin e Kalasë Dodës do të thoja -njeri i vetëndërtuar.

Mars,2014



Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?

SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!

< rrugaearberit@gmail.com >

emigracion

Bisedë me Meleq Beqirin,
mërgimtar në Itali

E deshëm atdheun, por, me sa duket, një pjesë s'na deshi

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Në Bulqizë shkova fëmijë dhe ika burrë i pjekur...

"Shihe se çfarë na vjen nga Shqipëria. Njerëz të cilët i përçmojmë. Shikoje se çfarë kulturë profesionale kanë përveç kulturës tjetër. Ky me të vërtetë është inxhinier dhe unë i kërkoj falje sepse e paragjykova".

As që kam ndërmend që t'i shkul rrënjët nga vendlindja, nga Strikçani. Po mendojmë me vëllain e madh që të blejmë edhe diçka tjetër, të ndërtojmë edhe nga një shtëpi secili që ta kemi në fshat..–

Natyrisht malli më i madh është për prindërit, për shokët por nganjëherë edhe për një copë gurë, jo një gurë të shenjtë, por një gurë që e kemi ndesh shpesh, madje që na ka vra këmbët zbathur, por edhe për ndonjë ferrë që më ka grisur këmishën. Nganjëherë kur e arratis mendjen e ndjej se nuk qetësohem...

HYRJE NË BISEDË...

E kam njohur maleve të Bulqizës, atyre maleve që më shumë se floririn e nëntokës kanë atë të mbitokës, atë që lëviz, atë që ngjitet kreshtave dhe zbret thellësive, NJERËZIT...Punëtorë si ata, familjarë si ata, të shoqërueshëm deri në gaz shpirtëror.

E kam njohur edhe në kalimin e kohëve, kur drejtonte rrethin, në periudhën më të vështirë për Bulqizën...

Më humbi për shumë vite...

E gjeta një ditë në shoqërinë e madhe të internetit...



Një ditë më kërkoi numrin e celularit në Shqipëri...

U takuam disa herë. Pimë kafe dhe udhëtuam luginës së Bulqizës për tu ngjitur me mend në Dhoks e në Tërnovë, për të zbritur në nivelin e dhjetë asokohe në ndërtim, për tu takuar e biseduar me miqtë e përbashkët...

Një ditë në plazhin e Malit të Robit, tek gjerbnim kafen shtypa butonin dhe i"shkrova" në diktofon zërat me të...

Po e përcjell zërin dhe emocionet e tij, zërin e një mërgimtari që nuk e ka harruar dhe nuk e harron vendlindjen...

* * *

Meleq Beqiri! Mirëserdhe në Atdhe!

Mirë se ju gjeta!

Ç'e mirë ju solli?

Dashuria për atdheun. Veçanërisht dashuria për prindërit, për nanën, për shokët, për gjithçka që kemi lënë mbrapa dhe gjithçka që kërkojmë të gjejmë.

Sa vjet t'u bënë në Itali?

Njëzet e një vjet.

E mban mend si ike?

Natyrisht.Dhe nuk do ta harroj kurrë në mënyrën si kam ikur. Sigurisht një nga mënyrat e vetme që nuk do të dëshiroja të ikja. Për fat të keq situatat ishin të tilla dhe na detyruan të iknim. Ne e deshëm atdheun por me sa duket një pjesë e atdheut nuk na deshi.

Si u vendose në Itali?

Me shumë vështirësi. Pa bazë, pa asnjë pikë mbështetje. Dalëngadalë u integrova. Kam fjetur jashtë për katër muaj.

Kur thoni jashtë si ta kuptojmë?

Kam fjetur në park nga data 5 shtator 1993 deri më datën 9 janar të vitit 1994.

Ike nga parku dhe u strehove në...

Gjeta punë dhe pastaj gjithçka mori rrugë...

Mund të më përshkruash ditën e parë të punës?

(Qesh...) Punë me kazmë e lopatë.

Po ajo kazma dhe lopata kishte lidhje me kazmën e gjeologut në malet e Bulqizës?

(Qesh...) Jam i gëzuar që mësova edhe nga kazma dhe lopata e vërtetë që na u desh kur nuk e prisnim.

Cili është formimi intelektual i juaji?

Kam mbaruar Universitetin e Tiranës me rezultate të shkëlqyera në degën e gjeologjisë. Kam punuar në minierën e Bulqizës inxhinier gjeolog. Nuk kam pasur mundësi të bëj specializime të mëtejshme që ka qenë ëndrra ime.

A mund të kthehesh paksa në Bulqizë, tek miqtë, tek shokët, në nostalgjinë tuaj për kërkuesin e mineralit të kromit në vendburimin më të madh të kromit në Shqipëri dhe në një ndër vendburimet më të mëdha në botë?

Bulqizën e konsideroj vendlindjen time të vërtetë, pa harruar Strikçanin ku kam lindur. Në Bulqizë shkova fëmijë dhe ika burrë i pjekur.

Nga shokët kë kujton me mall?

Nuk mund të veçoj asnjë. Kujtoj të gjithë ata shokë me të cilët kemi kaluar rininë, pjekurinë, pushimet e verës, punën, përpjekjet, veprimtarinë shoqërore, profesionin. Pa përjashtim, të gjithë.

Si u integrove në punë dhe në jetën shoqërore në Itali?

Dalëngadalë. Më duhej të rritesha profesionalisht. Kam një histori tepër të veçantë të integrimit. Më mori një usta goxha i moshuar. Dëshironte të rregullonte shtëpinë e djalit i cili shpejt do të martohej. Pas disa ditësh punë më pyeti për profesionin. I thashë se kam qenë inxhinier gjeolog. Nuk më besoi. Kur po sistemonim materialet e ndërtimit brenda në dhomë i thashë t'i sistemojmë rreth mureve sepse momenti i forcës në mesin e dyshemesë është shumë i lartë dhe mund ta rrëzojmë atë.

-Çfarë është ky momenti i forcës? – më pyeti Ia shpjegova duke bërë një skicë...

Atëherë më tha se me siguri duhet të kesh studiuar për inxhinieri.

Kur erdhi djali, i cili ishte inxhinier ndërtimi, i bëra një pyetje teknike. Ai hezitoi për momentin të përgjigjej.

Babai i tha: "Shihe se çfarë na vjen nga Shqipëria. Njerëz të cilët i përçmojmë. Shikoje se çfarë kulturë profesionale kanë përveç kulturës tjetër. Ky me të vërtetë është inxhinier dhe unë i kërkoj falje sepse e paragjykova". Në vijim të ditëve më sugjeroi që t'i ve objektiv jetës time që të mos vazhdoj të punoj me kazmë e lopatë por t'i ve dijenitë në shërbim të një pune timen.

Vite më vonë, kur u transferova nga Roma në Veneto një zonjë e moshuar e cila kishte prej trembëdhjetë vjetësh një problem të pazgjidhur në shtëpinë e saj, kur e zgjidha më tha "Ti je i zoti të bësh një numër trembëdhjetë në loto". Kur e përshëndeta në darkë më pyeti: "Pse vazhdon të punosh nën padron?". I them se kam familjen për të mbajtur. Më tha që nesër të shkosh të hapësh një llogari pune në bankë. Dhe në qoftë se gruaja dhe vajza jote do të rrezikohen të vdesin për bukë bjeri se do t'i mbaj unë. Ti vetë mund të vdesësh në qoftë se nuk je i zoti të mbijetosh.

Të nesërmen hapa llogarinë e punës. Që atëherë kam njëmbëdhjetë vjet që punoj në punën time. Partita iva është ajo që identifikon



ndërmarrjen. Nga momenti që e hap ke një ndërmarrje mbi bazën e të cilave paguan taksat dhe zhvillon gjithë veprimtarinë e punës. Edhe tash, në kohë krize, ndërmarrja vazhdon të ketë sukses, relativisht të mirë. I rezistuam krizës. Jemi 3-4 familje që jetojmë me këtë ndërmarrje.

Çfarë veprimtarie bëni konkretisht?

Kemi një ndërmarrje ndërtimi. Kryesisht merremi me rikualifikimin e ndërtimeve të vjetra plus edhe ndërtime të reja si dhe shërbime të ndryshme.

Sa është vlera e punimeve?

Afërsisht 150-200 mijë euro në vit, nganjëherë edhe më shumë.

Çfarë mjetesh pune keni në përdorim?

Kemi mjete të lehta që quhen betoniere, trapanofleksibele, dy kamioncina 35 kuintal. Pothuajse të gjitha veglat e lehta.

Nga kush përbëhet ndërmarrja?

Jam unë si titullar. Kam edhe tre të tjerë dhe sipas rastit marr edhe 5-7-10 të tjerë sipas volumit të punës.

Të tjerët janë shqiptarë apo edhe italianë apo emigrantë?

Janë të gjithë shqiptarë për momentin por në disa raste thërres edhe hidraulikun që është italian, elektricistin po italian. Me ta koordinojmë punët. I ftoj ose më ftojnë që unë të bëj pjesën e ndërtimit.

Si je i stabilizuar familjarisht në Itali?

Goxha mirë. Jam ndalur në Padova sepse pikësynimi im është që të krijoj një të ardhur ku fëmijët të mund të shkojnë në një universitet prestigjioz siç është universiteti i Padovës, i dyti universitet më i vjetër në Itali pas universitetit të Bolonjës.

Sa vite ka që është hapur?

Me siguri diku tek pesëqind vite më parë. Di që kanë studiuar dhe dhënë mësim Galileo Galilei, Lermontovi, Mendelejevi, Isak Njutoni...dhe personalitete të tjerë të kohës sonë.

Familja jote e ngushtë?

Jam unë, bashkëshortja dhe dy fëmijë. Gruaja, Fazile Lleshi vajzë Gjorice por nga Zogje, vajza e Tufik Lleshit. Kam edhe vajzën Aurorën, vajza e madhe 11 vjeç dhe djalin 6 vjeç, Endrin. Vajza vazhdon shkollën që po ta llogarisin me sistemin në Shqipëri i bie të jetë në klasën e gjashtë. Djali është akoma në kopsht.

Je shtetas italian apo...?

Që nga data 9 gushti jemi të katërt me shtetësi italiane. Unë ka 4 vjet që bashkë me fëmijët e kam marrë shtetësinë italiane kurse gruaja e mori më 9 gusht 2014.

Në Shqipëri kë keni?

Nga familja e ngushtë kam nanën, vëllezërit, motrat. Kam dy vëllezër këtu, kam edhe tri motra. Kam edhe një motër në NewYork. Janë të martuar dhe me fëmijë. Djalin e kam edhe me shtetësi amerikane sepse ka lindur në NewYork.

Në fshat kë keni?

Kam nanën dhe vëllain që rrinë në Strikçan.

I keni shtuar ndonjë tullë shtëpisë së vjetër në Strikçan?

Kemi bërë një shtëpi të re atje ku rri nana dhe vëllai. Kemi mbajtur gjithë tokën...

Akoma i mban të gjalla, nuk i keni shkulur rrënjët në vendlindje?

As që kam ndërmend që t'i shkul rrënjët nga vendlindja, nga Strikçani. Po mendojmë me vëllain e madh që të blejmë edhe diçka tjetër, të ndërtojmë edhe nga një shtëpi secili që ta kemi në fshat. Ne kemi gjithsesi shtëpinë tonë sepse atje rri nana dhe vëllai, që është shtëpia jonë edhe ajo, e vjetra fare që është e gjyshit ku rri vëllai dhe nana dhe mendojmë të ndërtojmë edhe nganjë shtëpi tjetër që kur të vijmë të jemi tek shtëpia jonë.

Rruga e Arbrit del në prag të shtëpisë?

Më vjen shumë afër. Shpresoj që të mos ngelet premtim elektoral. Mendoj që ta kërkojmë, natyrisht në mënyra të ligjshme. E drejta e dibranëve për të pas Rrugën e Arbërit është më se e ligjshme, madje shumë e vonuar. Ka ardhur koha që dibranët të kenë rrugën e shumë premtuar.

Kur do të ikni në Itali?

Do të ik më 28 gusht. Më duhet të kthehem sepse për fatin e mirë jam shumë i ngarkuar me punë. Por përpara se të shkoj në Itali do të shkoj në Strikçan për tu çmallë me nanën, me njerëzit, me vendet e mia.

Do të lahesh në Zall?

Erdhe në Zall do të shkoj. Do të çoj vajzën dhe djalin. Kanë dëshirë të lahen dhe ta përjetojnë realisht atë që u kam treguar unë se cili ka qenë plazhi jonë, Zalli i Okshtunit. Është me të vërtetë një Zall i mrekullueshëm me atë ujë qelibar të pastër me troftat që vallëzojnë mbi gurë.

Çfarë ndjen atje ku je, në mërgim, mall që të tundon e ta merr gjumin?

Natyrisht malli më i madh është për prindërit, për shokët por nganjëherë edhe për një copë gurë, jo një gurë të shenjtë por një gurë që e kemi ndesh shpesh, madje që na ka vra këmbët zbathur, por edhe për ndonjë ferrë që më ka grisur këmishën. Nganjëherë kur e arratis mendjen e ndjej se nuk qetësohem. Me mall kujtoj veçanërisht ditët e festave, ditët veçanta të ditëlindjeve kur e ndjej të pamundur që mendjen mos e kthej dhe mbaj atje gjatë.

Rruga e Arbërit nr. 103

Kur bie fjala për Shemsi Hoxhën, e kujtojnë duke arritur deri atje sa ta quajnë "Njësh në shumë drejtime...

portret

Shemsi Hoxha – dibrani me mendje, qëndrime e **veprime brilante**

Nga **SHEMSI MANJANI**

Shemsi Hoxha, kudo ku punoi e jetoi në Dibër, ka lënë emër tepër të respektuar. Jeta e tij prodhoi vetëm mirësi, mençuri e kontribute. Ai ishte kuadër me mendje të kthjellët e të thellë, me pasion e kompetencë në punë, me korrektësi e shpirt demokratik, me cilësi të veçanta komunikimi, mbi të gjitha, me karakter për t'u admiruar.

Me siguri, ndonjë lexues i nderuar, që nuk e ka njohur për së afërmi Shemsi Hoxhën e opinionin e përgjithshëm për të, vlerësimin e sipërm do ta konsideronte zell të tepruar e të shpërdoruar të autorit. Jemi përballur me zelle të tilla që i largohen shumë të vërtetës, duke krijuar një opinion jo të mirë për cilindo autor apo çdo person tjetër që bie në pozita të tilla, gjë që nuk do t'ia dëshiroja vetes. Kujtoj këtu thënien e shkrimtarit Arturo Graf që thotë: "Në gjykimet që japim për të tjerët, shpesh tregojmë se çfarë jemi ne vetë". Vlerësimi i sipërm për Shemsi Hoxhën bazohet jo vetëm te njohja ime për së afërmi për disa vite, por edhe tek opinioni për të, i njohur dhe përmendur nga shumë të tjerë në shumë raste, disa prej tyre dibranë e jodibranë që punuan e drejtuan në Dibër, tani prej vitesh banues në Tiranë. Kur bie fjala për Shemsi Hoxhën, e kujtojnë duke arritur deri atje sa ta quajnë "Njësh në shumë drejtime", "Trurin e Komitetit Ekzekutiv", "Qytetarin model" të atyre viteve e tjerë.

Unë e kam njohur në vitin 1957, kur mbarova studimet e larta dhe u emërova mësues në shkollën pedagogjike, një njohje kjo e përciptë, karakteristikë e njohjeve të mësuesve e përqendruar më shumë për njëri-tjetrin apo drejtuesit e institucionit nga ku varen. Interesi për ta njohur më mirë ndodhi kur ai u lidh në fejesë me Hava Shehun, shoqen time të klasës në shkollën unike, shkollë e hapur në vitin 1946 në qytetin e Peshkopisë. Ajo pati qenë nxënësja më e shkëlqyer në tre vitet e unikes, shembullore në çdo drejtim; pas mbarimit të saj mësuese e dalluar pa arsim përkatës. Me mbarimin e pedagogjikes me korrespondencë, arriti të radhitet mes mësueseve më të mira të Dibrës. U fol shumë mirë për atë lidhje, siç ndodhte e siç ndodh në qytetet e vogla, ku banorët njihen mirë me njëri-tjetrin. Ata përjetojnë ngjarjet e gëzueshme që ndodhin në qytetin e tyre, siç e përjetuan atëherë edhe këtë lidhje që do të krijonte familjen dinjitoze, sipas mendimit të tyre, ashtu si lidhjet e rrënjëve nga ku vinte çifti.

Në përvjetorin e çlirimit të Dibrës të atij viti, krahas partizanëve të tjerë, do të dallonim (disa nga ne për herë të parë) edhe Shemsi Hoxhën me dekorata të shumta në gjoks. Shpejt do të mësonim se ai, së bashku me Qatip Calën nga Sllova, kishin qenë partizanët më të rinj dibranë, rreth moshës 14-15-vjeçare, kur i ishin përgjigjur thirrjes drejtuar djemve shqiptarë për të mbrojtur atdheun. I aktivizuar me të rinjtë që në vitin 1943 në përkrahje të luftës për çlirim, i arrestuar dhe i liruar për mungesë provash nga armiku, më vonë do të radhitej me forcat partizane. Do të merrte pjesë në luftën për çlirimin e Peshkopisë, Kukësit, Prizrenit e tjerë. Në gjoksin e tij do të vendoseshin dekoratat: "Medalja e Çlirimit" - më 8 maj 1946, "Medalja e Trimërisë" - në vitin 1954 në 10-vjetorin e çlirimit, po në këtë vit edhe "Medalja e Punës".

Tepër komunikues, i qetë dhe i vëmendshëm me të gjithë punonjësit. Shquhej për diskutimet që bënte në mbledhjet e komitetit me argumentet që përdorte. Shfaqte një talent superior jo vetëm për problemet ekonomike si profesionist, por edhe për çdo problem tjetër...



Në foto: Shemsi Hoxha

Shemsi Hoxha, kudo ku punoi e jetoi në Dibër, ka lënë emër tepër të respektuar. Jeta e tij prodhoi vetëm mirësi, mençuri e kontribute. Ai ishte kuadër me mendje të kthjellët e të thellë, me pasion e kompetencë në punë, me korrektësi e shpirt demokratik, me cilësi të veçanta komunikimi, mbi të gjitha, me karakter për t'u admiruar.

Pas çlirimit do të punonte njëfarë kohe në drejtimin e kooperativave të konsumit në Tiranë, i tërhequr pastaj në Dibër në këtë detyrë për nevoja kuadri, ku shërbeu për disa vite i papërlyer asnjëherë, gjë që ndodhte në sektorin e tregtisë. Në vitin 1959, në moshë të rritur, mbaroi Fakultetin e Ekonomisë, në degën e ekonomisë industriale me rezultate shumë të mira, i pari në Dibër me arsim të lartë në këtë sektor.

Njohjen më nga afër për të do ta kisha në vitin 1967, kur do të emërohesha shef i seksionit të arsimit e kulturës në Komitetin Ekzekutiv, ku Shemsiu më parë kishte filluar punën si shef i seksionit të planit. Që në fillim të punës në komitet, nuk e pata të vështirë të kuptoja se ai ishte ndër më të respektuarit. Në seksionin e planit, të gjithë e mbanin si idhull për punën që bënte, për ndihmën e kujdesin ndaj tyre.

Tepër komunikues, i qetë dhe i vëmendshëm me të gjithë punonjësit e aparatit. Shquhej për diskutimet që bënte në mbledhjet e komitetit me argumentet që përdorte. Shfaqte një talent superior jo vetëm për problemet ekonomike si profesionist, por edhe për çdo problem tjetër kur diskutohej apo vendosej, duke u dalluar për integritetin e tij të pacenueshëm. Ishte mbështetja kryesore për tre kryetarët e komitetit me të cilët punoi, mbështetje për gjykimin e problemeve, përgatitjen e materialeve, përfshi dhe materiale për komitetin e partisë, qeverinë e tjerë. Si shef seksioni, pas një pune këmbëngulëse, botoi "Vjetarin statistikor të rrethit të Dibrës", libër shkencor, me qindra faqe për të gjithë sektorët, duke krahasuar arritjet me ato të Republikës, botim i parë i këtij lloji për kohën. Me këtë rast iu akordua Urdhri i Punës së klasit III me përmbajtjen: "Për shërbime të shquara shtetërore e shoqërore në sektorin e planit të shtetit". Më vonë do të merrte dhe Urdhrin e Punës të klasit II, në vitin 1967 dhe atë të klasit I më 18 janar të vitit 1985. Në ato vite pati ndërhyrje për ta tërhequr në Tiranë, gjë që u kundërshtua nga rrethi për nevoja kuadri.

Për aftësitë, meritat e kontributet do të ngrihej në përgjegjësi, duke u emëruar nënkryetar i Komitetit Ekzekutiv, duke i dhënë në vartësi edhe seksionin e arsimit dhe kulturës, përveç seksionit të planit, industrisë e ndonjë tjetri. Kuadrot drejtuese të tyre e ato të ndërmarrjeve do të ishin shumë të lidhur e të afruar me të. Ishte personi kryesor, njohës i problemeve të tyre, duke filluar që nga planifikimi e duke vazhduar deri në fund me arritjet e mosarritjet, pengesat e vështirësitë e shumta që dilnin e rrugët për kapërcimin e tyre.

Lidhja ime për çdo problem të rëndësishëm që do të kisha, që do të gjykohej e vendosej për t'u paraqitur në komitet, do të bëhej vetëm me të. Diskutonim e gjykonim për emërime, lëvizje kuadri, të drejta studimi e shumë probleme të tjera që dilnin vazhdimisht në seksionin e arsimit dhe kulturës. Kishim përballje të vazhdueshme edhe me Komitetin e Partisë, kryesisht me sektorin e edukimit për kërkesa e ankesa që bëheshin atje. Shemsi Hoxha shqetësohej shumë kur përballeshim me mendim tjetër të Komitetit të Partisë, për të drejta studimi dhe emërime të kuadrove të këtij sektori, sidomos për rastet me ndonjë "kleçkë" në biografi, megjithëse ishte kompetencë e Komitetit Ekzekutiv. Nuk më harrohet shqetësimi i tij për nxënësit e shkëlqyer të gjimnazit, A. K. e F. L., e ndonjë tjetër, që u penguan për t'u dërguar për studime të larta, për dënime të baballarëve të tyre, megjithëse me shumë kontribute gjatë luftës e pas saj, në vitet e çlirimit. Keqardhje ndiente Shemsi Hoxha për disa mësues, si R. B., L. Sh., nga qyteti që kishin punuar me ndërgjegje shumë vite pa u krijuar asnjë mundësi për afrim. Edhe më keq për disa mësuese që u bënë edhe me fëmijë.

Ishin vite kur kritika e Komitetit të Partisë për zbutje të luftës së klasave, sidomos kur ishte e përsëritur, bëhej më përvëlonjëse. Shemsi Hoxha përballej me guxim me kritikat pa vend, kur ato ishin të tilla. I shfaqte mendimet e tij edhe në mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv. Këtë bënte edhe për ndonjë favor të padrejtë që vinte si orientim nga lart. Qëndrimet e tij të drejta, me mendime ndryshe, ne të tjerët i miratonim, por më shumë duke heshtur apo duke folur me zë të mekur. Këto veprime e qëndrime të Shemsiut nuk pëlqeheshin nga ndonjë kuadër kryesor në rreth.

Në kuadrin e 25-vjetorit të çlirimit e më pas, në Dibër, duke përdorur metodën e aksionit me goditje të përqendruar, pati disa arritje që bënë bujë. Arritje në ndërtimin e veprave social-kulturore, ndërtimin e disa kanaleve vaditëse e tjerë. Për këto, në gjoksin e Dibrës u vendos ylli i artë, asaj iu dha titulli "Hero i Punës Socialiste".

Aksioni më i rëndësishëm, më i vështiri e më me leverdi për qytetarët e Peshkopisë ishte ai i ndërtimit të lagjes së re, të Kamenit, ndërtim që do të bëhej pa buxhet të planifikuar, brenda një viti, mbështetur i gjithi te rezervat e ndërmarrjeve e te puna vullnetare. Drejtues për këtë aksion u caktua Shemsi Hoxha, i vlerësuar si i vetmi që mund ta kryente. Gjendja e strehimit në qytet ishte si mos më keq. Shumë pa strehim, disa të strehuar në fshatrat përreth. Keq ishin dhe gati shumica e të strehuarve, dy familje në një hyrje dy dhoma e një kuzhinë me një tualet ku vështirësitë fillonin që në mëngjes duke pritur radhën për në tualet, pa përmendur këtu edhe probleme të tjera më serioze që dilnin herë pas here. Shemsiu, së bashku me drejtuesit e ndërmarrjeve, i lidhur me ta prej vitesh, studiuan të gjitha mundësitë duke përcaktuar ndërtesat në ngarkim të çdo ndërmarrjeje e mbështetjen që do t'u jepej me aksionet e përqendruara me punë vullnetare e forma të tjera. Puna filloi. Punohej ditë e natë me turne. Ndihma me punë vullnetare nga qytetarët, përfshi edhe nxënësit e shkollave të mesme, qe e paparë deri atëherë. Sipërfaqja e ndërtimit, e rrethuar dhe e ndriçuar me drita të shumta, me çadrën në mes, ku ishte vendosur drejtuesi i aksionit, Shemsi Hoxha, mbushej plot me vizitorë ditën e në mbrëmje deri vonë, duke ndier një kënaqësi të veçantë. Kënaqësi, gëzim e lumturi ndjenë veçanërisht ato familje që u strehuan në ato dhjetëra ndërtesa një e dykatëshe. Një arritje e parealizuar deri atëherë. Shemsi Hoxha e ndjeu veten edhe më të nderuar e më të respektuar.

Filloi punën si zakonisht në detyrën ku ishte, punë që nuk e pati braktisur edhe gjatë aksionit. Ndodhi çudia! Pas njëfarë kohe, ngadhënjimi u kthye në disfatë, Shemsi Hoxha u dërgua shef plani në kooperativën e Fushë-Çidhnës. U fol se ishin raportuar disa të dhëna fiktive në qendër, për të cilat duhej dënuar një person me përgjegjësi për të shpëtuar një person tjetër më me përgjegjësi, iniciator për këto aktivitete. Ishte caktuar Shemsiu. Ndodhnin gjëra të tilla, abuzime në disa raste, duke u mbështetur edhe në disa orientime të partisë, siç ishte e ashtuquajtura "Lëvizje për qarkullim", që të mbyllte gojën edhe kur bëhej padrejtësisht. Me një shok të ngushtë të tij i shkuam ato ditë për një vizitë në shtëpi. Gjatë bisedës, ai e pyeti nëse do të bënte ankesë për këtë lëvizje. Më bëri përshtypje se Shemsiu u përgjigj po ashtu siç më ishte përgjigjur mua dikur Selim Alliu, intelektuali i shquar me kontribute në arsim e kulturë i dërguar mësues në Shupenzë, kur i kisha bërë këtë pyetje, kuptohet, me fjalë të tjera. Selimi mua më ishe përgjigjur shkurt, duke më përmendur aforizmin: "Kur të rrahin, nuk të pyet kush të dhemb apo jo". E kujtova vite më vonë këtë aforizëm që karakterizonte atë kohë, kur duhej vendosur për ankesë ose jo.

Opinioni i shëndoshë për Shemsiun si brenda rrethit, ashtu edhe në Tiranë, bëri që ai të kthehej në Peshkopi pa mbushur vitin. U caktua drejtor në institucionin financiar më të rëndësishëm të rrethit, në bankë, ku kishte pasur disa vështirësi e probleme. E drejtoi atë me përkushtim, aftësi e dinjitet derisa doli në pension, i rënduar nga gjendja shëndetësore.

Më 5 shkurt të vitit 1999, në moshën 72-vjeçare, Shemsi Hoxha u nda nga jeta, duke lënë në pikëllim të thellë familjen, miq e shokë, banorët e qytetit të Peshkopisë, të gjithë ata që e njohën, që punuan e drejtuan me të. Duke udhëtuar kokulur drejt varrezave, të gjithë meditonin për të, për simbolin e punës, sakrificës e ndërgjegjen e pastër, për madhështinë e tij larg alibive politike e vlerave falco.

Përfundoj duke shprehur dëshirën e mendimin, shumë i bindur se është dëshirë e të gjithë qytetarëve të Peshkopisë e më gjerë: Për të përjetësuar emrin e tij, të shpallet "Qytetar nderi" dhe lagjes në Kamen t'i jepet emri "Lagjja Shemsi Hoxha".

mundje

Më 1 nëntor 2014 në Pallatin e Sportit "Bashkim Lala" u organizua një takim me të mundësit dibranë që përfaqësuan ngjyrat e ekipit Korabi ndër vite

Mundja, *sporti që u ka hije* **dibranëve**

Nga **SASHENKA NDREKA**

Nëntori startoi sërisht me festë për sportin dibran. Këtë herë ishte ekipi i mundjes që mblodhi tok veteranë, ish sportistë e kampionë në një eveniment të përbashkët, për të festuar 65 vjetorin e krijimit dhe njëkohësisht për të nderuar figurat më të shquara në këtë sport.

Më 1 nëntor 2014 në Pallatin e Sportit "Bashkim Lala" Bashkia e qytetit, në bashkëpunim me Shoqatën Kombëtare të Mundjes dhe Klubin sportiv Korabi, organizuan një takim për të gjithë mundësit dibranë që përfaqësuan ngjyrat e ekipit Korabi ndër vite. Ndonëse për shumë arsye, në Dibër këtij sporti i është zbehur shkëlqimi, nuk mund të lihen pa përmendur vitet e arta, ku mundësit dibranë shkruan historinë e mundjes shqiptare.

Ishte viti 1949 kur në Shqipëri mori jetë ekipi i mundjes Korabi, nën udhëheqjen e trajnerit Hiqmet Elezi i dekoruar me titullin "Nderi i sportit shqiptar"për të lindur më pas simotrat e tij ekipi i pionierëve dhe të rinjve në stilin e mundjes klasike dhe atë të lirë.

Do të ishte ky një fillim i mbarë, për të vijuar më pas me tituj të herë pas hershëm kombëtarë e ndërkombëtar.

Deri tani nga Ministria e Arsimit, Kulturës dhe Sporteve janë vlerësuar më tituj mjaft mundës të shquar dibranë: Menzat Allajbegu - Nderi i Mundjes Kombetare Shqiptare, Ramadan Martini, Fiqiri Osmani, Xhelil Cibaku, Fiqiri Rama - Mjeshtra te Merituar te Sportit dhe "Nderi i Sportit Shqiptar",Hiqmet Elezi, Ferik Reci, Meleq Zajmi, Shemsi Shini, Masllam Tola, Haxhi Dani, Njazi Karasani, Rrahim Rama, Nesim Rama, Lutfi Noka, Veli Drizi, Rasim Shira, Defrin Koci, Skender Rama, Femi Sejdini, Artan Tomçini, Zija Zajmi, Avni Sadikaj jane nderuar me titujt e larte sportive Mjeshter Sporti dhe Nderi i Mundjes Shqiptare.

Ndërsa në evenimentin e mbajtur këte herë, u zgjodhën të tjerë sportist dibranë për tu ndëruar: Xhemal Skara, Ismet Sula, Emirjan Huna, Shemsi Shini, Mentor Karasani, Reiz Avdia, Asllan Osmani, Skender Rama dhe Avni Halili (pas vdekjes), Ilir Gjiza (pas vdekjes), Ivzi Muca (pas vdekjes), Haxhi Dani (pas vdekjes), etj.

Pas dekorimit të të pranishmëve, kujtimit dhe respektit të atyre që nuk janë më mes nesh, pas fjalëve të mbajtuara nga çdokush që e pa të arsyeshme të cilësojë e lartësojë vlerat e këtij sporti burrëror, që më së shumti u ka hije dibranëve, për të nderuar sportdashësit e mundjes si dhe për të nxitur punën për zhvillimin e sportit dhe aftësisë sportive të mundjes, u organizua një aktivitet rajonal, me ekipet e Korabit, Kukësit, Matit dhe Bulqizës (Ostrenit), ku padyshim triumfues ishin sportdashësit dibranë.



Pa bazë materiale edhe pasioni më i madh venitet

Sipas bisedës me Mjeshtrin e Merituar të Sportit Fiqiri Rama, dhjetor 1995

Ndeshja më e vështirë?... Më e vështira ka qenë me djalin. Shorti na vuri të dyve përballë njeri tjetrit. Mendova t'ia lë djalit, ta bëj kampion. E zgjidhi djali. Pas tre-katër minutash ndeshjeje, kapjesh e lëvizjesh të bukura, djali më kapi dorën dhe e ngriti lart. Djali i fitoi të gjitha ndeshjet e tjera. Edhe unë i fitova. Unë zura vendin e parë kurse djali të dytin...

Disa ditë më parë, nëpërmjet facebook-ut përjetova çaste të bukura nga vlerësimet për mundësit dibranë, kampionë kombëtarë e fitues të mëdhenj në ndeshjet ndërkombëtare. Nëntëmbëdhjetë vite më parë kisha bërë një intervistë me Mjeshtrin e Merituar të Sportit Fiqiri Rama.

Dorëshkrimit i kisha ngjitur dy fotografi, foto të shkëputura nga albumi vetjak i Fiqiriut. Ishin fotografi BABË dhe BIR, fotot me kostum sportiv të Fiqiri Ramës dhe Gazmend Ramës, dy kampionë dibranë në mundjen e lirë...

Nuk mbaj mend në se intervista është botuar. Dy fotografitë ma shtojnë dyshimin se ajo mbeti në arkivin tim pa parë dritën e botimit...

Ishin kohë kur flitej për gjithçka që lidhej me politikën dhe as çka për sportin, veçanërisht për mundjen, mbase edhe sot "vrima e fundit e kavallit sportiv"

Po e përcjell bisedën me kampionin Fiqiri Rama me gjasën se edhe pas nëntëmbëdhjetë vjetësh ajo flet sa atëherë...

Abdurahim Ashiku

Athinë, 9 nëntor 2014

* * *

Fiqiri Rama, Mjeshtër i Merituar i Sportit në mundjen e lirë, kampion kombëtar për peshën e tij gjatë 18 vjetëve radhazi, tash trajner i ekipit të "Korabit". Si dolët në kampionatin e këtij viti?

Lamë nam, apo si me e thanë më shqip, bëmë atë që nuk e ka bërë kush, asnjë ekip.


Si ta kuptojmë këtë?

Me pesë vetë, me pesë adoleshentë të moshës 15-16 vjeçare, djem të pasionuar pas mundjes së lirë, përfaqësuam Dibrën në tre kampionate njëherësh dhe në një ditë: Në kampionatin e Para të Rinjve, të të Rinjve dhe të të Rriturve. Gazmend Rama, Fatos Rama, Rudin Rama, Landi Limani dhe Krenar Iskurti zëvendësuan 30 mundës (dhjetë për çdo grup moshe). Në ekipin e Para të Rinjve Gazmend Rama, Fatos Rama e Rudin Rama, dolën kampionë kurse Landi e Krenari zunë vendet e dyta. "Korabi" për arsye se ishte vetëm me pesë mundës, nga dhjetë që duhen, zuri vendin e dytë.

Menjëherë pasi mbaruan ndeshjet me Para të Rinjtë, të pesë djemtë filluan ndeshjet me të Rinjtë. Të lodhur, pa asnjë pauzë pushimi, ata treguan se janë të fortë dhe dinë të luftojnë si burrat. Rudin Rama zuri vendin e parë ndërsa katër të tjerët vendet e dyta.

Pasdite 15-16 vjeçarët, pa pushuar fare, filluan ndeshjet me të Rriturit. Të pestë dolën nën kampione...





Pse gjithë ky sforcim?

Të thuash sforcim është pak. Të gjithëve u ka ra të bëjnë nga 10-12 ndeshje. Gazmendit i ra të bëjë 13 ndeshje. Dhe të gjitha këto në harkun e një dite, pa pushuar fare, nga njeri tapet në tjetrin.

Dhe e gjithë kjo është bërë sepse rrethi nuk kishte para, nuk mundej me financuar 5 vetë e jo më 30 vetë sa duheshin për të tre kampionatet. Vetëm pasioni i ngjiti këta djem të rinj 15-16 vjeçarë në tapet, i bëri burra.

Çfarë ka të përbashkët midis Fiqiri Ramës dhe mundjes së lirë?

E përbashkëta është se jemi një. Jam 42 vjeç. Kam 27 vjet që merrem me mundjen e lirë. Tetëmbëdhjetë vjet kam dalë kampion kombëtar në peshën time dhe në pesha më të larta. Ndeshjen e parë e kam zhvilluar në vitin 1968 me Bujar Ramën, një kushëri timin. Ndeshjen e fundit e kam zhvilluar në dhjetor 1994 me djalin tim Gazmendin...

Dhe cila ka qenë ndeshja më e vështirë?

Më e vështira ka qenë me djalin. Shorti na vuri të dyve përballë njeri tjetrit. Mendova t'ia lë djalit, ta bëj kampion. E zgjidhi djali. Pas tre-katër minutash ndeshjeje, kapjesh e lëvizjesh të bukura, djali më kapi dorën dhe e ngriti lart. Djali i fitoi të gjitha ndeshjet e tjera. Edhe unë i fitova. Unë zura vendin e parë kurse djali të dytin...

Cila ka qenë dita sportive më e gëzuar?

Kam pas shumë ditë të gëzuara, në kampionatet tona dhe në ndeshjet e zhvilluara jashtë vendit; në Greqi, Rumani, Turqi, Itali. Ndër ta veçoj fitoren 12 me zero me hungarezin në Stamboll.

Përmendët shumë Rama...

Ramët janë shumë të pasionuar pas mundjes. Mund të përmendi edhe shumë të tjerë; kampionët e njohur Rrahim Rama, Nesim Rama, Haxhi Rama. Por Radoveshi ku kam lindur, nuk ka vetëm Ramët mundës të dëgjuar e kampionë. Ka edhe Karasanët- Hazizin, Shefqetin, Mentorin etj.

Si e shikon të ardhmen e mundjes së lirë Fiqiri Rama?

Djali i madh, Gazmendi, tashmë është kampion. Djali i vogël pesëvjeçar, Ylli, është shumë i shkathët dhe premton shumë. Në Dibër dhe në veçanti në Gollobordë pasioni për mundjen është i madh. Por vetëm me pasion, pa bazë materiale, pa palestër e tapet, pa asnjë lloj fondi, edhe pasioni më i madh venitet. Megjithatë ne do të luftojmë, nuk do të tërhiqemi.

Abdurahim Ashiku

Peshkopi, 7 dhjetor 1995

Rruga e Arbërit nr. 103

Pas 42 vitesh futbolli
dibran kërkon elitën

sport

Korabi në udhëtimin e një **historie**!

Shtatë fitore në shtatë ndeshje, si kurrë më parë

Nga **DEFRIM METHASANI**

Goli i Kacnisë në minutën e tretë të ndeshjes në Skrapar i ka dhënë Korabit një fitore të vështirë në transfertë, por edhe një rekord të ri për ekipin. Nuk ka ndodhur kurrë më parë që që skuadra e futbollit "Korabi" të arrijë shifra të tilla entuziazmuese: Në shtatë javët e kampionatit të kategorisë së dytë, kemi për herë të parë shtatë fitore dhe pikët e plota 21.

Tashmë të tjerët kanë kthyer kokën nga "Korabi" dhe habiten me fitoret dhe rezultatet që kërkojnë të hyjnë në histori. Kishte vite që e kishim vështirë të hidhnim sytë në shtypin sportiv, sepse do të shihje shkallët e poshtme të tabelës dhe humbjet që s'kishin të sosur. Por si rrufe në qiell të pastër, këtë sezon erdhën fitoret brenda dhe jashtë.

Një staf tjetër ka në dorë fatet e futbollit dibran, që menaxhohen më së miri nga një djalë i ri, por shumë pasionant, si Fehmi Mëziu, që nuk e ka për herë të parë mbështetjen e

Ja ndeshjet e luajtura deri tani:

Sukthi - Korabi	**1-2**
Korabi - Shenkolli	**2-0**
Luzi 2008 - Korabi	**0-1**
Korabi - Tirana B	**4-2**
Olimpik - Korabi	**0-1**
Korabi - Domosdova	**2-0**
Skrapari - Korabi	**0-1**

Ndeshjet e mbetura:

Korabi - Teuta B
Partizani B - Korabi
Korabi - Vora
Alpetrol - Korabi
Korabi - Erzeni

sportit, bashkia e qytetit dhe drejtuesi i klubit Korabi, Sokol Muho, që në disa raste ka dhënë edhe kontributin e tij personal. Ndërkaq roli i pankinës i është besuar dyshes, Erblin Laçi dhe Shpëtim Toska, ky i fundit, padyshim lojtari më i mirë në gjithë historinë e futbollit dibran. 13-3, është golavarazhi deri më tani, që tregon për sigurinë në mbrojtje dhe sulmin e efikas.

Djemtë e Dibrës, por edhe një grup i ardhur nga Tirana, kanë gjetur gjuhën e përbashkët, në shërbim të një qëllimi dhe misioni: daljes në kategorinë e parë të Korabit.

Tashmë vëmendja është përqendruar edhe nga tifozët të cilët kanë zënë të mbushin shkallët e stadiumit Korabi, që kish mbetur si shkretëtirë, ngaqë kish humbur besimi te skuadra. Shtypi sportiv shqiptar, të hënave publikon në faqen e parë, titujt që lexon me patjetër "Korabin" edhe pse në një kategori inferiore si e dyta, por rezultatet janë për t'u veçuar dhe përbëjnë rekord.

Gazetarët shkruajnë e flasin, për atë që s'e kishin thënë më parë. Një model tjetër po lind në verilindje të vendit. Pas Kukësit, është Dibra që kërkon të thotë fjalën e saj në futboll.

Gjasat janë këtë sezon edhe pse ndoshta është shumë shpejt të themi, kur kam parasysh se kjo fazë ka edhe 5 javë të tjera. Erzeni dhe Partizani B, janë rivalet direkt deri më tani për skuadrën e Korabit dhe ndeshja e fundit me 28 dhjetor në Peshkopi me skuadrën shijakase, mund të quhet një derbi i së dytës.



Flet shefi i klubit Korabi, Sokol Muho

Misioni është i vështirë, por **jo i pamundur**

Suksesi i deritanishëm vërtet është për t'u përgëzuar, por është edhe puna e viteve të fundit, që s'duhet nënvleftësuar, pa lënë mënjanë edhe ardhjen e disa lojtarëve cilësorë nga Tirana, të cilët i janë bashkuar këtij grupimi. Tashmë Korabi është ekip pretendent për të dalë në kategorinë e parë.

Natyrisht, që ky sukses i deritanishëm, është një kontribut edhe i trajnerëve dhe lojtarëve, të cilët tashmë janë ndërgjegjësuar edhe vetë për këtë mision që i kanë vënë vetes.

Objektivi ynë është vendi i parë dhe futbolli i pastër brenda dhe jashtë fushës sonë. Tani po afrohet edhe mbështetja më e madhe e bashkisë së qytetit, kontributi i presidentit dhe donator të tjerë, madje dhe nga Amerika e Tirana. Interesimi tashmë ka qenë më i madh i mediave dhe spektatoreve.



Natyrisht, lufta sportive për ne do të jetë edhe më e madhe, por ne po përgatitemi më së miri për të arritur qëllimin. Misioni vërtet duket i vështirë, por aspak i pamundur.



Erblin Laçi – Trajner i Korabit

Objektivi ynë: **të fitojmë çdo ndeshje!**

Korabi tashmë është një realitet i ri në futbollin e kategorisë së dytë në grupin A.

Mendoj që grupi i fortë, respekti, harmonia dhe puna e secilit, na japin besimin për të dhënë maksimumin në çdo ndeshje. Janë lojtarë që kanë një bosht të tyre, sepse kanë vite që luajnë bashkë.

Por sivjet kemi edhe disa prurje të reja nga Tirana, si Karaj, Bardhi, Xhafa, dhe Livani, ndërsa konsolidimi i emrave dibranë, vazhdon të mbetet te Lleshi, Laci, Brahasani, B. Doçi dhe Indrit Doçi, Kacnia, Merdini, Torba, Toska, Adili, etj. Çdo ndeshje kemi objektiv të fitojmë dhe kur ke këtë objektiv, natyrisht të shërben për objektivin e madh. Por edhe tifozët janë një plus i madh dhe na japin shumë moral për fitoren. Ata na vijnë edhe në qytetet jashtë Peshkopisë.

Problem mbetet ana financiare,



edhe pse bashkia thotë që ka çelur një fond prej 2 milionë lekë të vjetra. Gjithsesi, e kam thënë dhe e përsëris që është vetëm pasioni që na mban gjallë dhe kaq të karikuar.

Flet kapiteni i skuadrës, Gerald Lleshi

Korabi mund të friket nga **gjyqtarët**, jo nga **kundërshtarët!**

Korabi ka ndryshe trajnerin, që na ka fut në punë. Plus lojtarëve që erdhën nga Tirana, të cilët sollën më shumë kualitet, si dhe presidentin Fehmi Mëziu.

Tifozeria na mbështet çdo ndeshje. Besojmë se do të fitojmë çdo ndeshje.

Frikë mund të kemi gjyqtarët, por jo kundërshtarët.

Shpëtim Toska, ylli i futbollit dibran

Është krijuar **besimi** për **kategorinë e parë**

Së pari ndjehem mirë që ne po diskutojmë tashmë një tjetër pikë, atë të daljes së Korabit në kategorinë e parë.

Janë disa faktorë që duhen përmendur në këtë lëvizje të deritanishme, edhe pse ne vazhdojmë të kërkojmë më shumë cilësi. Kemi kapur pikët e plota, por na duhen edhe ndeshjet e bukura.

Presidenti i skuadrës Fehmi Mëziu dhe drejtori i klubit Sokol Muho, na kanë mbështetur dhe jemi mirënjohës për punën e tyre. Ata të dy janë për t'u marrë shembull në këtë përkujdesje.

Por sivjet po bëhet një punë e mirë edhe për grupmoshat dhe prapavijën e këtij sporti dhe dua të përmend punën e trajnerit Artur Cami që punon me grupmoshat e të rinjve dhe po ecin mjaft mirë me një fitore dhe një barazim.

Tashmë ata janë e ardhmja e Korabit dhe vërtet, nëse e arrijmë objektivin sivjet, do na duhen mjaft elementë të rinj, sepse e njohin mentalitetin e lojës dhe traditën e futbollit dibran.

Jemi shumë afër një suksesi, por që s'ka mbaruar, por vazhdon, sepse neve na duhet të fitojmë çdo ndeshje.

futboll

Flet Fehmi Meziu
- Presidenti i Korabit

Korabi është i të gjithëve!

Jam vërtet i emocionuar për arritjet e deritanishme dhe këta djem meritojnë kategorinë e parë. Është një rrugë jo e lehtë, që ka nisur mbarë dhe mendoj që do të vazhdojë kështu, sepse i kemi vënë vetes një qëllim, të dalim në të parën.

Ka shumë njerëz që duhen përmendur në këtë udhëtim historik. E nis me kryetarin e bashkisë zotin Ilir Krosi, pas një bisede që më ngjalli më shumë respekt dhe shpresa për të vazhduar drejt suksesit, pasi më garantoi që bashkia do japë maksimumin. Dhe meqë jemi te bashkia, dua të veçoj edhe Sabri Laçin, nënkryetar i bashkisë, që na ndjek në ndeshje dhe ndajmë bashkë të mirën dhe vështirësinë.

Gjithashtu, nënvizoj Sokol Muhon, që meriton edhe ai përgëzime, sepse nuk është vetëm një shef klubi, por edhe dashamirës, që në raste të caktuara ka ndihmuar skuadrën.

Stafin drejtues, duke nisur nga trajneri i parë Erblin Laçi, një trajner i kualifikuar nga FSHF, rezultatet e të cilit vijnë gjithnjë në rritje dhe i dyti, Shpëtim Toska, një emër i madh i futbollit dibran, që këtë vit e kanë marrë çdo gjë seriozisht dhe po japin rendimentin e duhur, në kërkim të kategorisë së parë.

Shkojmë më tej. Një tjetër trajner, një emër i njohur në futbollin dibran është Telman Perleka. Ai ka një tjetër grup lojtarësh që merret me ta në Tiranë, duke lehtësuar punën tonë.

Skuadra, vërtet duhet përgëzuar për shpirtin e garës dhe karakterit që shpalos në fushë. Janë djem kurajozë, që luajnë brenda dhe jashtë fushe, duke pasur pikësynim jo vetëm fitoren, por edhe futbollin e pastër dhe lojën korrekte. Tifozët, lojtari i 12-të, pa të cilët Korabi nuk do të ishte ky që është tani. Ata s'na ndahen jo vetëm në Peshkopi, por edhe në transfertë, madje qindra, duke sakrifikuar gjithçka nga vetja, për të ndihmuar objektivin tonë madhor.

Po ndalem tek disa lojtarë, që kanë vendosur fate në lojën e ekipit. E nis nga porta, aty ku portierët Levani dhe Torba, janë ruajtësit fanatikë të kuadratit dhe siguria e prapavijës sonë. Mbrojtja ka emra të spikatur, që nis me kapitenin Lleshi e vazhdon me Bardhin, B. Doçin, B.Laçin, I. Doçi. Ndërkaq që mesfusha është truri i skuadrës, me Kacninë, Karaj, Xhafa, Toska, Adili, Ibro, Jashari, etj.

Por s'mund t'i shmangesh sulmit, me dyshen e rrezikshme, Merdini dhe Brahasani, pa harruar ndonjë futbollist tjetër, që vihet në shërbim të skuadrës sa herë trajneri ka nevojë për të.



Jemi përballë një fakti historik, asaj historie të re që kërkojmë të gjithë bashkë ta bëjmë realitet. Modelin e kemi shumë afër, te skuadra e Kukësit, fqinjit tonë gjeografik që arriti majat e superligës dhe doli në disa ture europiane. Por ky model tregoi se kur të gjithë bëhen bashkë, suksesi është i padiskutueshëm.

Korabi është zemra ime dhe e shumë dibranëve të tjerë. Unë kam ardhur jo sivjet pranë ekipit, por edhe kohë të tjera. Por ky moment është i artë, sepse jemi në një rrugë pa kthim, që ka nevojë jo vetëm për mua, por edhe për çdo dibran që e sheh veten këtu, si kontribues jo vetëm i një ekipi, por edhe i një historie.

Fazën e dytë do bëjmë edhe ndonjë ndryshim të mundshëm, pa luajtur pozitat e këtij grupi të fortë, që është shumë fantastik, por edhe për një stol të fuqishëm, me qëllim që trajnerët të mos kenë dhimbje koke për raste të ndryshme dhe skema të tjera.



Ekipi i Korabit dhe Presidenti i tij Fehmi Meziu uron gazetarin e mirënjohur sportiv Defrim Methasani, mikun e gjithë sportistëve dhe artistëve dibranë për ditëlindjen, duke i uruar atij edhe 100 vite të lumtura, i gjallë dhe aktiv si gjithmonë! Me këtë urim bashkohet edhe redaksia e gazetës "Rruga e Arbërit".

Ilir Krosi – Kryetar i Bashkisë Peshkopi



Jemi të mrekullueshëm me Korabin!

Jemi të mrekullueshëm me këto rezultate të deritanishme, madje do t'i quaja surprizuese.

Kam dëshirë të theksoj kontributin e zotit Fehmi Mëziu, deri me tani donator i vetëm i futbollit.

Vërtet mbështetja e tij ka qenë e madhe, por ai është i vetëm dhe duhen të tjerë për të pasur më shumë të ardhura dhe garanci për të ardhmen.

Roli i tij edhe pse i madh, ka qenë gjithnjë krahas bashkisë me ato mundësi që ka pasur ajo deri më tani. Është një shpërblim i madh kjo që kanë arritur deri tani njerëzit e futbollit në Dibër.

Është pikërisht ky ekip, pra, Korabi, që ka zgjuar shpresat e dibranëve. Janë rikthyer ëndrrat, por duhen donatorë të tjerë për një Korab në elitë dhe një nxitje e mëtejshme për bashkinë.


Tashmë dhe qytetarët na thonë çoni lekët te Korabi. Është një zgjim i madh i ndërgjegjes qytetare.

Duhet të vazhdojë të mbetet në fuqi kjo lëvizje e futbollit dibran, për të merituar më shumë vëmendje dhe më shumë mbështetje.

Të gjithë bashkë do t'ia dalim!

Rruga e Arbërit nr. 103

libri i ri



VARRË

Roman i ri nga Eqrem Basha

Botimet KOHA
ISBN: 978-9951-417-67-9
Çmimi: 5 Euro

Për të gjithë këto që i the po largohesh, o Udhëtar?
Ika se nuk mbet kush, o Zotni.

Po ti qenke mbushur mall pa ia kthyer shpinën vatanit. Gjithë këtë zjarrmi që paske për atë patkua, s'do ta përballosh duke ikur.

E sheh këtë varrë? S'e sheh, s'e sheh, se është brenda. Nuk duket nga jashtë. Është shumë e thellë. Ja, këtu më djeg, në kraharor. Këtu kanë hyrë thikat dhe kanë çarë damarë, kanë gërryer kocka. Kjo sëmbon sa herë ndërron moti. E moti ndërron shpesh se jemi në tokën ku përplasen erërat e ndeshen rrugët e furtunave. Unë të thashë se nuk e kam të lehtë, se sot e tutje nuk do të jem ky që njohe.

A nuk të duket se i jep të drejtë kufirit që të ka ndarë e harrë?

E di ti si është krijuar bota? Më parë ishin Adami. Pastaj erdhi Eva. Pastaj erdhën fëmijët. Pastaj fëmijët e fëmijëve të tyre. Pastaj fëmijët e fëmijëve të tyre. Pastaj erdhën fëmijët e fëmijëve të fëmijëve të tyre. Pastaj fëmijët e fëmijëve të fëmijëve të fëmijëve të fëmijëve të tyre... fëmijët e fëmijëve të fëmijëve të fëmijëve të fëmijëve të fëmijëve të fëmijëve të fëmijëve të fëmijëve të fëmijëve...

Pastaj erdhi dikush dhe ua vuri kufijtë në mes. I bëri pikë e pesë!

Bota nuk është menduar kështu, o Zotni!



Pajtohu në gazetën *RRUGA E ARBËRIT*

Merr versionin PDF ose kopjen print duke filluar me 50 lekë/muaj

Gazeta ofron faqet e saj për REKLAMA apo NJOFTIME të ndryshme për biznese dhe individë.

ÇMIME TË ARSYESHME për faqet me ngjyra dhe bardh e zi.

Për individët, njoftimet deri në 50 fjalë (1/16 e faqes) ofrohen falas!

Për informacion:
E-mail: rrugaearberit@gmail.com
Tel: +355 69 20 68 603